



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 DHE 18 MAJ 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. I 18. MAJA 2015. GODINE**

**MAJ - MAJ
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Propozimi i GP të Listës serbe për emërimin e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
4. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve joekzekutivë në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014,
9. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë kundër Korrupsionit për vitin 2014,
10. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014,
11. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014,
12. Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Predlog PG Srpska lista za imenovanje potpredsednika Skupštine Republike Kosova,
4. Izbor dva (2) neizvršna člana u Bordu Centralne banke Kosova,
5. Prvo razmatranje N/zakona o dojenju,
6. Prvo razmatranje N/zakona o hitnoj medicinskoj službi,
7. Prvo razmatranje N/zakona o mentalnom zdravlju,
8. Razmatranje Izveštaja Nezavisne komisije za medije za 2014 godinu,
9. Razmatranje Izveštaja Agencije protiv korupcije za 2014 godine,
10. Razmatranje Izveštaja Autoriteta za civilnu avijaciju za 2014 godinu,
11. Razmatranje Izveštaja Državne agencije za zaštitu ličnih podataka za 2014 godinu,
12. Predlog PG Srpska lista za zamenjivanje članova u parlamentarnim komisijama.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritarë,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Unë do të filloj të procedoj në bazë të radhitjes. Blerta Deliu-Kodra e ka kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, pastaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të përgatitet Sadri Ferati.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
Fjala ime sot lidhet me vendimin për ulje të takës së automjeteve në 50%, e cila mendoj se do ta lehtësojë ngarkesën e madhe të mërgimtarëve.

Kjo taksë, ashtu siç edhe jemi të informuar, i ka dekurajuar në masë të madhe bashkatdhetarët dhe ka qenë barë e rëndë për ta.

Megjithatë, mendoj se për shkak të fluksit të madh të bashkatdhetarëve, të cilët priten të hyjnë në Kosovë, mendoj se është e nevojshme që ata të ndihmohen nga shteti dhe të krijohen edhe lehtësira të tjera për ta.

Janë pritje disaorëshe në kufi, zvarritja në rregullim të dokumentacionit, pritja nëpër sportele, janë vetëm disa nga barrierat me të cilat ata ballafaqohen. Prandaj, unë mendoj se institucionet duhet të merren seriozisht me ta.

Administrata komunale mendoj se duhet t'i rrisë kapacitetet dhe t'i zgjasë orët e punës, që të plotësohen nevojat e mërgimtarëve për t'u pajisur me dokumente të shumta.

Mërgata kosovare mbetet edhe më tutje njëri ndër kontribuuesit më të mëdhenj të Buxhetit të shtetit të Republikës së Kosovës. Prandaj, konsideroj se institucionet e kanë obligim që mërgimtarët t'i trajtojnë me dinjitet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sadri Ferati e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
Unë sot desha ta ngre një çështje që këto ditë është shndërruar në një temë dhe bëhet fjalë për rivarrimin e eshtrave të Isa Boletinit dhe bashkëluftëtarëve të tij, për të cilën gjithçka ishte përgatitur që pikërisht me rastin e 99-vjetorit, pra më 23 janar të këtij viti, të ndodhë rivarrimi

dhe vendosja e eshtrave aty ku paraprakisht ishin përgatitur edhe varret, pra në oborrin e Kullës së Isa Boletinit. Asgjë më legjitime, më e natyrshme dhe e drejtë se të ndodhë një diçka e tillë.

Prapë u tha që për shkaqe objektive nuk do të mund të ndodhë rivarrimi në janar, por se ajo punë është shtyrë për datën 10 qershor, një datë po ashtu e madhe, me që lidhet me Lidhjen e Prizrenit. Dhe, tash këto ditë pa shumë shpjegim e kemi një vendim të Këshillit Organizativ që rivarrimi i eshtrave të ndodhë, por të ndodhë në Vlorë.

I gjithë opinioni është i papërgatitur ngase ka pasur shumë pak shpjegime për arsye pse po ndodh kjo dhe e ka krijuar një pakënaqësi të gjerë te qytetarët dhe sidomos në regjionin e Mitrovicës që me padurim e kanë pritur kthimin e eshtrave të kolosit Isa Boletini dhe bashkëluftëtarëve në vendlindjen e tij.

Unë mendoj se edhe pse është thënë e ekziston një vendim edhe pse ka pasur edhe kontakte me autoritetet nga Shqipëria, mendoj se nuk është vonë që kjo çështje të diskutohet dhe të merret një vendim po aq sa është i drejtë po aq edhe që i del hakut edhe veprës edhe gjithë opinionit, veprës së Isa Boletinit por edhe opinionit në Mitrovicë.

Prandaj, duke konsideruar se ky është një veprim i ngutshëm, një veprim i cili ka promblematizuar, i cili e ka ngrehur në këmbë gjithë opinionin në Mitrovicë dhe më gjerë, unë mendoj se në këso situatash i takon secilit trup, pra edhe Këshillit Organizativ, edhe Qeverisë dhe institucioneve tjera, që edhe një herë ta rishqyrtojnë këtë çështje dhe të marrin vendim të arsyeshëm. Dhe, unë mendoj se vendimi i arsyeshëm është kthimi i mbetjeve mortore, pra të eshtrave të Isa Boletinit dhe bashkëluftëtarëve në komunën e Mitrovicës. Pra, në oborrin e Kullës së Isa Boletinit, apo në Parkun Memorial, i cili është emëruar me emrin e Komandantit Isa Boletini.

Prandaj, unë mendoj se ky nuk është vetëm mendim imi, nuk është mendim i shumicës së kolegëve që unë i kam konsultuar, por është mendim i shumicës së qytetarëve dhe sidomos i institucioneve dhe qytetarëve të komunës së Mitrovicës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Ferati! Albin Kurti e ka kërkuar fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
22 veta u vranë e 26 u arrestuan nga luftimet në Kumanovë gjatë fundjavës së shkuar dhe fillimit të kësaj jave. Sipas raportimit të mediave, duket se së paku dy qytetarë të Kosovës u vranë pasi u kapën robër dhe pasi ishin çarmatosur. Humbje e dëme të mëdha njerëzore e materiale, si dhe shkelje të shumta të të drejtave të njeriut u shënuan në Kumanovë këto ditë.

Mirëpo, partnerët e koalicionit qeverisës në Kosovë dje nuk lejuan debat në Kuvendin e Kosovës. Të gjitha deklaratat e krerëve institucionalë në Kosovë për ngjarjet në Kumanovë ishin deklarata të njerëzve që mendojnë për veten e tyre, e jo për Kumanovën dhe shqiptarët atje. Kështu, presidentja Jahjaga dhe kryeministri Mustafa i dënuan shtetasit e Republikës së Kosovës të përfshirë në incidente në Maqedoni, ministri i Jashtëm Thaçi me gjuhë edhe më të ashpër e dënonte cenimin e rendit dhe sigurisë në Maqedoni, ndërkaq kryetari i Kuvendit, Veseli, shprehte

besimin e tij në vullnetin e kapacitetet e shtetit maqedonas. Mbi të gjitha, asnjëri prej tyre nuk e dënoi regjimin autokratik të Gruevskit, i cili me kryespiunin Mihalkov e kryepolicen Jankulovska është dëshmuar për qëndrimet e veprimet e tyre antidemokratike e antishqiptare. Ambasadorë të ndryshëm perëndimorë, e posaçërisht zoti Erwan Fouere, e tejkaluan edhe çdo fjalor diplomatik në përshkrimin negativ të Gruevskit dhe shpurës së tij. Mirëpo, këtë nuk e bënë edhe krerët e shtetit të Kosovës. Përkundrazi!

Unë jam i bindur që shumica e deputetëve në Kuvendin e Kosovës nuk mendojnë si këta, se ju përgjithësisht nuk ndiheni të përfaqësuar me ato deklarata dhe se kjo është një arsye e fuqishme politike dhe institucionale që e bën debatin për ngjarjet në Kumanovë të domosdoshëm në Kuvend, por njëkohësisht është edhe arsyeja pse këta nuk e lejuan këtë debat.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Karakterin dhe orientimin e shtetit të Maqedonisë nuk mund ta kuptojmë pa ndikimin e Serbisë dhe interesat e saj. Dallimi ndërmjet Gruevskit dhe Georgievskit është si dallimi ndërmjet Serbisë dhe Bullgarisë. Se Serbia shfaqet si protektore e Maqedonisë e kemi ditur edhe nga historia, edhe e kanë thënë vetë krerët e Serbisë shpesh. Për shembull, në vizitën dyditore të ish-kryeministrit të Serbisë, Ivica Daçiq, në Shkup, na janar të vitit 2013, ai pati deklaruar. “Maqedoninë nuk e kërcënon kurrfarë rreziku nga veriu, as për ekzistencën dhe as për identitetin e saj, kurse Serbia mund vetëm të ndihmojë nëse ai rrezik kërcënon prej ndonjë ane tjetër”. Daçiq bën një pauzë cinike dhe vazhdon “në kuptimin politik, natyrisht”.

Në po të njëjtën ditë, kur Gruevski po e mirëpriste Daçiçin në Shkup, ministri i Jashtëm rus, Sergej Lavrov, po e mirëpriste ministrin e Jashtëm maqedonas, Nikola Popovski, në Moskë. Vështirë të ketë qenë koincidençë protokollesh e gjithë kjo.

Jo vetëm me Republikën serbe në Bosnjë, por , Serbia bashkëpunon edhe me Maqedoninë më shumë sesa Kosova me Shqipërinë. Më 16 shkurt 2015, Qeveria e Serbisë dhe ajo e Maqedonisë e patën diskutuar kompletimin e Korridorit X deri në shtator 2016, ndërtimin e largpërçuesit elektrik 400 kW ndërmjet Nishit e Shkupit, që do të hapet në dhjetor të këtij viti, si dhe ndërtimin e lidhjes së gazit Vranjë-Kumanovë dhe të të gjitha lidhjeve hekurudhore me Greqinë.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Nuk do të mund të mbijetojnë edhe regjimi i Gruevskit, edhe shteti i Maqedonisë. Sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë në Maqedoni, shqiptarët përbëjnë mbi çerekun e banorëve të Maqedonisë, ndërkohë që numri i tyre realisht sillet mbi një të tretën e popullsisë.

Numri i të punësuarve shqiptarë në ndërmarrjet publike dhe Administratën shtetërore është rregullisht nën 10%, kurse për pozitat udhëheqëse ai bëhet pothuajse i papërfillshëm.

Dihet se shifra “20%” është shprehja më e shpeshtë në tekstin e Marrëveshjes së Ohrit, mirëpo nga pushteti i Gruevskit kjo merret si shtysë e motiv për t’i zbritur shqiptarët kudo nën 20% të popullsisë, e jo për t’ua rritur atyre të drejtat, meqë përbëjnë mbi 20% të popullsisë në aq shumë vendbanime. Nëse nuk do të mund t’i dëbojë plotësisht shqiptarët nga Kumanova, shtettrrethimi i Gruevskit atje do që shqiptarët në komunën e Kumanovës t’i zbresë nën 20%. Kumanova e lidh

Luginën e Preshevës me Shkupin, prandaj Gruevski e Vuçiqi duan ta zbrazin sa më shumë atë nga popullsia shqiptare.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

E ardhmja e rajonit të Ballkanit Perëndimor, që nuk është e integruar në Bashkimin Evropian, nuk po duket aspak e ndritshme. Në vend se të kemi debosnjëzim të Bosnjës, po rriten gjasat për tri Bosnjë në rajon: Bosnja si Bosnjë, Kosova si Bosnja e pasluftës me “Zajednicën” e instaluar, dhe Maqedonia si Bosnja e paraluftës, me regjimin e Gruevskit. Nëse nuk e rimendojmë Ballkanin Perëndimor, nga hegjemonia e Serbisë dhe elitat e korruptuara gjithandej, Ballkani Perëndimor po shndërrohet në një Lindje të Mesme të Evropës, e para portave të Bashkimit Evropian.

Populli ynë po i diskuton këto tërë kohën e gjithandej. Deputetët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoja fjalën!

ALBIN KURTI: Populli po i diskuton këto tërë kohën gjithandej. Deputetët janë zëvendësit e popullit, edhe sipas etimologjisë së fjalës “deputet”. Pra, ne këtu e zëvendësojmë popullin, sepse kjo sallë nuk i zë dy milionë njerëz, por i zë 120 sish.

Dhe, teksa populli nuk ndihet i përfaqësuar as me një debat në Kuvendin e Republikës për gjendjen në Kumanovë, mund të themi që ne si deputetë nuk e përfaqësojmë popullin as sa për sy e faqe. Faleminderit!

KRYETARI: Tani në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar kolegë deputetë,

U diskutua edhe më herët, por dëshiroj të ritheksoj që është urgjente që Kuvendi i Kosovës të ndërmarrë vendime dhe të kërkojë nga Qeveria që ta tërheqë një vendim absurd për ta rivarrosur heroin kombëtar Isa Boletinin jashtë Kosovës.

Kjo flet për maturinë e Ekzekutivit të vendit, që me veprimet e veta po i fyen, jo vetëm të gjallët, por edhe të vdekurit.

Besoj se në këto dy ditë, mbarë opinionin në Kosovë, por edhe jashtë, e arsyetoi mjaftueshëm pse eshtrat e heroit duhet të varrosen në Boletin.

Duke filluar nga fakti se kulla dhe varri i hapur në oborrin e shtëpisë së tij janë testament që e ruan kjo kullë ndër breza dhe simbol i luftës sonë kundër tkurrjes së territorit dhe luftës për çlirim, e deri te realiteti i sotëm i hidhur, kur ende 15 vjet pas luftës së fundit në Kosovë nuk jemi zot të shtëpisë në shtëpinë tonë, flet për faktin se kjo Qeveri ka dështuar.

Heronjtë kombëtarë si Isa Boletini, e më pas Adem Jashari, Luan e Shkëlzen Haradinaj, Zahir Pajaziti e mijëra gra e burra të rënë ndër shekuj, meritojnë që të paktën të prehen në paqe në dheun e Kosovës. Për këtë luftuan dhe për këtë ranë.

Lojërat e Ekzekutivit, ku përditë po nëpërkëmbet vullneti i qytetarëve të shumicës dhe ku përditë po i nënshtrohen diktatit të pakicës, flasin për mungesën e vizionit për ndërtimin e një shteti modern, ku respektohet Kushtetuta dhe ku sovraniteti i vendit nuk falet përditë.

Me këtë rast, nëpërmjet folklorizmit patriotik po mundoheni ta mbuloni dështimin e radhës për t'u sjellë si shtet brenda territorit të shtetit.

Të gjithë tani po i dinë arsyet e këtij vendimi, e i dini edhe Ju!

Unë e thërras këtë Kuvend që sot të reflektoj dhe të kërkojmë si institucion ligjvënës nga Qeveria e vendit që ta tërheqë vendimin e marrë dhe të veprojë konform kërkesave të qytetarëve, që vullneti i shumicës e përcakton.

Ju zotërinj, të cilët edhe sot po mungoni, nuk keni të drejtë të silleni si pronar të Kosovës, dhe nëse me gjithë vullnetin e shumicës së qytetarëve të Kosovës, rreth 1 kilometër prej Prishtinës, e vendosët bustin e Milosh Obiliqit, atëherë gjejeni guximin brenda vetës dhe varrosini eshtrat e heroit kombëtar në Mitrovicën e tij, në Mitrovicën e Kosovës, e cila nuk është veç e Qeverisë dhe nuk është aspak e Qeverisë, sepse nuk po mbërrin ta shtrijë sovranitetin dhe integritetin atje dhe me 10 qershor, në ditën e Lidhjes së Prizrenit, të paktën një herë veproni si i ka hije Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Tani në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, fjalën e ka Valdete Bajrami. Atëherë më fal, se jeni lajmëruar dy. Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Pa diskutim se nuk do të largohemi nga çështja preokupuese për të gjithë qytetarët, e veçanërisht për ne deputetët, ajo që ka ndodhur dhe që është duke ndodhur në Kumanovë dhe në Maqedoni me bashkëkombësit tanë.

Kumanova ishte një storie jo e këndshme, jo vetëm për Maqedoninë dhe Kosovën, por edhe për rajonin dhe pretendimet e arsyeshme për integritet evropian të këtij rajoni.

Dhuna e paparë e shfrenuar shtetërore ndaj një lagjeje të banuar kryesisht me shqiptarë e tregoi edhe një herë mungesën e demokracisë që ekziston brenda institucioneve të vendit fqinj, institucione të cilat çdo ditë po e dëshmojnë shizofreninë nga e kaluara karshi qytetarëve shqiptarë në atë shtet.

Brenda një periudhe kaq të shkurtë mbi 22 të vrarë, mbi 30 të plagosur, 60 shtëpi të shkatërruara, pamje si e luftërave të Vukovarit, apo të Drenicës nga regjimi fashist i Milosheviqit, janë një dëshmi e mjaftueshme që ne si të zgjedhur të qytetarëve të kemi qëndrim pas një debati që, për fat të keq, po ngulfatet këtu në Parlament.

Thënë të drejtën, edhe insistimi ynë i djeshëm ka pasur të bëjë me atë se zyrtarët përgjegjës të shtetit të Kosovës nuk janë prononcuar konform situatës reale që ekziston me shqiptarët në Maqedoni dhe faktikisht mendojnë se ka mungesë të sensit për ta studiuar e analizuar dhe për të dhënë qëndrime të sakta për çështjet e caktuara dhe ndoshta është keq të thuhet, por deklarata e ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë duhet të jetë model se çfarë qëndrimi duhet të mbajnë zyrtarët e shtetit të Kosovës për çështje të caktuara, në këtë rast për Kumanovën.

Mungesa e debatit natyrisht po dyshoj se po bëhet me qëllim, për shkak se sigurisht pas një debati do të dilnin përgjegjësitë që i kanë institucionet e sigurisë së vendit karshi ngjarjes së Kumanovës dhe në këtë rast, në bazë të asaj sa dimë dhe sa është publike Kryeministri, Presidentja, ministri i Punëve të Brendshme dhe organet tjera kanë qenë në dijeni për një skenar, i cili ka ndodhur në Kumanovë, e në këtë rast po besoj se duke i ikur një debati konstruktiv në Parlament, është duke u tentuar t'i iket edhe përgjegjësisë që kanë organet e sigurisë së vendit karshi ngjarjes në Kumanovë, karshi një ngjarjeje në të cilën janë të implikuar edhe qytetarët e Kosovës, ndaj të cilëve kemi përgjegjësi institucionale dhe ligjore në momente të caktuara. Mosndërhyrja ose mosmarrja e masave paraprake të bën të dyshosh me të drejtë se mekanizma të caktuar brenda organeve të sigurisë janë pjesë e këtij skenari.

Prandaj, më lejoni edhe si deputet, edhe si Grup Parlamentar, por edhe si qytetarë të kërkoj përgjegjësi të veçantë deri në dorëheqjen e ministrit të Punëve të Brendshme, i cili është bashkëpërgjegjës për shkak të mosangazhimit të tij konform ligjit në ngjarjet e Maqedonisë dhe meqë është bashkëpërgjegjës për atë që ka ndodhur atje, pasi ka pasur informacione, është shumë njerëzore dhe etike që ai njeri të largohet nga pozicioni dhe të japë përgjegjësi ligjore para organeve të duhura. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, Mexhide Mjaku e ka kërkuar fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në kujtesën tonë janë të njohura format e veprimit dhe krijimi i preteksteve për vrasje, ekzekutime dhe shfarosje në masë të shqiptarëve nga pushtuesit serb në periudhën 90-vjeçare të okupimit të Kosovës.

Kujtesa historike na kthen në vitet '45, kur po ky pushtet, në pretekstin e luftimit të reaksionit, e zhvilloi masakrën e tmerrshme të Tivarit, duke vrarë 4 mijë djem të rinj shqiptarë, të cilët barabar me të tjerët e luftuan fashizmin, duke besuar në lirinë dhe të drejtën e vetëvendosjes së popujve. Në luftën e fundit, prapë u vazhdua me masakra të shumta anembanë Kosovës, e ndër to edhe masakra në Burgun e Dubravës.

Fundi i prillit të vitit 1999 shënon kohën ku Serbia e ndërmori një aksion të përmasave të gjera, e që kishte qëllim grumbullimin e të gjithë shqiptarëve në Burgun e Dubravës, në Istog. Apo më saktë, dërgimin e të burgosurve shqiptarë në kasaphanën që Serbia e kishte përgatitur për ta. Brenda një kohe të shkurtër Serbia arrin ta popullojë Burgun e Dubravës më afro 1 mijë të burgosur. E bëri këtë, sepse Serbia kishte informacione të sakta se bombardimi i Dubravës do të ndodhte.

Pati të burgosur, të cilët janë sjellë në Burgun e Dubravës drejtpërdrejt nga salla e operacionit të spitalit të burgut qendror të Beogradit, akoma pa i lëshuar anestezionin. Për disa javë, mbi të burgosurit shqiptarë u zbatua një trajtim i egër çnjerëzor dhe barbar. Ky trajtim mizor deri në ditën e zhdukjes së tij u bë edhe mbi intelektualin, profesor Ukshin Hotin.

Serbia e dinte kohën e bombardimeve, e dinte edhe ditën. Një i burgosur shqiptar i mbijetuar i masakrës, në deklaratën dhënë për Fondin për të Drejtat e Njeriut, kishte thënë: “Në orët e mëngjesit, disa të burgosur ordinerë, me shkopinj të gjatë ishin parë nëpër pemë, duke thyer degët e pemëve të sapogjellbëruara. Pemët e thyera ngjasonin sikur mbi to të kishte rënë ndonjë ciklon, apo tornado. Ambienti duhet të ngjasonte sikur në këtë vend vërtet kishte pasur bombardime të tmerrshme, sa edhe pemët ishin zhveshur nga granatimet e shumta. Dhe, pas dy orësh vërtet ranë bombat e para. Me këtë krijohen edhe kushtet për realizimin e skenarit kaheër të përgatitur nga shteti serb”.

Informatat operative të deritashme tregojnë se në agimin e 22 majit 1999, Burgu i Dubravës ka qenë praktikisht nën kontroll të njësive të veçanta policore, anëtarët e të cilëve janë radhitur brenda kompleksit të burgut, pasi janë konsultuar me Drejtorinë e Burgut.

Ata janë shoqëruar nga të dënuar serbë të armatosur. Se si ka ndodhur masakra mbi të burgosurit jemi në dijeni të gjithë nga të mbijetuarit e saj, e të tillë kemi edhe në mesin tonë.

Masakra e Dubravës për nga përmasa dhe veçanërisht për nga përmbajtja e dhembshme është pa dyshim njëra ndër tragjeditë më të tmerrshme që njih historia e njerëzimit. Shumë njerëz gabojnë kur thonë se numri i të vrarëve në këtë masakër nuk mund të jetë argument i mjaftueshëm që ajo të radhitet në mesin e tragjeditë më të tmerrshme. Pikërisht, ana përmbajtësore është ajo që këtë tragjedi e veçon nga shumë tragjedi të tjera më të mëdha në përmasa sasiore.

Fatmirësisht, shumica e dëshmitarëve, viktimat shqiptare të mbijetuar në masakrën e Dubravës janë ende gjallë dhe lehtë të arritshme për dëshmi. Po ashtu, fatmirësisht, edhe ekzekutorët e drejtpërdrejtë janë gjallë, së paku shumica prej tyre dhe lehtë të arritshëm, së paku, për drejtësinë ndërkombëtare.

Në cilësinë e të akuzuarve për gjenocid, lista e të akuzuarve nis nga kreu i atëhershëm i shtetit serb, e deri te gardiani i fundit në Burgun e Dubravës, që kreu gjenocid. Natyrisht, nuk duhet harruar edhe civilët serbë që ishin të dënuar, të cilët të joshur me favore nga shteti i tyre u armatosën dhe qëlluan mbi pengjet shqiptare të pambrojtura.

Në rrethana tjera, sot institucionet e Kosovës janë të maturuara dhe të pavarura për t'i nisur procedurat e identifikimit dhe të ndëshkimit të fajtorëve të masakrës së Dubravës. Pengjet e mbijetuara, jo vetëm të masakrës së Dubravës, duhet t'i drejtojnë dëshmitë tek gjykatat përkatëse në Kosovë. Po ashtu, duhet të dërgohen dëshmitë me qëllim të ndriçimit të krimeve edhe në adresat ndërkombëtare, siç janë Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Komiteti i OKB-së Kundër Torturës, zyrtat e burrështetasve të vendeve të fuqishme të botës, intelektualët eminentë botërorë etj.

Një masakër që akoma është e freskët në kujtesën shoqërore, një masakër së cilës i dihen me emër dhe mbiemër kush ishin masakruarit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, regjia vazhdoja fjalën!

MEXHIDE MIAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

... dhe kush të masakruarit e të persekutuarit i duhet vetëm një nismë e mbarë shtetit tonë për të ngrehur padi penale kundër shtetit serb për gjenocidin e planifikuar dhe të ushtruar kundër të burgosurve shqiptarë.

Natyrisht, institucionet tona duhet të punojnë ngushtë me faktorin ndërkombëtar, në mënyrë që këta ta detyrojnë Serbinë t'i ofrojë dosjet dhe dokumentet e tjera për pjesëmarrësit në masakrën kundër pengjeve shqiptarë të masakrës së Dubravës.

Me këtë, fajtorët do të silleshin para drejtësisë me akuzën e qëndrueshme juridikisht për masakër të parashikuar ndaj pjesëtarëve civilë të një populli tjetër. Duke ditur se qëllimi i fundit ka qenë vrasja totale e të gjitha pengjeve në Burgun e Dubravës, duke i ditur paraprakisht emrat e atyre që e kanë administruar burgun dhe emrat e ekzekutorëve të masakrës, juridikisht krijohet bazë e mjaftueshme që vetë shteti serb të akuzohet për gjenocid apo tentim gjenocidi ndaj popullit shqiptar.

Për fund, nuk duhet hequr asnjëherë nga mendja shfrytëzimin e njerëzve tanë të artit dhe të kulturës me ndikim botëror në fushën e letërsisë, medias e filmit. Masakra e Dubravës meriton të jetë pjesë e një projekti hollivudian, sepse sot në botë kjo është një dritare e fuqishme komunikimi dhe mënyrë e duhur e plasimit të realitetit në opinion publik botëror. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Melihate Tërmkulli.

MELIHATE TËRMKULLI: Faleminderit!

Shumë shkurtimisht do t'i them dy-tri fjalë.

Javën e kaluar, një deputet këtu nga Partia Demokratike, zoti Azem Sylja, e bëri njëfarë shpifjeje ndaj meje, po e bëri atë shpifje s'kemi çka t'i bëjmë. I përmendi disa helikopterë, diçka. Unë nuk e di, nuk e di për kënd e ka pasur fjalën, por i kam pas vetëm një 16 vjeç atëherë. Bën vaki më ka dërguar kush në helikopter, një Zot e di.

Unë veç mund të shpreh keqardhje, vërtet më vjen keq se në çfarë derexheje kanë ardhur njerëzit këtu. Të bien në këtë derexhe në Parlamentin e Kosovës nuk është mirë, e unë do ta ndjek rrugën ligjore, rrugën e drejtësisë gjyqësore.

Në fakt, më tepër që dola të flas, pa tingëlluar si shumë patriotike, desha t'i them një dy fjalë, sepse kjo kërkon drejtësi, siç do të duhej të ishte.

Isa Boletini, u tha edhe nga shumë kolegë këtu, duhet të riarroset në vendin e vet, në Kullën e Boletinit. Nëse kjo nuk bëhet atje, kjo do të thotë se, pasi në këtë vendim është i përfshirë

zëvendëskryeministri, Qeveria pra ka hequr dorë nga Veriu dhe nëse nuk e konsideron këtë pjesë të Kosovës. Nëse është kështu, institucionet e Kosovës, qytetarët e Kosovës duhet të informohen.

Pra, qytetarët e Kosovës duhet të informohen çka fshihet pas vendimit për rivarrosjen e eshtrave të Isa Boletinit në Vlorë. Po nxjerrin pallavra ‘jo janë toka shqiptare, jo njëra, jo tjetra’.

Isa Boletini ka luftuar për shqiptari, por ka luftuar edhe për Kosovë dhe natyrisht me këtë rast duhet t’i falënderojmë shumë të gjithë ata që kanë punuar me sakrificat më të mëdha në kohën e okupimit të Kosovës për gjetjen e eshtrave të tyre, një grup i njerëzve, në krye me profesor Muhamet Shukriun, që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm dhe pas krejt asaj sakrifice, sot në Kosovën e lirë, të pavarur, demokratike të merren e të dërgohen eshtrat në Vlorë, singërisht kjo nuk ka asnjë kuptim. Nuk e di çfarë kuptimi ka. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismajl Kurteshi nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Vitin që shkoj, me arsyetimin e zgjedhjeve të përgjithshme, që do të ndodhnin në qershor, u përshpejtua procesi në sistemin e arsimit parauniversitar.

Një prej këtyre proceseve që edhe organizimit të testit të arritshmërisë për klasat e nënta t’i ndërrohet vendi, i cili u afrua me kohë me këtë motiv për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme dhe thuhej se nevojiten ambientet shkollore për këtë proces.

Këtë vit, edhe pse nuk ka asnjë arsye të vlefshme, përkundrazi sërish testi po organizohet para se të mbarojë viti shkollor. Ministria e Arsimit ka planifikuar që testin e arritshmërisë për klasat e nënta të mbahet më 22 maj 2015, ndërsa viti i rregullt shkollor për të njëjtën nxënëse do të përfundojë më 2 qershor të vitit 2015.

Vitin e kaluar po ashtu e kanë organizuar në të njëjtën kohë me arsyetimin që e përmenda më lart. Është absurde që Ministria e Arsimit të lejojë që testi i arritshmërisë për klasën e nëntë të mbahet para përfundimit të vitit shkollor. Ky është një çrregullim që prek të gjithë nxënësit e Kosovës, pra rreth 30 mijë fëmijë tanë do të testohen edhe për njohuritë që ende nuk i kanë marrë, si dhe nuk do t’u lihet kohë që të përgatiten për këtë test.

Se cili është qëllimi që i shtyn kompetentët ta çrregullojnë gjithë sistemin në këtë mënyrë, mund ta kuptojë vetëm Ministria e Arsimit, në krye me ministrin Bajrami, por jo edhe mësuesit, nxënësit e prindërit e këtij vendi. Gjithashtu, nuk është në rregull që testimi të mbahet ditëve të mësimi, sepse e çrregullon procesin mësimor nëpër shumë shkolla, përkatësisht shumë shkolla humbin mësim për shkak të mbajtjes së testit në ambientet e shkollave të tyre.

Së pari, testimi do të duhej të organizohej gjatë ditëve të fundjavës, qoftë kjo me rastin e testit të arritshmërisë, qoftë me rastin e testit të maturës. Ministria e Arsimit duhet urgjentisht të marrë vendim që ta anulojë menjëherë dhe pa dyshim datën e 22 majit, të caktuar për mbajtjen e këtij testi dhe testin e njëjtë ta organizojë pas përfundimit të vitit shkollor, në kohën kur nxënësit kanë kohë që të përgatiten dhe nuk pengohet procesi mësimor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Valdete Bajrami e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Para se ta filloj fjalimin tim, po e shpreh edhe një herë keqardhjen time se pikërisht mosprania e Kabinetit qeveritar është një neglizhencë ndaj këtij Kuvendi, ndaj deputetëve, por edhe ndaj qytetarëve.

Unë sot dua ta ngre një çështje që ka të bëjë infrastrukturën në rajonin e Anamoravës. Të udhëtosh nëpër disa rrugë nga qytetet e Kosovës deri diku thuajse janë të rregulluara, e besa diku edhe më mirë, por shqetësimin tim dua ta ndaj me ju për rrugët të cilat e lidhin kryeqytetin dhe të gjitha rrugët tjera me Anamoravën.

Në rast se dikush nuk e di se në infrastrukturën rrugore në Anamorava nuk është bërë asnjë investim. Rrugët si ajo Gjilan-Prishtinë, Gjilan-Ferizaj, Gjilan-Dheu i Bardhë, Gjilan-Viti, Gjilan-Zhegër, të gjitha janë në gjendje tepër të rëndë dhe të cilat përbëjnë rrezik shumë të madh për të gjithë shoferët, por edhe për këmbësorët.

Këto po i përmendi për të gjithë ata që nuk e kanë frekuentuar këtë pjesë të Kosovës. Edhe t'ju tregoj që asnjë pjesë e Anamoravës nuk i ka rrugët e rregulluara. Unë sot nuk po diskutoj diçka që ju nuk e dini, se jeni dëshmitarë në rrugën Gjilan-Prishtinë, pikërisht te Liqeni i Badocit një pjesë e saj është tërësisht e shkatërruar dhe paraqet rrezik për të gjithë ata qytetarë, të cilët e frekuentojnë dhe po ashtu duhet që të ndërmerren hapa që sa më parë diçka të bëhet në përmirësimin e të gjitha rrugëve të Anamoravës, por konkretisht në të gjitha rrugët e Gjilanit.

Ata të cilët udhetojnë përgjatë kësaj rruge, e po në vendin tek ura e Badocit, është bërë tepër i rrezikshëm udhëtimi, pasi asfalti është shembur dhe kjo nuk është prej një jave, apo prej një muaji, por kjo shembje e rrugës është me muaj të tërë. Në atë gjendje ende nuk ka asnjë përmirësim në atë pikë. Andaj, i bëj thirrje ministrit që sa më parë të merret me ndërtimin e rrugëve në gjithë Anamoravën, se me të vërtetë një vend si Gjilani, me gjithë atë rrethinë, besoj që qytetarët e kësaj ane e meritojnë ta kenë një infrastrukturë rrugore, së paku sikur qendrat e tjera në tërë Kosovën.

Merruni, zoti ministër, edhe me atë pjesë të vendit, se edhe ajo është Kosovë, duke e ditur rëndësinë e Gjilanit si pikë strategjike që mund të jetë për zhvillimin ekonomik dhe për tërë vendin, andaj filloni t'i kushtoni kujdes Anamoravës, se ju e dini se çfarë rëndësie strategjike ka lidhja e Gjilanit me Preshevën, Medvegjën, Bujanocin, por edhe me Kumanovën. Andaj, ju bëj thirrje që sa më parë ta keni parasysh t'i evitoni ato rreziqe që i sjell ajo rrugë, por duhet edhe të mendohet se në rast se investohet në infrastrukturën rrugore, ajo do të sjellë shumë përfitime, por edhe me rregullimin me kohë të asaj rruge ju mund ta shmangni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia ju lutem, fjalën!

VALDETE BAJRAMI: ... ndonjë aksident, i cili do të çonte deri në fatalitet.

Po ashtu, nga këtu e bëj një thirrje edhe për kryetarin e Komunës së Gjilanit, le të vendosë njëherë e mirë nëse do të merret me qytetarët e Gjilanit, apo do të merret me partinë e tij. Sipas të gjitha gjasave, ai i ka ambiciet që të jetë këtu në Prishtinë, por ju kisha lutur që t'i marrë seriozisht të gjitha kërkesat e qytetarëve të Gjilanit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zenun Pajaziti, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Po e marr fjalën për një çështje që u shtrua sot këtu, edhe në seancën e kaluar, çdo vit në këtë periudhë, për vite me radhë, shtrihet çështja e polisave kufitare që janë si ngarkesë, sidomos për bashkatdhetarët tanë.

E mirëprita edhe unë zbritjen 50% të kësaj takse, por vlen të theksohet që aq shume si shumë materiale, kjo është edhe ngarkesë administrative, procedurale, burokratike për qytetarët tanë që vijnë këtu dhe që duhet ta paguajnë dhe të ndalen e të merren me këtë burokraci.

Po ashtu, zoti Osmani javën që kaloi na i prezantoi disa të dhëna edhe për procesin. Ne e dimë që Kosova nuk është ende pjesë e Kartonit të Gjellbër, por duhet ta dimë që shumica e fondit që mbledhet nga kjo taksë në vit, sa unë kam marrë informata kur e kam shtruar viteve të mëparshme, ka qenë diku 10 deri 15 milionë. Prej tyre as 10% nuk shfrytëzohen për dëmet që shkaktohen nga ata që e paguajnë këtë taksë, që do të thotë që kjo zbritje nuk është ende në përputhje me ato çka shpenzohen. Mendoj që kjo zbritje duhet të jetë edhe më madhe dhe po ashtu nuk duhet të hiqet dorë që Kosova sa më shpejt të bëhet pjesë e Kartonit të Gjellbër dhe të hiqet përfundimisht krejt kjo.

Dëshiroj, po ashtu, t'i propozoj Qeverisë, meqenëse tash janë dy ministra këtu, që t'i lansojë disa fonde shtesë për bashkatdhetarët, për disa aktivitete qendrore gjatë këtij viti dhe po ashtu disa fonde për komunat, për disa komuna, të cilat fondin e vetëm gati e kanë për mbijetesën dhe mirëqenien e qytetarëve nga fondet që vijnë, nga paratë që vijnë nga bashkatdhetarët gjatë verës. Faleminderit!

KRYETARI : Faleminderit! Kujtim Paqaku është diskutuesi i fundit.

KUJTIM PAQAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E mora fjalën për ta treguar shqetësimin e komunitetit rom, i cili tani e 15 vjet ende s'po mund të punësohet, ende nuk po realizohet Ligji mbi shërbimin civil, përkatësisht të punësuarit, meqë sipas statistikave tona vetëm 0,01% janë të punësuar. Kemi përcjellë konkurse të shumta edhe në Polici, edhe në Dogana, pjesëtarët e komunitetit rom, edhe në disa raste në të cilat i kanë plotësuar kushtet, nuk janë pranuar.

Shkaku tjetër ende po vazhdon me temp më të shpejtë - shkyçja e rrymës kolektive nëpër rrugët apo në mëhallët e romëve, ku mund t'i gjejmë 2-3 të cilët nuk e kanë paguar rrymën, por është absurd që të bëhet shkyçja kolektive e pjesëtarëve të komunitetit, gjë që ai numër prej 33

mijërave, besoj që duhet të jetë 330 mijë, ngase romët nuk janë regjistruar në atë peticion, kështu që bëj lutje që së paku personave të cilët janë përfitues të skemave sociale të mos u ndërpritet rryma elektrike.

Tjetër? Shumë romë në periudhën e fundit kanë ngelur pa skema sociale, sepse në familjet e tyre nuk ekzistojnë fëmijë nën moshën 5-vjeçare. Andaj, romët tani duhet menduar për fëmijën tjetër të ri, kështu që të rritet nataliteti i komunitetit, që nuk ka nevojë, kështu që apeloj që Qeveria të ketë më tepër sens për komunitetin rom që të ndërrohet ky ligj, sepse për ta përfituar skemën programore në familje njëri prej kushteve është që ta keni një fëmijë nën moshën 5-vjeçare.

Tek shumë familje rome nuk po mund të plotësohen këto kushte dhe po ngelen pa skemën e ndihmës sociale. Ky është shqetësim i komunitetit, me të cilin jemi në bisedime. Po ashtu një trend i ri, nëpër spitalet e Kosovës tani pozita e pastruesve po privatizohet, kështu që shumë romë kanë pësuar ndryshime të vendeve të punës, si në Spitalin Regjional të Prizrenit, ku pas 30 vjetëve tani bëhet ndërrimi i vendit të punës, kështu që edhe ky problem është shumë aktual në Spitalin Regjional të Prizrenit, e kjo do të ndodhë edhe nëpër spitalet tjera, kështu që do të jetë një problem i madh që pas 25-30 vjetëve një person duhet ta ndërrojë vendin e punës, gjë që po sjellë telashe për këtë.

Besoj që Qeveria do të ketë mirëkuptim për këto shqetësime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë e kemi mbaruar edhe kohën dhe diskutimet në pikën e parë të rendit të ditës. Futemi në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare është 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 31 pyetje parlamentare. Unë do t'i lexoj pyetjet e deputetëve, në qoftë se nuk e kemi praninë e ministrave, ata deklarohen vetë nëse duan t'i lexojnë, apo i lënë për herën tjetër.

Pyetja e parë, deputetja Puhie Demaku, pyetje për zëvendëskryeministrin Hashim Thaçi.

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

Ndonëse zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme refuzon të marrë pjesë në seancat plenare të këtij Kuvendi, megjithatë do ta parashtroj këtë pyetje, të cilën e kam parashtruar kohë më parë.

Çështja është këtu se që nga viti 2013, ish-ministri i Punëve të Jashtme, tash deputeti, zoti Enver Hoxhaj, ka deklaruar edhe para mediave, edhe para Komisionit për Punë të Jashtme, se Kosova është gati për të aplikuar për anëtarësimin në Këshillin e Evropës.

Pyetja për ministrin e Jashtëm është se kur Kosova, më në fund, do të aplikojë për anëtarësim në Këshillin e Evropës? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Besa Baftija, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Vazhdojmë! Deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra, deputetë,

I nderuar ministër Kuçi,

Deri më tani janë licencuar gjithsej 25 përmbarues privatë, kryesisht në Prishtinë dhe në disa komuna të Kosovës. Sipas Ligjit për procedurën përmbarimore, Ferizajt i takojnë 4 përmbarues privatë në bazë të numrit të banorëve në këtë komunë, megjithatë nuk është asnjë i tillë. E qytetarët për ta përmbaruar një lëndë të tyre duhet të udhëtojnë deri në Prishtinë, apo edhe në komunat tjera, për ta gjetur një përmbarues, ndërkaq kjo po ua rrit edhe koston procedurale.

Është e pakuptimtë që qytetarët nga komuna e Ferizajt, me gjithë numrin e madh të juristëve, madje edhe me kuadrot e trajnuara për përmbarues, duhet që shërbimet e tilla t'i marrin nëpër komunat tjera. Zvarritja për ta pasur një zyre përmbarimore në Ferizaj është e paarsyeshme nga fakti që shumë qytetarë kanë vendime të plotfuqishme të gjykatave, kanë fatura të ndryshme të paekzekutuara dhe po presin realizimin e tyre. Dhe, pyetja për ju, zoti ministër, është: A e ka në plan Ministria e Drejtësisë ta organizojë provimin për përmbarues privatë, ku do të përfshiheshin kandidatët nga i gjithë territori i Kosovës, ashtu siç parashihet, me ligj me qëllim të krijimit të mundësive që qytetarët t'i marrin sa më afër shërbimet e tilla?

KRYETARI: Ministri Hajredin Kuçi e ka fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

E nderuara deputete Rysha, faleminderit për pyetjen!

Sa i përket organizimit të provimit për përmbaruesit privatë, më lejoni t'ju them që ne tanimë e kemi funksionalizuar këtë sistem në Republikën e Kosovës dhe po ashtu të gjitha konkurset i shpallim, përveç në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, edhe në dy gazeta ditore. Deri më tani kemi mbajtur tri provime për përmbaruesit privatë, e tani jemi në fazën e përgatitjes së provimit të katërt.

Më lejoni t'ju them që sa i përket komunës suaj të Ferizajt, që ne e kemi një komision që e bën përzgjedhjen e tyre, e ka përzgjedhur një kandidat, i cili ka refuzuar që ta kryejë punën e vet në Komunën e Ferizajt. Ne shumë shpejt do ta hapim konkursin dhe prapë do t'i japim mundësi, që dikush nga komuna juaj të konkurrojë dhe besoj, që herën tjetër do ta pranojë detyrën dikush nga ajo komunë. Faleminderit!

KRYETARI: Po, ka pyetje shtesë nga deputetja.

SYNAVERE RYSHA: Jo pyetje shtesë, po më tepër po më gëzon fakti, që Komisioni ka përzgjedhur një kandidat dhe ai ka refuzuar, në fakt, nuk është mirë që ka refuzuar, por sidoqoftë uroj që kësaj here ju të zgjidhni një kandidat, që vërtet vendosë të punojë për Ferizaj dhe

qytetarët e Ferizajt të marrin shërbimet në komunën e tyre, po edhe qytetarët e komunave tjera, që nuk kanë përmbarues në komunat e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Skënder Hyseni.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit.

Unë këtë pyetje e kam lexuar në seancën e kaluar, kështu që në këtë seancë e kam për ministrin, Arsim Bajrami. Dhe, ua kisha ditur për nder, nëse është i pranishëm dhe ma jepni fjalën.

KRYETARI: Vetëm një moment! Në qoftë se e ke pyetjen për sot, apo ke pyetje tash, e ke të parashtruar këtu te ne? Po, mund të vazhdosh.

NEZIR ÇOÇAJ: Pyetjen për Ministrin e Punëve të Brendshme...

KRYETARI: ...Po, pyetja qenka edhe për Arsim Bajramin.

NEZIR ÇOÇAJ: Pasi që nuk është ministri këtu, nëse vjen në ndërkohë do ta merrja edhe një herë, përndryshe nuk e lexoj. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, e lëmë si opion të hapur. Deputetja Shukrije Bytyqi, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Pyetjen e kam prezantuar edhe në seancën e kaluar, por përgjigje nuk kam marrë.

I kemi mbi afër 18 mijë persona me aftësi të kufizuara, 7 kategori, pa përfshirë invalidët e luftës, të cilët kërkojnë mbështetje ligjore dhe jo asistencë sociale.

Pyetja është: Ku është dhe sa u zbatua Memorandumi i mirëkuptimit mes Këshillit Drejtues të Forumit Kosovar të Aftësisë së Kufizuar të datës 6 qershor 2014, me vlerë rreth 270 mijë euro, ndërmjet FKAK-së dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe MDA-së e IP-Center për aktivitetin e kësaj kategorie.

KRYETARI: Zoti ministër nuk është këtu, deputete! Më vjen keq! Atëherë, deputeti Elmi Reçica ka pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Kur të vijë ministri do t'ia parashtroj pyetjen. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Shaip Muja, pyetje për ministrin Skënder Hyseni.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do ta pres derisa të vijë zoti Hyseni, meqenëse e interpretova herën e kaluar pyetjen dhe prita përgjigje, i dhashë një mundësi që me shkrim të ma kthejë përgjigjen, meqenëse s'po mund të vijë dhe, pasi që është zhvilluar edhe teknologjia në Republikën e Kosovës me komunikimin

3G, ju propozoj, zoti kryetar, që t'ua jepni ca telefona, bile në video-konferenca të komunikojmë me ta, se Qeveria s'e ka ndërmend fizikisht të vijë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Rregulloren e re do ta kemi shumë shpejt, mund ta fusim tele-parlamentarizmin.

Deputeti Elmi Reçica pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Vlen e njëjta, kur të vijë ministri do t'ia parashtroj pyetjen. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Realisht, pyetja ime ishte për dy çështje.

E para është për pensionet e qytetarëve tanë, të cilët kanë punuar në Zvicër dhe të cilët në vitin 2009, Qeveria zvicerane aso kohe ka marrë vendim që të mos e gëzojnë të drejtën në këto pensione, në se jetojnë në Kosovë.

Kjo vazhdon të jetë një problem, po pasi që kryeministri nuk është këtu, atëherë po e presim, ndoshta vjen dhe na tregon se deri ku ka mbërri Qeveria me këtë marrëveshje.

KRYETARI: Zonja Kadaj-Bujupi e keni edhe një pyetje menjëherë, për Isa Mustafën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Pyetja tjetër, po ashtu, lidhet me një urgjencë, po si duket Qeverisë s'po i bëhet vonë, pasi s'po vjen as në Kuvend.

Mos kompletimi i bordeve publike, sidomos me theks të veçantë i AKP-së po sjell dëme të mëdha në ekonominë e vendit tonë. Po merren vendime të dëmshme, mirëpo në mungesë të bordit, askush nuk po merr llogari dhe përgjegjësi për këto vendime. Prandaj, desha ta pyes se ku janë me procedura apo kur të vijë, ndoshta na përgjigjet.

KRYETARI: Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje, Kabinet qeveritar!

Përshëndetje, kolegë të nderuar!

Qytetarë të nderuar,

I nderuar zoti ministër,

Më 24 korrik 2014, është bërë marrëveshja për transport ndërkombëtar rrugor në Prishtinë, me shtetin e Italisë, e ratifikuar nga presidentja Jahjaga, kurse ende pa ratifikuar nga shteti i Italisë.

Çdo ditë po flasim për mbështetje të bizneseve të vogla dhe të mëdha, kurse operatorët ekonomikë kosovarë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë për transportin e pasagjerëve me autobusë në destinacion ndërkombëtar me shtetin e Italisë, janë në një situatë shumë të palakmueshme, për të mos thënë, drejt falimentimit.

Kjo është duke ndodhur pikërisht për shkak të mosveprimit të ministrive përkatëse, të cilat kanë marrëveshje bilaterale.

Kompanitë transportuese kosovare janë të detyruara të paguajnë gjoba marramendëse pas çdo kontrolli nga policia italiane, ku shuma më e vogël është 2002 euro. Arsyeja e vetme e policisë rrugore italiane është, sepse nuk ka ratifikim të marrëveshjes nga shteti i Italisë. Masat ndëshkuese të cilat janë marrë me bllokim të autobusëve, ku nga fundi i vitit 2014 muaji dhjetor, deri më tani janë bllokuar 14 autobusë, ku 4 ende janë në bllokim me nga 60 ditë.

Në qoftë se, bëjmë një llogaritje të thjeshtë, dëmet për bizneset kosovare sillen diku rreth 260 mijë euro, për të cilat janë të detyruara të paguajnë bizneset kosovare.

Zoti ministër, pyetja ime është: cilat janë masat konkrete, që i keni ndërmarrë në këtë drejtim, a keni kontaktuar me Ministrinë italiane, për të përshpejtuar ratifikimin e marrëveshjes?

Me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje ju do t'i ndihmonit bizneset kosovare, por njëkohësisht do t'i ndihmoni edhe të gjithë pasagjerët mërgimtarë që udhëtojnë me transport rrugor.

KRYETARI: Ministri Zharku e ka fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryetar,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputet Gutaj,

Më 10 dhe 11 qershor të vitit 2014, në Prishtinë është mbajtur takimi mes komisioneve teknike të Kosovës dhe Italisë për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, në të cilin është përafuar marrëveshja bilaterale, për rregullimin reciprok të transportit rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet dy vendeve.

Kjo marrëveshje e rregullon transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, që do të thotë se automjetet për transport komercial, autobusë dhe kamionë e të dyja shteteve mund të udhëtojnë dhe të kalojnë transit nëpër territoret e njërit apo shtetit tjetër, që paraqet lehtësim për qarkullimin e lirë për në vendet evropiane.

Marrëveshja për transport ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave në Republikën e Italisë është nënshkruar, siç e dini, më 24 korrik të vitit 2014, ndërsa procedurat e ratifikimit nga Republika e Kosovës janë kryer më 23 shtator të vitit 2014.

Për sa na përket ne si Ministri e Infrastrukturës, çështjen e marrëveshjes për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave midis Republikës së Kosovës dhe Italisë e kemi rumbullakësuar në tërësi dhe të gjitha procedurat tjera janë në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Megjithatë, jemi të interesuar për funksionalizimin e kësaj marrëveshjeje në vazhdimësi, nëpërmjet përfaqësuesve diplomatikë të Kosovës, konkretisht Ambasadës së Kosovës në Itali, për çështjen e përsheptimit të ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

Sipas informatave që kemi, marrëveshja ende nuk është dërguar në Parlamentin italian dhe se janë duke u bërë konsultime në Ministrinë e Financave të Italisë rreth implikimeve buxhetore të kësaj marrëveshjeje. Ambasada jonë vazhdon të ketë takime të shpeshta me palën italiane, si me Ministrinë e Punëve të Jashtme, me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë italiane të Transportit, për përsheptimin e procesit të ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

Po ashtu, në çdo vizitë të udhëheqësve të lartë nga Kosova, kjo çështje është ngritur në të gjitha programet e vizitave dhe pikat e takimeve. Herën e fundit kjo çështje është ngritur gjatë vizitës së deputetëve nga Kosova në Romë, pjesë e të cilit delegacion keni qenë edhe ju dhe ministrit për Integritet Evropian, më 9 prill 2015, në takimet e realizuara që i keni pas në Senat dhe Dhomën e deputetëve, si dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Natyrisht, ambasada jonë do të vazhdojë me punë në këtë drejtim, por këtë çështje do ta ngre edhe unë personalisht me ambasadorin italian në Prishtinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputetja Veselaj-Gutaj ka sërish pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

(Ndërprerje e incizimit)

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: ... kur është ministri i pranishëm, kryetar! Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Çoçaj, e lë për më vonë, në qoftë se vjen ministri i Arsimit. Deputeti Ismajl Kurteshi, ka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Para kësaj pyetjeje për kryeministrin kam pasur bërë edhe dy pyetje tjera, të cilave asnjëherë nuk u është përgjigjur kryeministri. Madje, edhe s'e kam pas parë në kohën derisa pyetjet kanë qenë aktive.

Këtë pyetje do ta ruaj aktive derisa të vijë kryeministri, ose derisa të shkojë nga posti i kryeministrit, po këtu do të jem shumë këmbëngulës, të pres derisa të vijë, se vetëm kur ai të jetë këtu do të më përgjigjet në këtë pyetje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Ismail Kurteshi ka sërish pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

ISMAIL KURTESHI: Edhe këtë pyetje po e lë për javën tjetër.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Lahi Brahimaj, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe unë po e pres ministrin, në qoftë se vjen sot, e marr sot, në qoftë jo, atëherë javën tjetër.

KRYETARI: Do t'u dërgojmë mesazh të gjithë ministrave e kryeministrit, që do t'i presim. Deputetja Shukrije Bytyqi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nëse ne i presim ministrat dhe kryeministrin, nuk kemi kohë t'i shtrojmë pyetjet kurrë, sepse ata as gjatë kohës sa janë pyetjet aktive nuk janë këtu, po unë do ta shtroj pyetjen.

Viteve të fundit, prej vitit 2011 deri në këto vite dhe tani, jemi dëshmitarë se është paraqitur një epidemi - ethet hemorragjike "krime kongo", e cila ka përfshirë pesë komuna: Malishevën, Rahovecin, Gjakovën, Klinën dhe Therandën.

Sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i shëndetit publik të rajonit të Prizrenit prej vitit 2001 deri në vitin 2014, kemi pasur 34 viktima qytetarë të Republikës së Kosovës nga këto ethe, prej të cilave 18 raste kanë qenë nga komuna e Malishevës. Këtë vit Qeveria e Kosovës ende s'e ka parë të arsyeshme që të ndajë buxhet.

Pyetja ime shkon për kryeministrin: Sa keni paraparë buxhet për këtë vit për spërkatjen e zonave endemike të komunave të prekura nga ethet hemorragjike?

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Pyetja ime ka të bëjë lidhur me Ligjin nr. 04/250 për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror në Republikën e Kosovës, i cili është nënshkruar nga presidentja e Republikës së Kosovës më datën 7.4.2014 dhe është publikuar në numrin e 28-të të Gazetës Zyrtare, më datën 28 prill të vitit 2014, i cili është në fuqi që nga 13 maji i vitit 2014, përmes të cilit është themeluar Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës, e cila është e përkushtuar për operimin e sigurt të sistemit të navigimit ajror të Republikës së Kosovës.

Pyetja ime për ju, zoti ministër, është: A mund të na jepni shpjegim lidhur me zbatueshmërinë e këtij ligji, me theks të veçantë te neni 6 të tij, i cili ka të bëjë me emërimin, gjegjësisht shkarkimin e drejtorit të Agjencisë për Shërbimin e Navigacionit Ajror në Republikën e Kosovës, duke qenë se neni 6 i këtij ligji përcakton, se drejtorin e emëron Qeveria, pas dorëzimit të rekomandimit nga ministri. Ministri i Infrastrukturës para rekomandimit formon një komision vlerësues, i cili është përgjegjës për vlerësimin e kandidatëve, që përmes një konkursi të hapur siguron emërimin të bazuar në merita dhe kualifikim që përmbush kushtet e kërkuara për kandidim potencial, në përputhshmëri me ligjin në fjalë.

A është filluar me këtë proces dhe nëse po, në cilën fazë të zhvillimit është ai, zoti ministër?

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti kryetar,

Zoti ministër,

Kolegë,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Musliu,

Kuvendi i Kosovës, në seancë plenare të datës 20 mars 2014 e ka miratuar Ligjin për Agjencinë e Shërbimit të Navigimit Ajror, i cili më 7 prill 2014 është dekretuar nga presidentja e Kosovës.

Sa i përket çështjes së zgjedhjes së drejtorit të kësaj Agjencie, Ministria e Infrastrukturës gjatë vitit 2015 ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për hapjen e procesit për rregullimin e kësaj çështjeje.

Në kuadër të veprimeve të ndërmarra, janë mbajtur takime me drejtuesit e Agjencisë të Shërbimeve të Navigimit Ajror, ku jemi informuar për gjendjen aktuale të shërbimeve të navigimit ajror, për sfidat, për problemet ekzistuese buxhetore të shkaktuara si pasojë e shpronësimeve, të cilat i ka bërë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” para dhënies së tij me koncesion, me ç’rast barra buxhetore ka rënë mbi pjesën e mbetur, që nuk është dhënë me koncesion e që ofron shërbime të navigimit ajror.

Ministria e Infrastrukturës në nivel qeveritar i ka mbështetur të gjitha këto angazhime për mbështetjen financiare në procesin e kompensimit të shpronësimit të pronave e të cilat natyrisht, do të ndërmerren për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Në aspektin e përmbushjes së obligimeve të veta për zgjedhjen e drejtorit të ASHNA-s ka realizuar takime ndërministrorë me ministrin e Financave, me ministrin e Administratës Publike e të tjerë, lidhur me implikimet buxhetore, që ka kjo Agjenci për funksionalizimin e tij. Është arritur një qëndrim i përbashkët, se me rishikim të buxhetit do të adresohet edhe çështja e hapjes së vijës buxhetore, si kusht i domosdoshëm për përmbushjen e obligimeve të Ministrisë për zgjedhjen e drejtorit të ASHNA-s, gjegjësisht ndryshimin e statusit të ndërmarrjes publike në Agjenci.

Ju njoftoj, se zgjedhja e drejtorit të Agjencisë do të bëhet pas rishikimit të buxhetit, gjatë muajve në vijim të këtij viti, ku do të përcaktohen dhe do të realizohen veprimet për futjen e ASHNA-s si organizatë e veçantë buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Po, deputetja Musliu ka pyetje shtesë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, ministër!

Faktikisht, ne jemi vonuar, se thjeshtë e kemi bërë edhe një shkelje të ligjit, sepse ju e dini që neni 25 dispozita kalimtare e këtij ligji thotë, se drejtori i ASHNA-s emërohet nga Qeveria brenda 90 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe, pastaj gjithmonë fjalët “do të bëhet”, “do të shikohet”, “do të rishqyrtohet”, gjithmonë lënë shumë për të dëshiruar dhe është mirë, që të jepet një datë ose një afat i caktuar, se kur saktësisht do të ndodhë kjo, sepse ne e dimë shumë mirë,

rishikimi i buxhetit kur bëhet dhe pastaj sa zgjasin edhe procedurat tutje pas rishikimit të buxhetit.

Prandaj, është mirë që të ketë një datë të caktuar dhe ta dimë saktë se kur do të zgjidhet kjo çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër e ka fjalën sërish.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: E nderuar deputete,
Kam qenë i interesuar, natyrisht, menjëherë pasi që e kam marrë detyrën ta kryej këtë çështje, megjithatë për shkak se ASHNA vepron aktualisht si ndërmarrje publike, nuk kam kompetencë ta emëroj. Kështu që, në momentin kur hapet vija buxhetore, i ndryshohet statusi prej ndërmarrjes publike në Agjenci, menjëherë e bëj emërimin e atij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, deputetja Shukrije Bytyqi ka pyetje për ministrin Imet Rahmani.

SHUKRIJE BYTYQI: Unë do ta shtroj pyetjen, pavarësisht mungesës së ministrave dhe të kryeministrit, këtu.

Fatkeqësisht, për shkak të etheve hemorragjike në vitin 2013, me kërkesë të qeverive lokale të komunave, që janë të prekura nga këto ethe dhe kërkesës së ministrit të Shëndetësisë, zotit Ferid Agani, është themeluar Këshilli ndërministror për parandalimin dhe luftimin e këtyre etheve hemorragjike në Kosovë.

Angazhimi i këtij Këshilli së bashku me qeverinë lokale në Malishevë dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare “Dr. Shpëtim Robaj” në Malishevë kanë qenë shumë aktivë vitin e kaluar dhe fatmirësisht, nuk kemi pasur asnjë viktimë.

Por, këtë vit është tepër neglizhent ky Këshill ndërministror dhe kjo vërehet edhe gjatë një konference, që u mbajt më 24 prill 2015, në Malishevë, ku nuk morën pjesë përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

Pyetja ime për ministrin e Shëndetësisë, si kryetar i Këshillit ndërministror është: Pse këtë vit ende nuk është mbajtur asnjë takim i Këshillit ndërministror, të paktën deri më sot? A duhet gjithmonë të ndodhin fatkeqësitë, pastaj ju të merrni veprime?

KRYETARI: Faleminderit ! Do të na përgjigjet ministri kur të vijë. Shaip, dëshiron ta bësh pyetjen apo ta lësh më vonë?

SHAIP MUJA: Unë do ta lexoj e mandej, kur të vijë ministri, nëse nuk më ka kthyer edhe ky përgjigje me shkrim, do t’ia shtroj pyetjen prapë.

KRYETARI: Atëherë, është pyetja për ministrin Imet Rahmani.

SHAIP MUJA: Po, do ta lexoj pyetjen.

Zoti kryetar, zotimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është njëjtë sikur në pyetjen për ministrin e Punëve të Brendshme, për çështjen e kuadrove, të cilët janë të domosdoshëm të ruhen në Republikën e Kosovës dhe, momentalisht në sistemin shëndetësor të Republikës së Kosovës, specializohen një numër i caktuar i specialistëve në lëmi të ndryshme për të qenë më vonë specialistë në Shërbimin shëndetësor të Republikës së Kosovës.

Pyetja ime ka qenë kështu, për ministrin: Sa veta janë duke u specializuar dhe shkolluar pa pagesë në sistemin shëndetësor dhe ku janë bazuar për një vendim të tillë? Dhe, sipas ligjeve në Kosovë, Ligjit të punës dhe ligjeve për të drejtat e njeriut dhe kundër diskriminimit, a ka elemente për shkelje ligjore, që u janë bërë këtyre personave që shkollohen? Çfarë planesh ka, që në rishikimin e Buxhetit tash në qershor, që duhet të jetë, që të përfshihen këta persona me pagesë, sepse mendoj se është një shkelje ligjore dhe nuk përkon me zotimin e Qeverisë për avancimin e kuadrove specifike, e kryesisht këta në shëndetësi që janë duke punuar në orar të plotë, qoftë edhe me kujdestari pa asnjë kompensim material.

Dhe, kjo në këtë mënyrë këto kuadro specialistë, të cilët janë duke u shkolluar, kam informacione se shtetet e Bashkimit Evropian janë duke i negociuar që t'i marrin dhe të largohen nga sistemi shëndetësor i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Muja. Deputetja Teuta Haxhiu nuk qenka këtu. Ka një pyetje për kryeministrin, një pyetje për ministrin Mahir Yagcilar, i cili është këtu. Ne e presim, në qoftë se vjen, pastaj po kalojmë te deputeti Bekim Haxhiu, ka pyetje për ministrin e Kulturës, Kujtim Shala.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër Shala,

Me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 janë paraparë investime në infrastrukturën sportive dhe, tani jemi në muajin e pestë dhe nuk po shohim se kanë filluar investimet në këtë fushë, në projektet e miratuara në Kuvend. Renovimi i Stadiumit Olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë, renovimi i Stadiumit të qytetit në Prishtinë dhe ndërtimi i Stadiumit kombëtar të futbollit.

I nderuar ministër,

A mund të na tregoni në cilën fazë të zhvillimit janë projektet e lartshënuara dhe, pse ka ngecje në këtë drejtim?

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Shala!

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti deputet Haxhiu,

Punët për renovimin e Stadiumit Olimpik janë duke u zhvilluar sipas kontratës së 15 shtatorit të vitit 2014 dhe përfshijnë punimet në shtigjet e atletikës dhe në sistemin e ujtitjes.

Po ashtu, meqë Komuna e Mitrovicës për mungesë buxheti ka hequr dorë nga projekti për ndriçimin dhe sistemin e zërimit të stadiumit, këtë projekt e ka marrë përsipër Qeveria. Por, sipas

marrëveshjes, Komuna e Mitrovicës ka marrë përsipër të hartojë projektin e detajuar me parametat dhe të gjitha parallogaritë. Projekti do të finalizohet brenda dy javëve, ndërsa pas kësaj Ministria do t'i ndjekë procedurat e prokurimit që të lidhet kontrata për realizimin e projektit.

Ndërkaq, sa i takon renovimeve në stadiumin e qytetit të Prishtinës, Ministria ka bërë iniciimin e aktivitetit të prokurimit, sipas detyrës projektuese të dorëzuar nga Komuna e Prishtinës për hartimin e projektit zbatues.

Më 27 prill 2015 është shpallur tenderi për hartimin e projektit, ndërsa më 18 maj 2015 do të bëhet dorëzimi i ofertave.

Sa i takon pjesës së tretë, që ka të bëjë me ndërtimin e Stadiumit Kombëtar, bazuar në vendimin nr. 98/12 të datës 12 shkurt 2015 të Komunës së Prishtinës, sipas kërkesës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Stadiumit Kombëtar të Futbollit është bërë vlerësimi i lokacioneve nga ana e komisionit të përbërë nga përfaqësues të Qeverisë, të Komunës së Prishtinës dhe të Federatës së Futbollit të Kosovës.

Ky komision i ka parë si të pranueshme parcelat nr. 1197-1 dhe nr. 1197-6 në Bërnice të Poshtme. Pas kësaj janë ndjekur të gjitha procedurat verifikuese dhe meqë Agjencia e Kadastrave e Kosovës ka konstatuar se parcelat në fjalë janë pronë e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ne ia kemi drejtuar lëndën për shqyrtim kësaj Ministrie. Pasi të marrim përgjigje, do të vijojmë me fazën tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ke pyetje shtesë? Urdhëro, zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit i nderuar ministër për informacionin e dhënë. Unë, jo në kuptimin e pyetjes, sa më tepër në një formë këshillimi, për arsye se në vitin 2016, Kosova pritet, Federata e Futbollit të Kosovës të jetë pjesë e kualifikimeve për Kampionatin botëror 2018, dhe çdo ngecje në zhvillimin dhe renovimin e stadiumit olimpiq "Adem Jashari" në stadiumin e Prishtinës, do të kishte pasoja më afatgjate pasi që do të zgjasë ndërtimi i studionit kombëtar derisa të përfundojë, prandaj vetëm kërkoj një azhuritet sa i përket zhvillimeve të këtyre projekteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, Bekim Haxhiu, prapë pyetje për ministrin, po me përjashtim Albulena Haxhiu, se zoti Kuçi është këtu, asnjë ministër tjerë nuk është këtu. Këto pyetjet tjera që i kam unë vetëm do t'i lexoj. Atëherë, deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin që nuk është, Imet Rrahmani.

Deputetja Puhie Demaku, pyetje për kryeministrin që nuk është këtu. Atëherë, urdhëro!

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, kryetar!

Me datën 29 prill të këtij viti, presidenti i Lidhjes Qytetare Shqiptaro-Amerikane zoti Xhozef Diogardi, ka paraqitur një raport real për Qeverinë e Kosovës, para Komisionit për Punë të Jashtme të Kongresit Amerikan me ç'rast ai konstatoi se elita politike shqiptare në Kosovë, është bërë gjithnjë e më e pasur, ndërsa shumica e popullit shqiptar, është bërë gjithnjë e më e varfër.

Departamenti i Shtetit duhet të marrë përgjegjësi për përkrahjen që i ka dhënë Qeverisë Thaçi, e cila është shndërruar në ndërmarrje haraçi.

Zëvendësi i Thaçit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, zoti Petrit Selimi, u kundërpërgjigj duke e fyer zotin Diogardin dhe duke thënë se deklaratat e Diogardit janë si ato të Vuçiqit, Gjuriqit e Jeremiqit.

Pyetja për kryeministrin kudo që gjendet ai, është: A pajtohet ai me qëndrimin e zëvendësministrit Petrit Selimi? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Haskuka, keni një pyetje për ministrin Arsim Bajrami. A doni ta bëni pyetjen? Zoti Haskuka, a e dëshironi pyetjen për ministrin Bajrami, tash?

MYTAHER HASKUKA: Për zotin Bajrami, po e lë për javën e ardhshme që të flasim, pasi s'është këtu.

KRYETARI: Faleminderit! Po ashtu për ministrin e Financave, Abdullah Hoti.

MYTAHER HASKUKA: Po e parashtroj pasi nuk ka pasur diskutime mes nesh lidhur me pyetjen dhe dua ta parashtroj e pastaj të shohim.

Në bazë të ligjit numër 04/L-09 për persona të verbër neni 6, lirim nga taksat dhe tatimet, po e citoj ligjin - personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe të tatimit të drejtpërdrejtë, në rast vetëpunësimi ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast se zhvillojnë veprimtarinë si persona juridikë, ata gëzojnë lehtësira tatimore të cilat i realizojnë sipas ligjeve në fuqi.

Po ashtu të drejtat janë specifikuar në Kodin Doganor dhe të akcizave në Kosovë, pra në Kodin numër 03/9-109 tek dispozitat e përgjithshme, respektivisht në nenet 75, 76, 77 dhe 78.

Pyetja: Kohëve të fundit, personalisht jam i informuar nga shumë qytetarë të verbër se nuk mund të bëjnë importin e automjeteve dhe veturave të tyre ngase ato bllokohen në dogana me muaj. Pse nuk aplikohen dispozitat ligjore për këtë grup të cenuar të popullatës dhe më keq pse ato aplikohen në mënyrë selektive për disa po e disa jo. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

REXHEP SELIMI: Meqë kryeministri nuk është këtu, unë do t'ju njoftoj se pyetja ime ka të bëjë në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur në Maqedoni dhe po ashtu në lidhje me nevojën për të qenë të informuar pasi që shumë prej zyrtarëve të Qeverisë janë deklaruar se janë të informuar dhe Kuvendi ka nevojë që po ashtu të jetë i informuar dhe gjithsesi edhe qytetarët.

Përveç mungesës së kryeministrit duket që as ministri i Brendshëm dhe as ministri i Jashtëm, të cilët eventualisht do të mund të përgjigjen, nuk janë këtu, prandaj nëse në ndërkohë nuk kemi përgjigjen e tyre ose njoftimin publik në lidhje me ngjarjet atje dhe sidomos me listën e të arrestuarve dhe përfshirjen e qytetarëve të Kosovës, atje, do ta bart pyetjen time për seancën e ardhshme kur eventualisht ata të jenë këtu.

KRYETARI: Deputetja Albulena Haxhiu i ka dy pyetje për ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, i bëni bashkë apo ndaras, vendosni ju.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit !

Është për t'u përsëritur fakti që ministri i Drejtësisë i ka mbledhur forcat dhe ka vendosur të vjen në Kuvend, sepse gjatë gjithë kësaj kohe kemi parë një injorim të Kuvendit, qoftë për projektligjet që vetë i sjell, qoftë në kohën e pyetjeve parlamentare.

Me datën 6 maj 2015 me vendim të Qeverisë numër 11/27 u bë tërheqja nga shqyrtimi i mëtejme për këto projektligje:

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës,
- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
- Projektligji për trashëgiminë kulturore.

Në po këtë vendim thuhet se për informata shtesë, si gjithnjë, qëndrojmë në dispozicionin tuaj.

Nëse projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal e keni tërhequr për shkak se ka pasur presion nga Shoqëria civile dhe partitë opozitare, sepse kishte për qëllim amnistimin e zyrtarëve të korruptuar, nëse Projektligjin për trashëgiminë kulturore e keni tërhequr për shkak të presioneve nga Lista Serbe, cila është arsyeja e tërheqjes së Projektligjit për parandalimin konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pasi që aty Komisioni pat vendosur që zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik.

Pra, zoti ministër, është e rëndësishme që të na tregoni se cila është arsyeja konkrete kryesore pse e keni tërhequr një projektligj të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër, fjala është për ju.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Deputete Haxhiu, faleminderit për pyetjen. Ka pasur pyetje që mu ke drejtuar mua dhe s'kam qenë në Kuvend, për shkak të angazhimeve tjera dhe më vjen keq, por pyetja e sotme s'ka të bëjë me mua fare.

E para, dua të them se ajo pjesë e nënshkrimit, besoj s'e ke parë nënshkrimin tim, po të dikujt tjetër dhe e dyta, unë s'e kam tërhequr atë ligj, por e ka tërhequr dikush tjetër.

Unë mendoj se e keni marrë përgjigjen në seancën e kaluar, por Ministria e Drejtësisë, jo. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, deputete, nëse ke shtro pyetje shtesë.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë, Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik e ka sponsorizuar Ministria e Drejtësisë dhe për çfarëdo tërheqje është përgjegjëse Ministria e Drejtësisë, pavarësisht që vendimi është i Qeverisë, ju jeni sponsorizuesi dhe tash na informoni se a është e vërtetë që këshilltari politik i kryeministrit Mustafa, Besnik Berisha, ka bërë presion për tërheqjen e këtij projektligji, sepse kam informacione që edhe Ministria e Drejtësisë edhe ajo për Integritet ka qenë kundër, mirëpo ai ka bërë presion te kryeministri për ta tërhequr një projektligj të tillë.

KRYETARI: Zoti ministër, e ka fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

E nderuara deputete, për çfarëdo tërheqje nuk jam përgjegjës, se unë nuk jam krejt Qeveria.

E dyta, vendimet e Qeverisë ministri mundet t'i zbatojë ose jo, të heqë dorë, por përndryshe as s'e kam dhënë iniciativën e asgjë tjetër s'ka bërë Ministria e Drejtësisë. Me emra të përveçëm, unë s'merrem. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetjen tjetër, deputete nëse ka mundësi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit për konfirmimin që sapo e konfirmoj jo me emër të përveçëm, mirëpo e konfirmoj se po. Pra nuk e ka tërhequr ky, por e ka tërhequr vetë Besnik Berisha ose dikush tjetër, që unë besoj prapë Besnik Berisha e ka tërhequr.

Pyetja e dytë ka të bëjë: Më 20 dhjetor të vitit 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Projektligjin për procedurën përmbartimore. Në këtë ligj parashihet edhe Instituti i përmbartuesit privat, ose përmbartimi privat.

Duke ditur se përmbartuesit privat emërohen nga ju, vendimet për ta gjithashtu i merrni ju, caktimin e numrit të përmbartuesve gjithashtu e merrni ju, a keni bërë ndonjë vlerësim të punës së këtyre përmbartuesve privatë?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Meqë për përgjigjen e parë, deputete, unë kam aq guxim të them me emër e mbiemër, kur dua, hiq mos u bë merak. Por unë mjafton që thashë që unë jo, sikur që kur e tërheq, tregoj që unë, po. Dhe, për Kodin Penal po e jap një përgjigje shtesë. Unë po e jap vetëm një informatë. Agjencia Kundër Korrupsionit, në verifikimin që e ka bërë në vitin e kaluar, vetëm dy veta kanë dalë që kanë deklaruar pasurinë drejt, dhe mos harroni, edhe ju jeni në këtë sallë.

Dhe unë po ua them vetëm një fakt. Aty në ligj nuk është menduar asnjëherë për t'i fshehur ose për t'i falur ata që kanë larje të parave, korrupsion, krim të organizuar, por ata që marrin para nga buxheti i Kosovës për një shumë të caktuar deri në 5 mijë euro.

Agjencia Kundër Korrupsionit i ka falur vetëm ata ose ka akuzuar po them, vetëm ata që kanë pasur dallimin mbi 5 mijë euro. Por, ligji a e di çka thotë? Edhe për një cent duhet akuzuar. Ligji nuk e jep këtë përparësi.

Keni menduar që është më e mirë, mirë e shohim si do të dalë.

Sa i përket çështjes së përmbarrimit... jo se edhe ju u përgjigjët pak në pyetjen e parë, Albulena. Përmbarrimit, besoj në arkitekturën e drejtësisë, faleminderit për pyetjen, unë kam pasur dy qëllime në mandatin e parë: arkitekturën e drejtësisë dhe standardet, dhe në këtë drejtim kam arritur në plotni. Kemi bërë noterinë e re, përmbarruesit privatë, administratorët falimentues dhe arbitrazhin. Ministria e Drejtësisë dhe unë personalisht i kemi kryer të gjitha obligimet për përmbarruesit privatë dhe sot ata funksionojnë në Republikën e Kosovës.

Ata vetëm e marrin licencën nga unë, por është një Komision i veçantë që e bën përzgjedhjen e tyre, që e bën intervistimin e tyre dhe i bën propozimet te ministri.

Po ashtu, është një komision i veçantë i paraparë me ligj, prej 7 anëtarëve që e bën mbikëqyrjen e punës së tyre. Dhe, unë deri më tani nuk kam marrë ndonjë vërejtje me shkrim, por kam pasur dy vërejtje publike që i kam vërejtur në televizion, për rastin kur ata kanë bërë përmbarrimin e një rasti social dhe një pensionisti. Unë nuk kam hasur ende dhe s'kam marrë raport që është shkelur ligji, por kam takuar kryetaren e Odës së Përmbarruesve Privatë dhe kam kërkuar përgjegjësi të plotë.

Dhe, po e them, sa herë që e takoj dikë që e shkel ligjin atij do t'i merret licenca.

KRYETARI: Faleminderit! Albulena, ke diçka tjetër shtesë?

ALBULENA HAXHIU: Po, faleminderit!

Atëherë fillimisht më duhet të them që Lëvizja "Vetëvendosje" pati kundërshtuar fuqishëm Institutin e Përmbarrimit Privat. Nëse do të duhej të kishim përmbarrues shtesë, atëherë po, le të kemi përmbarrues, mirëpo publik që do të jenë të vendosur në gjykatat tona.

Zoti ministër a jeni në dijeni se pa zgjedhur mjete dhe pa zgjedhur metoda përmbarruesit privatë po i frikësojnë dhe po i shantazhojnë qytetarët që më së paku janë të mbrojtur. Pra, ata që po luftojnë për minimumin jetik ose që po përballen me varfërinë dhe mjerimin.

Deri më tani përmbarruesi privat është parë si mekanizëm kërcënues për mbledhjen e borxheve. Unë e kuptoj që borxhet duhet të kthehen, por duhet bërë një vlerësim edhe i gjendjes socio-ekonomike të një qytetari, sepse, siç e keni parë edhe ju, jo dy, por janë 200 e 200 mijë raste ku po terrorizohen qytetarët e Republikës së Kosovës, për shkak të përmbarruesve privatë.

Pra, si ministër i Drejtësisë e keni përgjegjësi primare që të kujdeseni që nuk po preket dhe nuk po cenohet dinjiteti i qytetarëve të Republikës së Kosovës. Unë çuditë se si deri më tani i keni dëgjuar vetëm dy raste.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, e nderuar deputete!

Besoj se e di dhe atëherë kemi diskutuar, ju keni qenë deputete e unë ministër dhe a duhet të ketë përmbarues privat ky vend apo jo, ka dallim konceptesh, që i kemi në parti politike. Dhe përmbaruesit privat i kam marrë qysh janë në Gjermani, janë në Slloveni, janë kudo tjetër, edhe në Shqipëri dhe Maqedoni nëse doni për rreth, por kjo është çështje konceptesh dhe ligji tani u miratua.

E dyta, nëse ata shantazhojnë apo kërcënojnë dikë tjetër, kjo është vepër penale dhe kjo vlen për të gjithë, jo vetëm për përmbaruesit privatë.

E treta, ata duhet të jenë të kujdesshëm në raport me rastet sociale.

Dhe e katërta, sa herë që konstatojnë se është shkelur ligji, unë e kam të vetmen fuqi, kur komisioni për mbikëqyrje e sjell te unë raportin dhe konstaton. E unë po them, asnjë raport s'ma kanë pru me shkrim. Unë kam iniciuar raste. Në momentin që e bien raportin, unë veproj.

Përndryshe, nuk mund unë të them ama licencën, po ta japi licencën.

KRYETARI: Faleminderit ! E ka fjalën Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë nuk e di se çka ke përgjegjësi zoti ministër, sipas jush, sepse sipas ligjeve dhe Kushtetutës, e di se cilat janë përgjegjësitë tuaja.

Por, nëse në secilin aspekt vetëm ka tendencë për degradim, qoftë në sistemin e drejtësisë, që jeni përgjegjësi kryesor për degradimin e sistemit të drejtësisë, qoftë edhe për gjitha çështjet tjera, nuk e di se për çka merrni përgjegjësi....

KRYETARI: E keqpërdore fjalën time, deputete! Urdhëro zoti ministër, se je i aftë boll për t'u përgjigjur.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: E nderuara deputete,

Unë ju kam dëgjuar shpesh juve nga pak duke i folur këto përralla. Shikoni, janë tri kategori në këtë vend.

(Ndërhyrje)

Shikoni. Unë përmes juve po dua të jap përgjigjen të gjithëve. Janë tri kategori në këtë vend që mendojnë për sistem të drejtësisë. Disa janë të sistemit të kaluar që nuk e ndajnë shumë pushtetin. Ju nuk jeni aty. Disa të tjerë e bëjnë për qëllime politike dhe ju jeni aty. Dhe, disa të tretët janë edhe juristë, edhe ju dhe unë jemi, dhe nuk e dinë ndarjen e pushtetit, është gjynah prej zanati.

Ju duhet ta dini. Ministri i Drejtësisë vetëm bën politikat e drejtësisë, as nuk bën për gjyqësor, as nuk bën për prokurori. Përmbaruesit janë të pavarur në punën e vet. Dhe, po ju them një, prej frymës së Monto Skies, libri i tij në frymën e ligjeve, deri sot, pushteti duhet të jenë të ndara.

KRYETARI: Faleminderit! Kërkoj falje prej të gjithëve, se e shkela Rregulloren! Deri në Rregulloren e re do ta krijojmë një barazi. Është edhe një pyetje, por deputetja Besa nuk qenka këtu për ministrin e as ministri Imet Rrahmani nuk është këtu. Me kaq përfundoj edhe pika e dytë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër të radhës:

3. Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për emërimin e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Nënkryetarja e Kuvendit aktuale nga radhët e Grupit Parlamentar të Listës Serbe, zonja Jasmina Zhivković e ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit se ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë.

Grupi Parlamentar Lista Serbe për nënkryetar të Kuvendit ka propozuar deputetin Slobodan Petroviq.

Ftoj kryetarin apo përfaqësuesin e Grupit Parlamentar Lista Serbe, që para Kuvendit të paraqesë propozimin për nënkryetar të Kuvendit nga radha e këtij grupi parlamentar. Urdhëro, zoti Sasha!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

Vi ste već sve rekli, ali još jednom da ponovom pošto je gospođa Jasminka Živković podnela ostavku na mesto potpredsednika, predlog Poslaničke grupe Srpske liste za novog člana Predsedništva je gospodin Slobodan Petrović pa bih zamolio sve prisutne da taj naš predlog izglasamo danas na sednici. Hvala!

KRYETARI: Atëherë, vetëm një këshillë juridike, që është për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, sipas nenit 67 paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nevojiten shumica e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit, pra së paku 61 vota për.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për zgjedhjen e zotit Slobodan Petroviq, nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radha e Grupit Parlamentar Lista Serbe.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Atëherë, edhe një herë do të futemi në votim me dorë. A ka pajtueshmëri të plotë lidhur me këtë?

Lus deputetët të përgatitën për votim. E kemi propozimin e Grupit Parlamentar Lista Serbe, Slobodan Petroviq ta zëvendësojë Jasmina Zhivkovićin, si nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kush është për?

Në fakt do të procedojmë me kush është kundër?

A ka kush që abstenon?

Atëherë, konstatoj se Kuvendi e zgjodhi deputetin Slobodan Petroviq me 62 vota për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radha e Grupit Parlamentar Lista serbe.

Urime zoti Petroviq! E falënderojmë për punën e deritanishme zonjën Jasmina Zhivkoviq.

Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Zgjedhja e dy anëtarëve joekzekutivë në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar propozimin e Panelit të Bordit të Bankës Qendrore për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar përzgjedhjen e dy kandidatëve prej tetë kandidatëve të propozuar.

Ftoj zotëri Naser Osmani të na sqaroj edhe me procedurat, edhe lidhur me votimin dhe procesin se si do të vazhdojmë më tutje. Urdhëro, zoti Osmani!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Në bazë të nenit 38 pikë 2 të Ligjit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi i Bankës Qendrore e ka emëruar Panelin seleksionues për përzgjedhjen e dy anëtarëve joekzekutiv të Bordit të BQPK-së.

Paneli ka zhvilluar procedurat e konkursit dhe pas vlerësimit të kualifikimeve dhe performansës së aplikantëve të ftuar për intervistë dhe ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve që i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret që kërkojnë me Ligjin për BQK-në.

Si rrjedhojë, në pajtim me nenin 38.2 të Ligjit për BQPK-, paneli selektues me datën 16 prill 2014 dhe me 25 korrik 2015, i ka dërguar Kuvendit dy propozime me listën e emrave të kandidatëve të përzgjedhur për plotësimin e dy pozitave të anëtarëve joekzekutivë të Bordit të BQPK-së.

Për shkak të shpërbërjes së Kuvendit, kandidatët nuk kanë arritur të radhiten për votim në seancat plenare. Paneli selektues, më datën 21.1.2015 pas konstituivit të Kuvendit ka riproceduar në Kuvend, listën e njëjtë të kandidatëve për plotësimin e dy pozitave për anëtarë joekzekutiv të Bordit të BQPK-së dhe ata janë:

- Mejdi Bekteshi,
- Mimoza Mustafa,
- Behxhet Brajshori,
- Shyqyri Bytyqi,
- Zelif Lufi,
- Nuhi Ahmeti,
- Agim Vishi, dhe
- Xhemajl Gashi.

Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që të bëjë dy përzgjedhje nga tetë të rekomanduarit nga paneli zgjedhor.

Meqenëse Ligji për Bankën Qendrore nuk e definon saktë çështjen e përzgjedhjes, para se të zhvillohet procedura e votimit për rizgjedhjen e anëtarëve, duhet të miratohet një procedurë e votimit që duhet ta aprovojë Kuvendi, si në vijim:

1. Përzgjedhja e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës bëhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm.
2. Deputeti i Kuvendit prej tetë kandidatëve për anëtarë jo ekzekutivë të Bordit të Bankës, voton për dy kandidatë.
3. Nëse në votimin e parë asnjë kandidat nuk merr numrin e nevojshëm të votave, katër kandidatët që kanë marrë më së paku vota hiqen nga lista e votimit dhe përsëritet me katër kandidatë që kanë marr më shumë vota.
4. Nëse në votimin e parë vetëm 1 kandidat i fiton votat e nevojshme, 5 kandidatë që kanë marrë më së paku vota hiqen nga lista dhe votimi përsëritet me 2 kandidatë që kanë marrë më shumë vota.

Kjo është procedura të cilën ishte dashur ta aprovojmë zoti kryetar para se të hyjmë në procesin e votimit.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Osmani për këtë sqarim tepër logjik. Tash paraprakisht duhet që deputetët të deklarohen lidhur me procedurat e votimit për përzgjedhjen e anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ishte ajo që e lexoi kolegu ynë i nderuar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. E thashë edhe një herë, për procedurat. Jemi duke folur për procedurat, jo për kandidatët. E lexoi kolegu i juaj Naser Osmani.

Pra, votojmë për procedurat e votimit. Votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 70 deputetë, nga të cilët 69 kanë votuar pro procedurave dhe 1 ka abstenuar.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi procedurën e votimit për përzgjedhjen e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

I ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës?

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar e propozon si anëtar të komisionit zotin Hajdar Beqa.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Ne e propozojmë për anëtar të komisionit zonjën Besa Gaxherri.

KRYETARI: Lëvizja “Vetëvendosje”, ju lutem!

GLAUK KONJUFCA: Besa Baftiajn.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës?

PAL LEKAJ: Ne e propozojmë për anëtar të komisionit Rrustem Berishën.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Mi predlažemo gospodina Slavka Simića.

KRYETARI: Grupi Parlamentar “Nisma”?

VALDETE BAJRAMI: Nga “Nisma”, Enver Hoti.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”?

KUJTIM PAQAKU: Grupi Parlamentar “6+” e propozon zotin Qerim Bajrami.

KRYETARI: Lus deputetët që me një ngritje dore ta kemi vetëm një miratim formal të propozimeve.

Konstatoj që Kuvendi i emëroi anëtarët në Komisionin votues për përzgjedhjen e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Lus komisionin që të fillojë me procedim, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas radhës së listës.

Komisionin e lus t’i zërë vendet. Fillojmë me procedurën e votimit. Fillojmë me votimin:

Sabri Hamiti, Adem Grabovci, Arben Gashi, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Kadri Veseli...,

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Zotërinj deputetë, mos u grumbulloni, se ju thërras me emra.

...Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kujtim Paqaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmerkoll, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Millka Vuletiq, Mufera Serbica Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviqe Halimi, Sërgjan Popović, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Sllavko Simiq, Slobodan Petroviq, Synavere Ryshta, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhevahire Izmaqu, Zafir Berisha dhe Zenun Pajaziti.

KRYESUESI: I dëgjojmë rezultatet e votimit. Komisioni e jep raportin.

BESA GAXHERRI: Kolegë deputetë,

Pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në seancën plenare, të mbajtur më 15 maj 2015, konstatoj si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 95 deputetë. Të pavlefshme janë 0 votime, domethënë të gjitha votat janë të vlefshme, 95 gjithsej.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Mejdin Bektashi ka fituar 38 vota,
2. Mimoza Mustafa ka fituar 20 vota,
4. Behxhet Brajshori ka fituar 34 vota,
5. Shyqyri Bytyqi ka fituar 20 vota,
6. Zylyf Lufi ka fituar 3 vota,
7. Nuhi Ahmeti ka fituar 62 vota,
8. Agim Vishi ka fituar 3 vota, dhe
9. Xhemajl Gashi ka fituar 2 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit dhe në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatoj se:

Nuhi Ahmeti i propozohet Presidentes së Republikës së Kosovës për emërim anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kolegë deputetë, në rundin e dytë në listën e fletëvotimit hyjnë Mejdi Bektashi dhe Behxhet Brajshori.

KRYESUESI: Faleminderit, Besa!

Atëherë, kandidatët le të përgatiten teknikisht për votimin e dytë.

A jeni të gatshëm? Procedojmë me votimet:

Adem Grabovci, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paqaku, Labinothë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmerkoll, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavljeviq, Selviqe Halimi, Sërgjan Popović, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Sllavko Simiq, Slobodan Petroviq, Synavere Rysha, Teuta haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqu, Zafir Berisha dhe Zenun Pajaziti.

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Vazhdoni me hapjen e kutisë të votimit!

(Ndërprerje e incizimit)

E ftojme kryesuesen e komisionit që ta paraqesë raportin para deputetëve për procesin dhe rezultatin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve joekzekutivë në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

BESA GAXHERRI: Faleminderit!

Pas votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në rundin e dytë, në seancë plenare të mbajtur më 15 maj 2015, konstatohet si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë, të pavlefshme janë 3 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Mejdi Bektashi ka fituar 37 vota,
2. Behxhet Brajshori ka fituar 44 vota,

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 38.2 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankat Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se Behxhet Brajshori i propozohet Presidentes së Republikës së Kosovës për emërim anëtar joekzekutiv i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, në bazë të raportit të Komisionit votues konstatohet se Kuvendi i zgjodhi zotin Nuhi Ahmeti dhe zotin Behxhet Brajshori për anëtarë joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 38.2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, vendimi i dërgohet Presidentes së Republikës për emërimin e anëtarëve joekzekutivë të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pauza do të jetë deri në orën 15:00, vetëm se ju lutem që atëherë të jeni këtu! Pauza e drekës, e pastaj e vazhdojmë seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

KRYESUESI: deputetë të nderuar, ju lutem merrni vendet tuaja! Po e vazhdojmë seancën.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqene Sociale e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin e Shëndetësisë, të cilin nuk e kemi këtu, por ministri Abrashi do ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ligji aktual 2/L-81 ka përmbledhur në përgjithësi obligimet dhe të drejtat e punëtorëve shëndetësorë në lidhje me nxitjen, rëndësinë dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, të drejtat e femrave për gjidhënie.

Po ashtu, ligji aktual rregullon edhe të drejtat dhe obligimet e personave të punësuar nga prodhuesit dhe distributorët e zëvendësuesve të qumështit të gjirit dhe kufizimet në promovimin e tyre.

Për shkak të vështirësive në zbatim, si dhe për shkak të paqartësive terminologjike të hasura gjatë zbatimit, është paraqitur nevoja për ndryshimin e ligjit.

Ndryshimet në këtë ligj janë të ndërlidhura me strategjinë sektoriale 2015-2020 - objektivi i parë - që ka të bëjë me shëndetin për nëna dhe fëmijë, përkatësisht me uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve.

Kjo fushë ndërlidhet edhe me dokumentit e mijëvjeçarit të aprovuar nga OKB-ja dhe të afirmuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, synimi zhvillimor i mileniumit katër.

Të nderuar deputetë,

Më lejon të theksoj se të ushqyerit me gjiri është dokumentuar si mënyra më e mirë, më e shëndetshme dhe më e lirë e ushqyerjes së foshnjës.

Kjo mënyrë e të ushqyerit është dokumentuar si forma më ideale për foshnja, sidomos në gjashtë muajt e parë të jetës.

Të ushqyerit ekskluzivisht me gjiri gjatë gjashtë muajve të parë të jetës e zvogëlon vdekshmërinë e foshnjave si pasojë e sëmundjeve të zakonshme të fëmijërisë dhe kequshqyerjes. E forcon

imunitetin biologjik të fëmijës dhe ndihmon në forcimin e lidhjes emocionale ndërmjet nënës dhe fëmijës.

Të nderuar deputetë,

Nëpërmjet këtij ligji definohej qartë zëvendësuesit e qumështit të gjirit, vendosen indikacionet mjekësore dhe mosha deri kur mund të përdoret. Po ashtu, ky ligj vendos edhe kufizime të përdorimit të qumështit zëvendësues.

Të nderuar deputetë,

Dua të theksoj se ligji i ri i përcakton më qartë obligimet dhe përgjegjësitë për monitorimin e institucioneve përkatëse në lidhje me marketingun e zëvendësuesve të qumështit të gjirit.

Së fundi, ky projektligj është përafëruar me tabelat e përputhshmërisë së ‘acquis’ së BE-së.

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e këtij ligji në mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve, kërkoj nga ju ta përkrahni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Abrashi!

Tash do të kalojmë në debatin për ligjin në parim. Fjalën e merr kryetarja e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kolegë dhe kolege,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill të këtij viti, e shqyrtoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me ushqim gjiri dhe vendosi që ta procedojë më tutje dhe ta miratojë në parim këtë projektligj me disa vërtetje, të cilat sigurisht edhe kolegët e mi, anëtarët e komisionit dhe deputetët, do t'i thonë edhe këtu, sepse ligji i ka edhe disa mangësi që nuk janë përfshirë plotësisht në projektligj.

Dihet se të ushqyerit me gji është mënyra më e mirë dhe e pazëvendësueshme për rritjen e foshnjës, por për ta obliguar me ligj nënën që ta ushqejë fëmijën me ligj, atëherë kujtomë edhe u tha në komision se paraprakisht se duhet të ekzistojë projekti nacional për shëndetin perinatal dhe posnatal të foshnjave, ku do të hynte edhe hapja e këshillimoreve për nëna dhe fëmijë dhe edukimi i nënave të reja për të ushqyerit me gji dhe rolin e të ushqyerit me gji si një ushqim i pazëvendësueshëm për rritjen e foshnjës.

Komisioni gjithashtu mendon se fëmijëve të porsalindur duhet t'i përkushtohet një vëmendje më e përqendrueshme. Ne si shoqëri duhet ta kuptojmë se më nuk kemi natalitet çfarë kemi pasur, por gjatë kësaj periudhe të pasluftës ka rënë përgjysmë nataliteti dhe nuk e kemi një arsyetim, e kjo do të thotë mungesë e përkujdesjes së fëmijëve dhe të nënave si mangësi.

Gjithashtu ligji nuk është plotësisht kompatibil me Ligjin e punës. Është kjo një vërejtje e komisionit, prandaj Ligji i punës duhet të ndryshojë në bazë të kësaj kërkesë që nënat të kenë mundësi ta ushqejë fëmijën në çfarëdo kohe sipas orarit që parashihet.

Kujtojmë, megjithatë, se ligji është i nevojshëm dhe procedojmë më tutje me vërejtjet që do të thuhën edhe në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Brovina! Tash flasin përfaqësuesit ose kryetarët e grupeve parlamentare. Nga Grupi i PDK-së, deputeti Fadil Beka e ka fjalën.

FADIL BEKA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe konsiderojmë se ky projektligj është i një rëndësie të veçantë dhe e përkrahim në parim

Më lejo, zoti kryetar, që t'i shpreh pikëpamjet e mia mbi rëndësinë e ushqyerit me qumësht gjiri.

Të ushqyerit me qumësht gjiri është ushqimi më i mirë për foshnjën e porsalindur, e gjithashtu më i përshtatshëm në gjastë muajt e parë të jetës, sepse i siguron foshnjës marrjen e të gjitha materieve energjike optimale.

Ka shumë arsye pse duhet mbrojtur dhe rekomanduar të ushqyerit me gji. Kjo është detyrë e një rëndësie të veçantë për stafin mjekësor, që merret me mbrojtjen e shëndetit të nënave dhe fëmijëve, sidomos në regjionet me standard të ulët socio-ekonomik.

Qumështi i nënës është më i volitshmi dhe më i preferuari për të porsalindurin dhe në tërë periudhën foshnjore, domethënë periudha foshnjore është deri në një vit, sepse ka elemente të nevojshme kualitative për të ushqyerit gjatë gjithë periudhës.

Qumështi i nënës ka shumë arsye që është i pazëvendësueshëm dhe ja disa prej tyre:

Qumështi i nënës nuk përmban mikroorganizma, pra është steril. Ka faktorë të shumë imunologjikë në përbërje, që e mbrojnë foshnjën nga infeksionet.

Përbërja kimike u përgjigjet nevojave për rritje dhe zhvillim normal. Nuk shkakton sensibilizim dhe alergji. Tretet lehtë dhe nuk e ngarkon traktin gastrointestinal. Është lehtësim për buxhetin familjar.

Përveç si ushqim për foshnje krijon edhe raport psikologjik të pazëvendësueshëm ndërmjet nënës dhe foshnjës dhe te nëna zhvillon relaks pozitiv.

Për ushqim të suksesshëm të foshnjës vetëm me gji, shtatzënat duhet të parapërgatiten nga ekipet mjekësore në terren.

Nënës, përkatësisht lehonës duhet t'i jepet i porsalinduri në gji gjithsesi në orët e para të jetës, kuptohet nëse lehona është në gjendje të volitshme shëndetësore.

Organizimi i reparteve duhet të jetë i tillë që i porsalinduri dhe nëna të vendosen së bashku në një dhomë.

Në konferencën ndërkombëtare, të mbajtur në Ankara, në shtator të vitit '91, OBSH-ja dhe UNICEF-i me programin e tyre të quajtur "Spitali, mik i foshnjës", kanë përkrahur dhe mbrojtur maternitetet dhe institucionet shëndetësore për gjidhënie të suksesshme dhe ka rekomanduar strategjinë dhe ka rekomanduar strategjinë dhe hapat e mëtutjeshëm që janë obligativë dhe të zbatueshëm edhe për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Lidhjen Demokratike, deputeti Hatim Baxhaku e ka fjalën.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri si qëllim kryesor e ka rregullimin me ligj dhe promovimin e të ushqyerit dhe inkurajon të ushqyerit me qumësht gjiri, por edhe mbrojtjen e tij nga propaganda dhe marketingu që bëhet nga prodhuesit e ndryshëm, distributorët dhe marketingu për zëvendësimin e tij me produkte të ashtuquajtura zëvendësues të qumështit të gjirit.

Rregullimi i kësaj çështjeje është shumë i rëndësishëm për t'i arritur objektivat strategjike të sektorit të shëndetësisë, siç është zvogëlimi i vdekshmërisë së foshnjave dhe nënave në përputhje me projeksionet me dokumentin njëvjeçar të aprovuar nga OKB-ja.

Me ligjin aktual në fuqi numër 02/L-81, që e rregullon këtë fushë, janë përmbledhur në përgjithësi obligimet dhe të drejtat e punëtorëve dhe institucioneve shëndetësore në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, të drejtat e femrave, përkatësisht nënave dhe çështjet tjera që lidhen me informimin e nënave nga institucionet përkatëse për të drejtat dhe detyrat e tyre, por nuk janë rregulluar të drejtat, përgjegjësitë dhe sanksionet ndaj prodhuesve, distributorëve dhe atyre që bëjnë marketing dhe këtë e bën ky ligj.

Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se ky projektligj e rregullon në mënyrë të kënaqshme këtë fushë, prandaj e përkrahim dhe do ta votojmë projektligjin në parim dhe kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve gjatë amendamentimit të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Deputetja Besa Baftija, për Lëvizjen "Vetëvendosje", e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Qumështi i gjirit është ushqimi ideal për foshnjat, e sidomos në gjashtë muajt e parë të jetës. Ai i kombinon tri themelet bazë të një ushqyerjeje të shëndetshme: ushqimin, shëndetin dhe kujdesin.

Qumështi i gjirit përmban gjithë lëndët ushqimore, antitruapat, hormonet dhe faktorët e rritjes që i nevojiten një foshnje për t'u rritur dhe zhvilluar. Stimulon sistemin e tyre imunitar dhe përgjigjen ndaj vaksinimit. Ndhmon në zhvillimin e sistemit nervor qendror.

Si rrjedhojë, projektligjin që e kemi para vetes është një nga më të rëndësishmit për shëndetin e fëmijëve tanë dhe për shëndetin publik të Republikës së Kosovës.

Rregullimet në këtë projektligj janë themeli i mbrojtjes së fëmijëve, nënave dhe familjeve të Kosovës.

Pra, në parim, ky projektligj është shumë i rëndësishëm, sepse qëllimi i tij është mbrojtja e të ushqyerit të fëmijëve nëpërmjet inkurajimit, mbrojtjes, promovimit të ushqyerit me qumësht gjiri dhe kufizimet në marketingun e zëvendësuesve të qumështit të gjirit.

Po ashtu, nëpërmjet këtij projektligji sanksionohet marketingu, keqpërdorimet me zëvendësuesit e qumështit të gjirit, si dhe përdorimi i zëvendësuesve të qumështit të gjirit vetëm atëherë kur ka indikacione mjekësore.

Çështja thelbësore i takon mbrojtjes efektive, që deri tash nuk ka qenë në nivel të lartë.

Ky projektligj është në pajtim me Kushtetutën dhe detyrime ndërkombëtare dhe ndërlidhet me dokumentin e mijëvjeçarit të aprovuar nga OKB-ja, që ka për qëllim uljen e vdekshmërisë së foshnjave dhe të nënave.

Po ashtu, në këtë projektligj përcaktohet qartë e drejta e grave të punësuarra për t'i ushqyer me qumësht gjiri foshnjat e tyre sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Mirëpo, vërejtje sa i përket terminologjisë ka të shumta, jo vetëm këto, mirëpo edhe në dokumentet tjera zyrtare, edhe në projektligjet e mëhershme, sepse përdorimi i fjalës “femër” në vend “grua” nuk është i pranueshëm. Në asnjë rast, “grua” dhe “femër” nuk e nënkupton të njëjtën gjë. Termi “femër” bart dhe përcjell një kuptim tërësisht biologjik, që përkufizohet me përkatësinë riprodhuese të një qenieje, që mund të jetë bimë, shpend a kafshë. Është pikërisht fjala “grua” që e bën dallimin mbi përkatësinë njerëzore dhe sociale. Të njëjtën fjalë e hasim jo vetëm në këtë projektligj, por edhe në projektligjet e mëparshme.

Prandaj, Grupi i Lëvizjes “Vetëvendosje” në parim e përkrah këtë projektligj, mirëpo ndërmjet dy leximeve ne do t'i paraqesim amendamentet për plotësim dhe ndryshim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRESUESI: Nga Grupi “Nisma” flet Shukrije Bytyqi.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Projektligji për të ushqyerit me gjë vërtet është i një rëndësie të veçantë. Unë i përkrah propozimet dhe vërejtjet e bëra nga doktoresha Baftija. Vërtet, termi i përdorur “femra” mendoj që është një gabim.

Unë do ta paraqes hulumtimin që e ka bërë Drejtoria për Hulumtime dhe do ta bëj krahasimin e projektligjit tonë me projektligjin që është në Kroaci dhe në Zvicër.

Kroacia këtë çështje e ka të rregulluar me Ligjin për amësinë dhe ndihmë prindërore numër 71/05-03, me plotësim-ndryshim në vitin 2013 dhe 2014.

Mbrojtja e amësisë të fëmijët e porsalindur, të drejtat e prindërve, janë qëllim i rregullimit nga ky ligj.

Dispozitat e këtij ligji aplikohen në kushte të njëjta, si për prindërit në bashkësi martesore dhe jomartesore.

Sipas dispozitave të këtij ligji, nënat kanë të drejtë në pushim të lehonisë, leje prindërore, të punojnë me kohë të pjesshme për shkak të kujdesit intensiv të fëmijëve, të kenë pauzë për të ushqyerit me gji, punë me kohë të pjesshme, në mënyrë që të kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara e tjerë.

Pushimi i lehonisë, nëna ka mundësi të hyjë në pushim 28 ditë para lindjes së pritshme dhe ta përdorë atë për një periudhë të vazhdueshme deri 42 ditë pas lindjes.

Data e pritshmërisë së lindjes përcaktohet nga një mjek i zgjedhur i mjekësisë së përgjithshme, ose i mjekësisë familjare, me propozim të gjinekologut.

Nënat mund të marrin leje 45 ditë para lindjes së pritshme, duke u bazuar në rekomandimin e gjinekologut.

Ky ligj parasheh se nëse nënës i vdes fëmija para skadimit të periudhës së amësisë, ajo ka të drejtë të vazhdojë ta shfrytëzojë atë edhe tre muaj pas muajit kur e ka pasur kohën të lindë, edhe pasi fëmija i ka dështuar.

Karakteristikë e ligjit është edhe transferimi i drejtë nga një prind në prindin tjetër, nëse ekzistojnë arsyet, të cilat janë: i paaftë plotësisht, pjesërisht i paaftë në raport me kujdesin prindëror, nëse për arsye të ndryshme nga dhuna në familje i ndalohej t'i afrohet shtëpisë apo banesës në të cilën jeton fëmija.

Nëna gjatë përdorimit të së drejtës të përmendur më lart kanë të drejtë të kompensimit të pagave në vlerë 100%.

Pamundësia e rregullimit të ambientit sipas kërkesave ligjore ku punon, nëna sjell për pasojë të drejtën që ajo të largohet me kompensim në shumën e pagës përkatëse të saj.

Sa u përket prindërve adaptues, ata kanë të drejtë për një leje relative kohore, ose përjashtim nga puna dhe të drejtën e pagës, ose formë tjetër të kompensimit financiar sipas dispozitave të këtij ligji.

Ndërsa krahasimi me Ligjin në Zvicër është: Konfederata zvicerane për fitime e të ushqyerit me gji për foshnjat dhe promovimin e saj janë të njohura në mbarë botën.

Kjo çështje është e rregulluar me Ligjin federal zviceran lidhur me punën në industri e tregti, të datës 13 mars 1964, fillon prej 1 dhjetor 2013 dhe rregulloret të cilat përmbajnë dispozita të qarta për mbrojtjen e nënave me fëmijë në gji në vendin e punës. Rregullorja për mbrojtjen e nënës, e datës 20 mars 2001, që nga janari i vitit 2013.

Sipas nenit 35 të Ligjit të punës, gratë shtatzëna nga java e tetë para lindjes nuk duhet të punojnë ndërmjet orës 20:00 dhe orës 6:00 të mëngjesit.

Gratë shtatzëna dhe nënat të cilat i ushqejnë fëmijët me qumësht gjiri nuk duhet të punojnë natën dhe t'u ekspozohen rreziqeve.

Si punë e rrezikshme, ose e rëndë, për gratë shtatzëna konsiderohet puna e cila bëhet me ambiente të mbyllura, në temperaturë dhome nën 5 gradë celsius, ose më lart se 28 gradë celsius.

Sipas legjislacionit zviceran, në vitin e parë një nënë e cila fëmijën e saj e ushqen me gjë ka të drejtë ta ushqejë brenda ndërmarrjes, organizatës ose jashtë saj.

Në qoftë se nëna e ushqen fëmijën brenda ndërmarrjes, ndërmarrja e ka obligim që ta ketë një dhomë të posaçme në dispozicion për nëna, neni 34 i Ligjit mbi marrëdhënien e punës.

Nëna e cila e ushqen fëmijën me gjë, koha e gjidhënies llogaritet si kohë e paguar dhe nuk kompensohet as paraprakisht. as më vonë. Për gjidhënie për katër orë në punë të kryer nevojiten së paku 30 minuta, mbi 4 orë 60 minuta, dhe nga 7 orë në punë së paku 90 minuta.

Ndërmarrjet ose organizatat duhet ta posedojnë një dhomë të posaçme për t'u ushqyerit me gjë. Kjo dhomë duhet të jetë e pajisur me frigorifer, i cili nevojitet për ruajtjen e qumështit të gjirit.

Kushtet që nevojiten për ruajtjen e qumështit të gjirit të nënës janë: temperatura e dhomës për ruajtjen e gjirit duhet të jetë 16 deri 29 gradë për 3 deri në 4 orë, kurse 6 deri në 8 dhe në kushte shumë të pastër.

Sa i përket temperaturës së frigoriferit, ajo duhet të jetë 4 gradë celsius. Ndërsa frigoriferi me ngrirje të thellë duhet të jetë deri në 17 gradë celsius.

Unë mendoj se këto krahasime duhet t'i kemi parasysh dhe Grupi "Nisma" për Kosovën e mbështet parimisht këtë projektligj dhe amendamentet tona do t'i bëjmë me kohë në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Aleancën, Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj dhe jemi nisur nga të gjitha ato reforma që janë të domosdoshme në këtë drejtim. Ne mendojmë që të ushqyerit me qumësht të gjirit është i pazëvendësueshëm, nuk ka efekte anësore negative dhe në parim e përkrahim ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fikrim Damka për Grupin "6+" e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

“6+” Parlamenter Grubu olarak Anne sütü ile beslenme Kanun Taslağını incelediğimizi ve bu kanun taslağında anne sütü ve anne sütü yerine geçebilecek süt ürünlerinin kontrol altında olması, bunların düzenlenmesi, reklam kısıtlayıcı gibi sorunların bu kanun taslağında düzeltilmesinin son derece önemli olduğunu görmekteyiz.

Bildiğimiz gibi sağlıklı çocukların yetişebilmesi için, özellikle ilk iki yıl doğumdan sonra anne sütünün önemli bir yere sahip olduğunu, bunun yerine geçebilecek süt ürünlerinin en iyi bir şekilde kontrol edilmesi gerektiğine inanmaktayız. Elbette ki Avrupa standartlarında bu süt ürünlerinin ithal ve korunması ve bunun da kanun üzerine düzenlenmesi son derece önemli.

İş Kanunu neticesinde bildiğimiz gibi ilk altı ay ve sonrası doğum izinleri olmaktadır, fakat özellikle bazı sektörlerde annelerin ikinci altı ayda ödeme şekli olmadığı için günde iki saat olarak anne sütüyle çocukların beslenmesi zorunludur. Fakat bunu pratikte görmediğimizi ve görme açısından bunun uygulanması açısından hem Sağlık Bakanlığının, hem de Çalışma ve Sosyal Bakanlığının daha fazla İş Kanununa atıfen bulunması gerektiğine inanmaktayız.

“6+” Parlamenter Grubu bu Yasa Taslağını desteklemektedir ve gerekli önerileri sunacaktır. Sağolun!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash deputetët, sipas radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu, le të përgatitet Shaip Muja.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar ministër Abrashi,

Ndoshta është mirë që sot këtë projektligj e paraqiti ministri Abrashi për arsye se ka disa nevoja që të plotësohet edhe Ligji i punës dhe një harmonizim i këtij projektligji tani me Ligjin e punës është më se i domosdoshëm për arsye se edhe ky projektligj e prek Projektligjin e punës.

Që në fillim i jap mbështetje kësaj nisme ligjore, sepse me këtë projektligj promovohen përparësi dhe u jepet përkrahje nënave për t'i ushqyer foshnjat e tyre me qumësht gjiri.

Ministria e Shëndetësisë i merr përsipër detyrimet për t'i hartuar politikat shëndetësore dhe për t'i koordinuar aktivitetet për ta mbrojtur të ushqyerit me qumësht gjiri për 6 muajt e parë të jetës, si dhe vazhdimin e të ushqyerit me të deri në 2 vjet e më tepër.

Brenda kësaj periudhe kohore kur do të trajtohet ky ligj, mendoj se edhe në dëgjimet publike, edhe Komisioni Parlamentar, por edhe vetë ministria duhet që t'i marrin praktikën më të mira të Bashkimit Evropian sa i përket kësaj fushe.

Promovimi dhe inkurajimi i të ushqyerit me qumësht gjiri duhet të ofrojë informacione të sakta sa u përket përparësive të të ushqyerit me qumësht gjiri, ushqimin e drejtë për nëna, përgatitjen e nënës dhe foshnjës për gjidhënie, si dhe mangësitë e zëvendësimit të qumështit të gjirit me qumësht tjetër shtesë.

Me qëllim që të sensibilizohet rëndësia e familjes karshi këtij procesi të suksesshëm të të ushqyerit me qumësht gjiri, Ministria e Shëndetësisë në të kaluarën e ka organizuar edhe javën e

të ushqyerit me qumësht gjiri në Kosovë, e tani kjo po rregullohet me këtë ligj dhe i japim mbështetje, duke këshilluar vazhdimin me seancat edukative shëndetësore për rëndësinë e të ushqyerit me qumësht gjiri, ku duhet përfshirë, përveç tjerash, edhe njoftimet për rreziqet e futjes së hershme të ushqimit shtesë dhe kohën e duhur për fillim me ushqim shtesë. Gjithashtu, ushqyerjen e shëndetshme për fëmijët.

Dhe, krejt në fund, duhet pasur parasysh edhe kontrollet pas përfundimit të procesit të të ushqyerit, si për fëmijën, ashtu edhe për nënën.

Në nenin 5 të këtij ligji parashihen të drejtat për femrat që në projektligj, që në projektligj u theksua si femrat, plotësisht i përkrah vërejtjet që cilat u bënë se kjo terminologji duhet ndërruar, për gratë të cilat e ushqejnë foshnjën me qumësht gjiri.

Çdo e punësuar në pikën 2 të këtij neni thuhet që e ushqen foshnjën me qumësht gjiri nëse nuk e shfrytëzon pushimin e lindjes pas muajit të gjashtë të tij dhe pas dispozitave përkatëse ligjore në fuqi ka të drejtë edhe në pushimin me pagesë në kohëzgjatje prej dy orë në ditë brenda orarit të punës, duke përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri për periudhën e mbetur të pushimit të lehonisë.

Propozimi është që për pushimin me pagesë në kohëzgjatje për 2 orësh në ditë brenda orarit të punës, duke mos përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri, është në rregull, nëse ky pushim përfshin periudhën nga 6-mujori i parë deri në një vit.

Dhe nëse vërtet dëshirojmë që me ligj ta stimulojmë të ushqyerit me qumësht gjiri, atëherë pushimi me pagesë në kohëzgjatje për një orë në ditë brenda orarit të punës, duke përfshirë pushimin e rregullt gjatë orarit të punës për ta ushqyer foshnjën me qumësht gjiri duhet përfshirë edhe periudhën prej 1 deri në 2 vjet.

Kjo është një nga mënyrat për ta stimuluar ushqimin me qumësht gjiri në formë ligjore. Gjithashtu, mendoj që këtu është i nevojshëm një ndërrim apo plotësim i Ligjit të punës sa i përket çështjes së të drejtave për lehonat. Mendoj që edhe me plotësim-ndryshimin e Ligjit të punës, duhet paraparë që pas 6-mujorit të parë lehonat të kenë mundësi të punojnë me gjysmë pagese, e kjo do ta stimulonte pastaj edhe rritjen e natalitetit në Kosovë.

Njëra nga mangësitë e këtij ligji me 16 nene është se nuk parasheh masën ndëshkimore për ata të cilët nuk i respektojnë dispozitat ligjore të këtij ligji, si për punëdhënësit të cilët nuk u lejojnë lehonave t'i shfrytëzojnë të drejtat ligjore që u jap ky ligj - 2 orë në ditë pushim, apo një orë në ditë pushim, po ashtu edhe nuk parasheh masat ndëshkimore për ato nëna të cilat për arsye të ndryshme joshëndetësore ua ndërpresin foshnjave të ushqyerit me qumësht gjiri në 6-mujorin e parë.

Prandaj, mendoj që komisioni përkatës parlamentar duhet të fokusohet dhe mendoj edhe për masat ndëshkimore për ata të cilët nuk i respektojnë dispozitat ligjore.

E unë këto vërejtjet e mia, të cilat i dhashë në këtë projektligj, do t'i paraqes edhe si amendamente në komisionin përkatës brenda periudhës së paraparë ligjore.

Edhe një herë, është pak vështirë, meqë për disa projektligje nuk janë ministrat adekuatë. Ne në seancën e kaluar kemi pasur një anomali, kur ministri i Shëndetësisë e ka paraqitur Ligjin për armët, tash Ligjin për shëndetësi e paraqet ministri i Punës, e nuk e di për ligjet tjera cili do të vijë.

Mirëpo, unë mendoj që, krejt në fund, për një ministër dhe një dikaster qeveritar nuk është asgjë më e rëndësishme se miratimi i legjislacionit sa i përket edhe rregullimi i fushës me anë të ligjit, e kur kemi për ta bërë prezantimin dhe trajtimin e këtyre ligjeve mendoj që është më se e nevojshme që ministrat të jenë të pranishëm në diskutime bashkë me ne deputetët këtu. Është mirë që sot ministri Abrashi është këtu, për arsye se edhe ky ligj interferon dhe ka nevojë që të koordinohet dhe të harmonizohet edhe me Ligjin e punës, dhe është mirë që ka prezantuar sot, është i pranishëm këtu ministri Abrashi, e besoj që edhe në të ardhmen do të bashkëpunojmë edhe më mirë për t'i koordinuar këto dy sfera shumë të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shqip Muja, po ashtu mjek edhe ekspert.

SHAIPI MUJA: Unë ju falënderoj për epitelin që ma dhatë, por s'e kam emëruar veten ekspert, zoti kryesues!

KRYESUESI: Jo, ti je edhe mjek ekspert, por thashë mos i bini në qafë këtij, se gjysma e Kuvendit janë ekspertë mjekë, kështu që ju mund ta diskutoni.

SHAIPI MUJA: Unë nuk dua t'u bie ministrave, se Qeveria ashtu-kështu është duke i organizuar mbrapshtë disa çështje në prezantim.

Unë jam i befasuar këndshëm sot që ato të cilat kanë ushqyer fëmijë nuk janë duke bisedua sot këtu në Parlament. Ato e dinë më mirë problemet dhe sfidat që i nxjerr ky ligj.

Prandaj, edhe ne këtu që prononcohemi, nganjëherë ndoshta bëjmë gabime. Kjo sa për uverturë, kështu për relaks.

Por, një diçka që unë e shoh te ky ligj është vërtet ligj i mirë, mirëpo të jep përshtypje më shumë si një lloj ligji edukativ e preventiv për çështjen e ushqimit teknologjik, zëvendësues të qumështit të nënës. Dhe, nëse analizohet në aspektin e koalicionit si ligj me ligjet e lehonisë, për shembull, ky ligj transferon nga barra kur janë nënat dhe transferon edhe problemet në të ushqyerit me gji për shkak të rritjes së lehonisë dhe për shkak të mospasjes së trajtimit të mirë të lehonisë te femrat që janë shtatzënë.

Prandaj, në këtë ligj shoh diçka që nga aspekti social, që mendoj ministri adekuat është këtu sot, më adekuat se ai i Shëndetësisë, nëse ndahet do të duhej të jenë të dy ministrat, edhe ai për gjirin që flet, edhe ky për përkrahjen sociale.

Të ofroj mundësinë që të shohë jo restriksionin dy orë, një orë të shkoj nëna ta ushqejë fëmijën, sepse nuk mund nëna sa qëndron me fëmijën, bile së paku vitin e parë, të gjitha këto gra që kanë lindur këtu e dinë problemin më të madh, që pas 3 apo 6 muajsh, që e kemi pranuar ne një pushim me pagesë, disa pa pagesë, nuk jam shumë familjar me ligjin, ai është një problem i cili do të ndikojë direkt te fëmijët. Arsyeshmëria që ka qenë në ato ligje, e që sot edhe për këtë ligj për shembull që mund të ketë vend në leximin e dytë, është se ka kosto buxhetore.

Unë mendoj që nëse bëhet një analizë e mirë, një fëmijë i cili rritet shëndetshëm nga një nënë e kulturuar, nuk ka nevojë shumë që ne t'i japim edukim çka është biberoni, që janë edhe emra këtu 'brend-nema', siç quhen, ose 'fabrikan' që janë përdorur, e që nuk është dashur të jenë emra 'fabrikan' në një ligj të Republikës së Kosovës, por kanë shqiptime të tjera, ose edhe në gjuhë të tjera që ne i lexojmë.

Prandaj, duhet parë në leximin e dytë, jo me 2 orë pushim, por së paku ato gra të cilat e kanë certifikatën edhe nga mjeku, edhe nga analizat që bëjnë çdo dy muaj, të lirohen për një vit me pagesë nga puna, e nëse me vullnet të lirë pranohet të qëndrojnë në shtëpi në rritje të fëmijës së paku gjatë vitit të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit, Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që mua personalisht më provokoi fjala e kolegut Shaip, mirëpo mendoj që ne po koncentrohemi kryesisht në fushat kompetente. Unë kisha dashur vetëm ta vë një theks.

Tek neni 5, shqetësimi im nuk është te ligji, sepse ligji me të vërtetë është një ligj shumë përmbajtësor, të cilin e kam lexuar me vëmendje dhe i jam gëzuar adresimit të tij në Kuvend, mirëpo shqetësimi im qëndron tek implementimi. Ne po arrijmë ta krijojmë një legjislacion shumë të fuqishëm, mirëpo kur po vjen puna tek implementimi dhe qëndrimi prapa tij me buxhet financiar dhe me përcjellje të mekanizmave tjerë tek implementimi jam e shqetësuar, për shembull, te sektori privat.

Gratë e reja, të cilat janë të punësuar në sektorin privat, me keqardhje them se një pjesë e mirë e tyre ankohen shumë që nuk u realizohen të drejtat e tyre në aspektin edhe të pushimit, edhe të pushimit të lehonisë, edhe të pushimit vjetor. Dhe, në këtë rast po e mendoj një nënë të re, e cila merr pushim, e cila nuk dëshiron ta shfrytëzojë komplet pushimin dhe vjen pas 6 muajve në punë. Dyshoj që një lider në një kompani do t'ia japë të drejtën asaj nënë që të shkojë dhe ta ushqejë me gjë fëmijën e vet për dy orë. Nëse e ka një orë pushim dhe dy orë të tjera të cilat i lejohen me ligj që të shkojë për t'i dhënë gjë fëmijës në shtëpi, unë kam frikë se kemi do ta dekurajojmë sektorin privat që t'i punësojë nënat dhe femrat e reja. Kryesisht do të kërkojnë femra të cilat nuk janë në moshë të volitshme për të lindur fëmijë.

Mirëpo, për këtë, ne sigurisht kemi mekanizma dhe do të duhet t'i shfrytëzojmë instrumentet dhe kryesisht do ta thërras Inspektoratin e Punës që t'i përcjellë se sa do të arrijnë ta implementojnë, konkretisht sektori privat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Derisa presim, kush i di më mirë, unë e dëgjova vërejtjen që në ligj është barazuar kuptimisht nocioni “femër” me “grua”. Pajtohem që çdo femër nuk është grua, siç pajtohem që çdo grua nuk është nënë, e po ashtu siç pajtoheni edhe ju që çdo nënë nuk i jep gjë fëmijës. Kështu që finesat e tilla nganjëherë vërtet duhet të precizohen dhe unë pajtohem që duhet të precizohen aty ku duhet, patjetër.

Po presim derisa t’i kemi numrin. Atëherë, derisa t’i presim ata, e shqyrtojmë ligjin tjetër:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim e miratim në parim.

E ftoj ministrin Abrashi që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Shërbimi mjekësor emergjent organizohet si fushë e veçantë e veprimtarisë shëndetësore me qëllim që ofrimin të kujdesit mjekësor emergjent të pandërprerë për qytetarët, të cilëve për shkak të sëmundjes apo lëndimit u është rrezikuar drejtpërdrejt jeta, organi i caktuar apo pjesë të caktuara të trupit, respektivisht shkurtimit të kohës optimale nga ndodhja e rastit emergjent deri në fillimin e procesit të trajtimit përfundimtar.

Me këtë ligj përcaktohen kushtet, organizimi dhe mënyra e funksionimit të shërbimit mjekësor emergjent në Republikën e Kosovës.

Riorganizimi i sektorit të shëndetësisë, i bazuar në Ligjin e shëndetësisë 04/L-125 i vitit 2012, e ka paraqitur nevojën e ndryshimit të ligjit aktual për kujdes shëndetësor emergjent me numër 2/L-50 të vitit 2006.

Kujdesi shëndetësor emergjent ndërlidhet me strategjinë sektoriale të shëndetësisë 2015-2020, objektivi i parë që ka të bëjë me përmirësimin e shërbimeve mjekësore emergjente të gjendjes shëndetësore të popullatës në kushte të paqes dhe gjendjes së jashtëzakonshme dhe ngritjen e kualitetit të shërbimeve mjekësore emergjente.

Detyrimet të cilat dalin nga ky ligj do të kontribuojnë në uljen e vdekshmërisë, sëmundshmërisë dhe invaliditeteve të shkaktuara nga gjendjet emergjente mjekësore përfshirë traumën, emergjencat pediatrike dhe obsterike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Abrashi! Tash e hap debatin në parim për këtë ligj.

Kryetarja e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e shqyrtoi në parim Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent dhe ia dha vizën ose rekomandimin që ligji të procedohet më tutje.

Komisioni pati dhe ka shumë dilema, edhe pse ia dha miratimin, ka dilema të shumta rreth këtij projektligji që na ofrohet.

Pse e dhamë miratimin? Për shkak se niveli i shëndetësisë së një vendi matet edhe me shërbimin e organizuar të emergjencave shëndetësore, por kjo nuk varet vetëm nga ligji, varet edhe nga kushtet e punës, kuadrot që punojnë aty dhe shumë gjëra të tjera. Por, ne në mënyrë që të kemi mundësi ta përmirësojmë këtë projektligji, të shohim sa mund ta përmirësojmë, e proceduam më tutje.

Vërejtjet kryesore të komisionit janë dhe ato do të shqyrtohen në tryezat e rrumbullakëta dhe debatet që do t'i organizojë komisioni me ekspertë dhe me njerëzit që e njohin këtë lëmi.

Sigurisht në këtë lëmi na duhet edhe përvoja e shteteve të tjera, sidomos shteteve të regjionit, pasi ligji gati në këtë strukturë ka ekzistuar edhe më parë, por ja se shumë shpejt erdhi si formë e re e ndryshimit të ligjit.

Prandaj, ne do të merremi seriozisht, të shohim sa mund ta përmirësojmë në këtë projektligj dhe me dilemën se ndoshta do të vijë edhe te mospranimi i tij, nëse nuk kemi mundësi ta përmirësojmë ashtu si duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Brovina! Tash kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Nga PDK-ja, Fadil Beka e ka fjalën.

FADIL BEKA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj në parim dhe i jep mbështetje, por kontributin tonë do ta japim në komisionin përkatës.

Desha, zoti nënkryetar, t'i paraqes edhe pikëpamjet e mia rreth kësaj çështjeje.

Një nga sfidat kryesore të sistemit shëndetësor, jo vetëm te ne, por edhe më gjerë, është organizimi, konsolidimi, funksionalizimi dhe menaxhimi i shërbimeve emergjente mjekësore kur kihet parasysh që kemi të bëjmë me të sëmurë apo të lënduar, kur drejtpërdrejt u është rrezikuar jeta, organi, apo sisteme të organeve, apo pjesë të caktuara të trupit, e që kërkohet të shkurtrohet koha optimale nga ndodhja e rastit emergjent deri në fillimin e procesit të trajtimit përfundimtar.

Shërbimet mjekësore emergjente janë të organizuara në të tri nivelet e shërbimit shëndetësor: në nivelin primar, nëpërmjet qendrave të mjekësisë familjare; në nivelin sekondar në spitalet rajonale dhe në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ne, si Kosovë, organizimin e shërbimit emergjent mjekësor me doktrinë të re e kemi filluar pas luftës, kur janë krijuar kuadrat e para specialistike me ndihmën e Spitalit "John Hopkins" të

Shteteve të Bashkuara, si dhe përgatitjet dhe trajnimi edhe i stafit të mesëm, e për këtë mund të mburremi se jemi ndër të parët në rajon. Normalisht, trajnimet duhet të jenë në vazhdimësi.

Shërbimi mjekësor emergjent, edhe pse quhet i tillë, nuk mund të funksionojë si i vetëm. Pra, i duhet mbështetja e Policisë dhe Shërbimi i Zjarrfikësve, e pse jo edhe i FSK-së.

Pra, duhet të funksionojë si një trup me organizim, me koordinim dhe komunikim dhe kështu të krijohet një sistem i integruar me kod të veçantë.

Ta zëmë, nëse vjen informata për një të sëmurë, apo për një aksident, në të njëjtën kohë këtë informatë duhet ta pranojë edhe Policia, edhe shërbimi emergjent mjekësor, por edhe zjarrfikësit.

Kjo do të mundësojë veprim më të shpejtë, më efikas dhe më të koordinuar. Kjo besoj mund të bëhet pa vështirësi dhe pa shpenzime të mëdha.

Institucionet që sot ofrojnë shërbime emergjente mjekësore që nga niveli primar, sekondar e terciar, kanë nevojë për mbështetje, duke filluar që nga auto-ambulancat e reja, e që të jenë të pajisura me aparaturë të nevojshme moderne, e pse jo në nivel të vendit ta kemi edhe ndonjë helikopter-ambulancë.

Nëse nisemi nga Qendra Klinike Universitare, them me përgjegjësi se ajo posedon personel të përgatitur, si superior, ashtu edhe personel të mesëm, por mungojnë aparaturat e nevojshme dhe infrastruktura.

Për shembull, në Qendrën Emergjente janë vetëm tetë shtretër për reanimim, kurse në mjekimin intensiv qendror 14 shtretër për gjithë Kosovën si qendër terciare dhe e gjithë kjo e bën të pamundur për ta përballuar fluksin e madh të rasteve të të sëmurëve, apo të të lënduarve.

Duke u nisur nga kjo, Partia Demokratike në programin e vet qeverisës, në kuadër të Misionit të Ri, ka paraparë ndërtimin e Qendrës së re Emergjente në kuadër të QKUK-së, ku do të bëhet ofrimi i shërbimeve cilësore emergjente mjekësore për të gjithë qytetarët dhe banorët në nevojë, e kjo do të realizohet.

Pengesë të veçantë sot për shërbimin emergjent mjekësor për ta përmbushur misionin e vet, me gjithë sfidave tjera, janë edhe rrugët dhe komunikacioni i dendur, sidomos në orët e pasdites, sepse asnjë qytet i Kosovës nuk ka rrugë të veçantë apo korsi të veçantë për shërbime emergjente, e kjo pamundëson që në kohë optimale të sëmurëve apo të lënduarve t'u afrohet ndihma e nevojshme.

Ata që janë mjekë e dinë që për shkak të sëmundjes apo të lëndimit dhe humbjes së sasisë së gjakut, organizmi i njeriut dhe qelizat e tij pësojnë ndryshime ireversibile, me ç'rast mjekësia moderne është e pafuqishme të veprojë, pra nuk mund të bëjë mrekulli.

Dhe, për fund, i gjithë personeli që ofron shërbime emergjente në të gjitha fushat mjekësore meriton status të veçantë, si në benefite materiale, ashtu edhe të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Hatim Baxhaku, për LDK-në, e ka fjalën.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Projektligji për shërbimin mjekësor emergjent e paraqet një sektor shumë të rëndësishëm të veprimtarisë shëndetësore në kuadër të sistemit të tërësishëm të shëndetësisë, i cili ka për detyrë ofrimin e kujdesit mjekësor emergjent për qytetarët në momentet kur atyre, për shkak të sëmundjes, traumës ose aksidenteve tjera u është rrezikuar jeta apo shëndeti, respektivisht e ka për detyrë shkurtimin e kohës optimale nga momenti i aksidentit apo sëmundjes akute dhe mbështetja shëndetësore gjatë kësaj kohe, deri në institucionin përkatës të trajtimit përfundimtar.

Rritja e patologjive dhe aksidenteve që kërkojnë trajtim emergjent si pasojë e ndryshimit të dinamikës së jetës, rritjes së komunikacionit, industrializimit të shoqërive, bën që nevojat për shërbime të shpejta, por edhe cilësore emergjente shëndetësore të jenë në rritje çdo ditë dhe të kërkojë në vazhdimësi reforma në këtë shërbim.

Në Kosovë, rrjeti i shërbimeve emergjente nuk e ka një rrjet të konsoliduar dhe të integruar. Prandaj, nevoja për një ligj të ri të shërbimeve emergjente është më se e nevojshme.

Edhe procesi i integrimi në Bashkimin Evropian kërkon që kjo fushë të rregullohet me ligj, duke i respektuar standardet evropiane në rregullimin e infrastrukturës, pajisjeve mjekësore, materialit shpenzues, sistemit të komunikimit dhe rregullimin e çështjeve të harxhimit dhe stokeve të barnave, si dhe të ambulancave me standarde evropiane.

Edhe pse edhe ky ligj nuk i përmbush në tërësi këto synime, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah këtë projektligj në parim dhe kontributin e vet do ta japë ndërmjet dy leximeve me amendamentimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk kemi paraqitje të grupeve të tjera. Besa Baftija, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Me të vërtetë është për të të ardhur keq nga mosprania e ministrave, sidomos e ministrave të fushave përkatëse, të cilët para nesh e prezantojnë ligjin, siç është një Ligj i emergjencës, ekspert i së cilës lëmi edhe është vetë ministri i Shëndetësisë.

Do të kishte qenë mirë që ai sot të jetë këtu, ta paraqesë para nesh, të na japë argumente pse ne duhet ta votojmë këtë projektligj, një projektligj i cili edhe ashtu nuk i përmbush kriteret që të kalojë sot në këtë Kuvend.

Fusha e emergjencës është shumë e rëndësishme, meqenëse ofron shërbime mjekësore në drejtim të stabilizimit të parametrave vitalë të pacientëve.

Për këtë arsye, është më se i nevojshëm rregullimi me një ligj të mirëfilltë. Mirëpo, dua të them që në fillim se kjo nevojë për projektligj është transformuar në një kërkesë për kompetenca e fuqizim deri diku individual brenda Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Bëhet fjalë për një zonë të projektligjit, ku parashikohet rregullim për nivelin spitalor terciar.

Në tërësi, ky ligj i rregullon nivelet e organizimit shëndetësor emergjent në tri nivele, ato që lidhen me atë primar e sekondar janë realitativisht të parashikuara mirë.

Mirëpo, sa i përket organizimit dhe administrimit të shërbimit mjekësor emergjent në nivelin terciar, në nenin 12 theksohet formimi i shërbimit të traumatologjisë në kuadër të Klinikës Emergjente. Kjo është vërtet jashtë çdo kuptimi, qoftë institucional, qoftë profesional.

Është edhe ideja që brenda një ligji emergjent për t'u futur edhe shërbimet traumatologjike, që është plotësisht e gabuar, qoftë nga aspekti funksional, po ashtu edhe ai financiar.

Nëse pretendojnë që të kenë mjekë specialistë të fushave të ndryshme, të përhershëm në emergjencë, përveç atyre që janë specialistë të emergjencës, atëherë kjo e ka një kosto shtesë financiare dhe një efekt të padukshëm sa i përket cilësisë së kurimit të pacientëve, sepse do të ishte dyfishim i kuadrit dhe infrastrukturës, e ky do të ishte një gabim i madh i shtuar në sektorin shëndetësisë, edhe ashtu i dështuar tash e 16 vjet.

Në nenin 9, paragrafi 2, thuhet se Klinika e Emergjencës dhe e Traumatologjisë ofron shërbime mjekësore emergjente dhe zhvillon të gjitha veprimtaritë në lëmi të domosdoshëm për kontrollim, diagnostifikim, trajtimin të pacientëve emergjentë, observim deri në stabilizim dhe transferin e tyre në repartet përkatëse, ose lëshimin në shtëpi pas stabilizimit në mënyrë definitive.

Atëherë shtohet pyetja: Në cilat reparte, në ato të Qendrës Klinike Universitare, apo të Klinikës Emergjente?

Ndërsa dihet që Emergjenca ofron shërbime deri në stabilizim të shenjave vitale të pacientëve, e më tutje është e detyrueshme që rastet e rënda, që ato të trajtohen në klinikat e specializuara të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, të cilat ekzistojnë për këtë gjë.

Ne kemi kontaktuar me profesionistë të fushave specialistike dhe ata na kanë vërtetuar se ajo çfarë parashikohet në projektligj është gabim dhe ka pasoja të rënda në funksionimin e brendshëm të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Shumë mjekë janë dhe kanë qenë kundër kësaj ideje me argumente e shpjegime, por ata nuk janë konsultuar, as nuk janë marrë parasysh dhe këtu para jush dhe para nesh ka ardhur versioni i vetëm i një grupi, që nënkuptohet se i kanë gjetur lidhjet e duhura te ministri i Shëndetësisë.

Me sa duket, këtu ka pasur vetëm konsultim me drejtorin aktual të Emergjencës, doktor Basri Lenjanin, siç ceket edhe në memorandumun shpjegues të këtij projektligji. Rezultati është futja në ligj e një interesi individual.

Duke marrë parasysh që ministri është edhe specialist i Emergjencës, duhet të ishte ai i pari që të mos e pranonte këtë formë të organizimit të Emergjencës të nivelit terciar.

Ne do të votojmë kundër këtij projektligji dhe bëjmë thirrje që Qeveria ta tërheqë dhe të rifillojë procesin e konsultave me drejtorët specialistë të shërbimeve spitalore klinike universitare, të bëjë diskutime publike, të paraqiten para opinionit versionet e opsionet të propozuara, e më pas të vijohet puna në Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pal Lekaj, për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj për shërbime mjekësore emergjente dhe ne si çdo herë jemi për reforma, por ato reforma të jenë në funksion të sistemit, jo në duplikim të sistemit që kanë kosto buxhetore mjaft të madhe.

Sa u përket reformave në sistemin shëndetësor, ne jemi larg atyre synimeve tona dhe premtimeve që i kemi dhënë, sepse nëse nisemi nga mjekësia primare dhe nëse shohim nëpër komuna që kenë duplikim të emergjencave, mendoj që kjo e ka një kosto shumë të madhe dhe nuk përket me profilizimin e sistemit apo shërbimeve mjekësore shëndetësore, e sidomos në Qendrën Klinike Universitare, ku mendohet që të grumbullohet i tërë shërbimi, tërë profesionalizmi që i kushton mjaft kësaj natyre.

Nëse nisemi që me ligj janë paraparë shumë profesionistë të grumbullohen në Qendrën Klinike Universitare, mendoj që kjo Ministrisë së Shëndetësisë dhe Buxhetit të Kosovës do t'i kushtojë shumë kur janë mjekët e profilizuar dhe mendoj që gjithë kjo është bërë në interes të individëve të caktuar.

Ajo që mund të them është se reformat janë të domosdoshme, por ato që shkojnë në favor të thjeshtësisë së sistemit, e jo të komplikimit të sistemit. Nëse bartet një pacient, ta marrim prej Gjakovës deri në Prishtinë, vetëm rruga e gjatë, e nuk mendohet fare transporti ajror, mendoj që në këtë drejtim ne jemi prapë larg sistemit.

Ne mendojmë që do ta japim kontributin tonë për këtë projektligj dhe do ta sanksionojmë në mënyrë të efektshme gjithë atë që duhet të shkojë në favor të sistemit të reformave shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Shkuri Bytyçi, për “Nismën”, e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka shqyrtuar Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent. Vërtet ky projektligj është shumë i rëndësishëm, por në mungesë të ministrit të Shëndetësisë këtu, ne vërejtjet tona do t'i bëjmë me kohë.

Ky projektligj nuk ka implikime buxhetore vetëm aq sa parashihet këtu, edhe pse edhe në këtë projektligj ministri nuk e ka cekur se kah do t'i merr të hollat për këto shërbime.

Prandaj, ne nuk do ta përkrahim këtë projektligj derisa të plotësohen kushtet, sepse vërtet ne nuk kemi as infrastrukturë për shërbime emergjente. Fillimisht t'i plotësojmë ato, e mandej të na vijë ligjet.

Ne nuk jemi të interesuar të bëjmë vetëm ligje, por të kemi zbatueshmëri të ligjeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fikrim Damka, për Grupin “6+”, e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Saygıdeğer milletvekiller

“6+” Parlamenter Grubu olarak Acil İlk Yardım Yasa Tasarısını incelediğimizi ve sağlık açısından özellikle de ilk yardıma muhtaç olan hastalarımızın veya kişilerin zamanlama açısından ulaşılması doğrultusunda hayat kurtardığını ve bu Yasa Taslağını “6+” Parlamenter Grubu olarak desteklediğimizi ifade eder.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli!

Nënkryetar Hamiti,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj është i nevojshëm për arsye se rregullon një fushë të rëndësishme të shërbimit emergjent dhe është më se e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me qëllim të përgatitjes edhe të kuadrit, por edhe të infrastrukturës mjekësore për ndërhyrje në rastet emergjente.

Gjithashtu, mendoj që përveç që këtij ligji që parasheh edhe rregullon kujdesin emergjent, është e nevojshme që me këtë projektligj të përfshihet edhe kujdesi intensiv për arsye se shpeshherë rastet e kujdesit emergjent apo nevoja për kujdes emergjent kërkojnë edhe kujdes tutje shtesë intensiv dhe siç tha edhe doktor Fadil Beka, sot Kosova ka për kujdesin intensiv vetëm 14 shtretër për 2 milionë banorë.

Edhe në mandatin e kaluar kam tërhequr vërejtjen për numrin e vogël të shtretërve në Qendrën Klinike Universitare dhe për nevojën që kujdesi intensiv të përgatitet edhe në qendrat tjera, nëpër spitalet tjera rajonale. Për fat të keq, sot në spitalet rajonale kujdesi intensiv në disa prej tyre punon me gjysmë kapaciteti, e në disa nuk është i aktivizuar, nuk punon fare, e ne po flasim për një kujdes të veçantë emergjent që kërkon një hallkë të tërë të organizimit shëndetësor për të shpëtuar jetë apo për ta zvogëluar vdekshmërinë, apo edhe paaftësinë për këta pacientë që edhe në rast të traumave të zvogëlohet edhe paaftësia e tyre për jetë.

Mirëpo, ne po flasim për një sistem që kërkon një nivel të lartë të kujdesit, ndërsa sistemi aktual shëndetësor nuk është duke funksionuar dhe do të doja që sot ministri i Shëndetësisë të na prezantonte se cilët janë objektivat e tij për sistemin aktual shëndetësor, për arsye se u tha edhe në elaborimin e ministrit Abrashi se ky projektligj rrjedh për shkak të nevojës pas ndryshimit të ligjit, apo hartimit të ligjit të ri për Shëndetësinë në vitin 2012, L-125, dhe është parë e nevojshme që kjo sferë të rregullohet tani edhe me ligj të veçantë.

Dhe, ne do të donim që ministri i Shëndetësisë, Imet Rrahmani, të na precizonte se mendon të vazhdojë me këtë sistem shëndetësor, mendon ta ndryshojë këtë sistem shëndetësor, për arsye se kemi parë disa deklarime publike të tij, duke thënë se ka disa mangësi në sistemin shëndetësor, dhe për shembull ka deklaruar që tani duhet shqyrtuar mundësinë që Qendra Klinike Universitare ta ketë drejtorin e saj për arsye se për momentin drejtorit të Qendrës Klinike Universitare i është shuar posti i tij dhe është me ligjin aktual parashihet të jetë drejtori i SHSKUK-së, e tani ne duhet ta rregullojmë këtë çështje - ku po duam të shkojmë me sistemin shëndetësor?

Dëshirojmë që gjendjen aktuale ta përmirësojmë. Nuk kemi ne problem me mungesë të ligjeve. Tani kemi bërë një përgatitje ligjore të nevojshme, e kemi bërë Ligjin e ri të shëndetësisë, Ligjin e sigurimeve shëndetësore, Ligjin e odave shëndetësore dhe sa i përket aspektit të infrastrukturës ligjore, sistemi shëndetësor nuk ka problem. Ne kemi problem në menaxhimin e këtij sistemi, për arsye se në klinikat tona kemi më shumë shtretër se sa doktorë, e kjo duhet të rregullohet dhe i takon sferës së Ministrisë së Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për politikat dhe kuadrot, e ne kemi mungesë kuadro në sektorin sekondar.

Si mund ta organizojmë sistemin emergjent kur ne nuk kemi kuadro në asnjë prej spitaleve regjionale dhe kur kthehemi te ky sistem emergjent, në Spitalin Rajonal të Mitrovicës ne i kemi 5 aparatura të reja, e kemi të përgatitur kujdesin emergjent dhe kujdesin intensiv, e aty nuk ka kush punon!

Prandaj, mendoj që ministri i Shëndetësisë do të duhej fillimisht të fokusohet në stabilizimin e këtij sistemi shëndetësor, në funksionalizimin e këtij sistemi shëndetësor. Qendra Emergjente në Prishtinë nuk mund t'i përpijë të gjithë pacientët e Kosovës. Vërtet, nëse u ka rënë për ta vizituar këtë qendër, mjekët e saj ndodhen para një presioni të hatashëm, në veçanti kur kanë 4-5 aksidente njëkohësisht dhe këta mjekë kërkojnë dhe do të duhej të trajtoheshin në mënyrë të veçantë edhe sa i përket aspektit të benefiteve për ta, por edhe të meritave, të cilat këta mjekë i kanë të jashtëzakonshme në shpëtimin e jetës dhe në kushtet në të cilat punojnë.

Prandaj, ministri i Shëndetësisë mendoj fillimisht të fokusohet në këndelljen e këtij sistemi shëndetësor dhe pastaj të shkojë me hapa më tutje edhe për rregullimin e sistemit emergjent, por pasi ta ketë funksionalizuar sistemin shëndetësor në tërësi.

Ne po ballafaqohemi me një katrahurë të këtij sistemi, e kjo duhet të evitohet dhe të rregullohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hatim Baxhaku e ka fjalën.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Para nesh sot e kemi një diskutim apo lexim të parë Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent, i cili është një ligj i rëndësishëm së veçantë, jo vetëm në kuadër të ligjeve që e rregullon fushën e shëndetësisë në tërësi, por është një ligj me rëndësi të veçantë edhe në aspektin e interesit nacional.

Shërbimi i mjekësisë emergjente paraqet një sektor të veçantë, por shumë të rëndësishëm në kuadër të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve, në kushte dhe raste shumë të veçanta, me qëllim të uljes së vdekshmërisë, sëmundshmërisë dhe invaliditetit të shkaktuar nga gjendjet e rënda emergjente, siç janë: trauma, emergjenca internistike, gjinekologjike, pediatrike dhe neuropsikiatrike etj.

Është një sektor i veçantë, sepse të veçanta janë edhe momentet dhe sëmundjet patologjike dhe lëndimet, të cilat kërkojnë trajtim dhe shërbim emergjent mjekësor. Janë këto çrregullime të rënda, të papritura që kërkojnë trajtim emergjent, në të kundërtën rrezikojnë jetën, apo në raste tjera dëmtojnë rëndë dhe pakthyesëm shëndetin e pacientit, duke shkaktuar invaliditet të përhershëm.

Të veçanta janë kushtet në të cilat duhet të ofrohet shërbimi mjekësor, sepse ai duhet të ofrohet në rrugë, në shtëpi, gjatë transportit, ndonjëherë dhe në kushte të veçanta të numrit të madh të atyre që kërkojnë ndihmë në raste të lëndimeve, aksidenteve dhe fatkeqësive të ndryshme natyrore.

Të veçanta janë edhe limitet kohore në të cilat duhet të ofrohet shërbimi mjekësor, si dhe i veçantë duhet të jetë përkushtimi, profesionalizmi, shkathësia dhe përgatitja e personelit mjekësor dhe jo vetëm atij mjekësor, i cili i ofron shërbimet mjekësore. Organizimi i shërbimit mjekësor emergjent për shkak të kostos së lartë financiare, por edhe qasjes multidisciplinare që kërkon paraqet një sfidë dhe problem serioz edhe për shtetet shumë më të zhvilluara ekonomikisht. Prandaj, duke u nisur nga kjo, unë jam i vetëdijshëm se ky projektligj është bazuar në mundësitë buxhetore të shtetit tonë dhe nuk mund të jetë perfekt, por përbën një bazë të mirë dhe të nevojshme për rregullimin e kësaj fushe me ligj.

Unë nuk dua të ndalem në atë se si do të dëshiroja të ishte ky ligj dhe si do të dëshiroja ta kishim shërbimin shëndetësor emergjent në Kosovë, por do të ndalem në disa çështje, të cilat mund t'i bëjmë në këtë se si mund ta bëjmë këtë shërbim shumë më efektiv dhe cilësor me mundësitë financiare ekzistuese, por me një riorganizim, menaxhim dhe ristrukturim, sidomos në nivelin e shërbimit mjekësor emergjent paraspitalor apo primar, sepse ai spitalor qëndron shumë mirë.

Së pari, propozuesi i ligjit, edhe pse pohon se me këtë ligj ka synim ta harmonizojë në nivel kombëtar rolin dhe funksionin e të gjitha qendrave lokale të thirrjeve emergjente, siç janë: mjekësia familjare, qendra e mjekësisë urgjente, qendrat rajonale operative emergjente, policia, zjarrfikësit etj., këtë nuk e rregullon dhe nuk e përkufizon me asnjë nen.

Së dyti, me këtë ligj nuk rregullohet mirë dhe qartë mënyra e organizimit të shërbimit mjekësor emergjent parësor, pra paraspitalor në aspektin territorial në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe nevojat e kohës. Pra, nuk përcakton se në sa banorë duhet të organizohet dhe themelohet një

qendër e mjekësisë emergjente, nuk parashihet themelimi i qendrave mjekësore urgjente rajonale dhe pastaj lidhjen e tyre në nivel horizontal dhe vertikal me një qendër nacionale të shërbimit mjekësor urgjent.

Të nderuar deputetë,

Organizimi i mirë territorial i rrjetit të institucioneve që ofrojnë shërbime mjekësore emergjente paraspitalore, do të mundësonte plotësimin edhe të një kriteri tjetër shumë të rëndësishëm, të cilin duhet ta përmbushë një shërbim mjekësor emergjent me standarde evropiane, e që është intervali kohor ndërmjet thirrjes për shërbim mjekësor emergjent dhe momentit të arritjes së ekipit, i cili do ta ofrojë këtë shërbim, e që për zonat urbane sillet nga 10-15 minuta, për ato rurale nga 15-20 minuta dhe koha brenda së cilës pacienti duhet të sillet në institucionet spitalore nuk duhet të jetë më shumë se një orë e ashtuquajtur “ora e artë” për shpëtimin e pacientit.

Për fund, mendoj që ky projektligj ka mangësi të shumta, është përgatitur në mënyrë shumë të shpejtë. Kjo shihet edhe nga mangësitë dhe gabimet e mëdha që ka në formulimin e fjalive, gabime të shumta gjuhësore dhe ndonjëherë shumë vështirë është t’i bihet në fije se çka ka dashur të thotë me ndonjë përkufizim, në qoftë se personi nuk është profesionist mjekësor. Por, megjithatë, unë mendoj se me një amandamentim të mirë gjatë dy leximeve, ky ligj mundëson një organizim të shërbimit mjekësor emergjent, i cili do të mundësonte vendosjen e standardeve të kërkuara nga Bashkësia Evropiane në infrastrukturë, pajisje, barna, material shpenzues, autoambulanca me standarde evropiane, me pajisje bashkëkohore, me resurse profesionale.

Prandaj, në parim unë përkrah këtë projektligj dhe do të mundohem që kontributin tim ta jap në Komisionin Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në grupin parlamentar ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë

Para se të filloj ta jap opinionin tim për këtë projektligj, e kam një vërejtje e cila e konsideroj që është krejt teknike. Në këtë projektligj, në deklaratën e përputhshmërisë me Legjislacionin e BE-së për shëndetin mendor, konsideroj që është gabim teknik, prandaj ne si deputetë tani nuk e dimë nëse Projektligji për shërbimin mjekësor emergjent është në përputhshmëri me Legjislacionin e BE-së, apo jo.

Të nderuar,

Ky projektligj përcakton kushtet, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të shërbimeve mjekësore emergjente në Republikën e Kosovës. Investimet në këtë shërbim në shikim të parë nuk gjenerojnë të ardhura, por në fakt janë shërbime, të cilat shpëtojnë jetë dhe këto shërbime të ofruara në kohën e duhur dhe në mënyrë profesionale shpëtojnë individët nga invaliditeti i përhershëm, e që në mënyrë indirekte gjenerojnë shumë të ardhura, sepse në të kundërtën do t’i kushtonte shumë familjes dhe shoqërisë kujdesi për një person që mbetet invalid si pasojë e mosofrimit të ndihmës së duhur nga shërbimi mjekësor emergjent.

Për këtë arsye, shërbimi mjekësor emergjent ka nevojë për buxhet shtesë, sepse buxheti i paraparë për tre vjetët e ardhshme është i pamjaftueshëm. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij shërbimi, përveç mjeteve të nevojshme të punës, është e domosdoshme që punëtorët shëndetësorë, të cilët punojnë në shërbimet mjekësore emergjente në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor të kenë stimulim shtesë, sepse natyra e punës është e rëndë dhe shumë stresuese.

Në këtë projektligj unë kam disa vërejtje, të cilat besoj që do të merren parasysh gjatë punës në Komisionin Funkcional. Sipas nenit 3, pika 1.7, me “mjek specialist i emergjencës” nënkuptohet mjeku i cili e ka kryer specializimin nga mjekësia emergjente dhe është licencuar, thuhet nga Ministria e Shëndetësisë. Duke pasur parasysh faktin se Ligji për odat e profesionistëve shëndetësorë është miratuar nga Kuvendi dhe sipas këtij ligji licencimi i profesionistëve shëndetësorë bëhet nga odat, duhet të thuhet “është licencuar nga odat e mjekëve të Kosovës”.

Mandej, në nenet 9 dhe 12 shpesh i referohet QKUK-së, e duhet të jetë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar, në mënyrë që të harmonizohen me Ligjin e shëndetësisë. Është e rëndësishme që Ministria e Shëndetësisë, sipas këtij ligji, do ta caktojë një zyrtar për shërbime mjekësore emergjente, i cili do t’i koordinojë dhe zbatojë politikatat shëndetësore të Ministrisë së Shëndetësisë për shërbimin mjekësor emergjent.

Por, Këshilli për shërbime mjekësore, sipas nenit 33, parashihet që të funksionojë në bazë të aktit nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë. Duke e pasur rëndësinë profesionale që duhet ta ketë Këshilli për Shërbime Mjekësore, mendoj që në dispozitat e këtij ligji do të duhej të përcaktohej numri i anëtarëve, përzgjedhja e tyre, kriteret që duhet t’i plotësojnë anëtarët e këtij këshilli, financimi dhe shumë çështje tjera, e kurrësi të mos mbetet të rregullohet me akt nënligjor kjo çështje kaq e rëndësishme.

Kur jemi te kriteret, mendoj se kriteret duhet të ketë edhe për personelin shëndetësor që përcaktohet të punojë në shërbimin mjekësor emergjent, sidomos për kuadrin e mesëm. Përveç edukimit të vazhdueshëm profesional, stimulimit shtesë që duhet ta kenë këta punëtorë, që e ceka edhe më herët, do të duhej që të përcaktohet edhe koha, periodha kohore sa gjatë këta punëtorë do të mund të kontribuojnë në këtë shërbim, duke pasur parasysh natyrën e punës.

Pra, për punën në këtë shërbim duhet të trajnohen dhe përgatiten në vazhdimësi kuadro të reja, e kjo çështje mund të lihet që të rregullohet me akt nënligjor. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ne jemi mësuar të kalojmë shumë ligje, por nganjëherë është mirë që të mos kalojmë ligje, të cilat dikush mund t’i përdorë për qëllimet e dizajnit të vetë ose interesave të një grupacioni të caktuar që ta deformojë qëllimin e ligjit.

Në terminologjinë e këtij ligji, me gjithë vullnetin e mirë të atyre që kanë punuar, unë ia shoh për të madhe Ministrisë së Shëndetësisë që e ka lëshuar një ligj të tillë, i cili, përveçse nuk bën lidhje logjike, nuk ka as shpjegim konfigurues praktik të funksionimit të sistemit urgjent mjekësor në

Republikën e Kosovës. Shpjegimet emergjente dhe urgjente janë të ndryshme për shkak të terminologjisë së gjuhës angleze, të cilët e kanë përkthyer në mënyrë bukfalet.

Po qesh Profesor Sabriu, sepse e di që është ashtu, se e ka lexuar që është përkthim bukfal dhe ka gabime të tilla, të cilat nuk janë në funksion. Ky ligj është munduar të sjellë diçka të mirë, mirëpo e sjell një kaos i cili mund të sjellë një keqpërdorim duke i dhënë dikujt mundësi fiktive me ligj, por jo përmbajtjesore në shërbim shëndetësor të Republikës së Kosovës.

Do të filloj me radhë, ndoshta nuk do t'ju lodh. Problemi fillon, ligji përveç prej preambulës që e ka mirë se është për t'ia shpëtuar jetën, t'i stabilizojë tjerat me radhë janë shumë keq.

Ligji jep përshtypjen se neni 8 thotë, “shërbimi mjekësor emergjent, kujdesi shëndetësor dytësor duhet të sigurojë ekzaminimin e hollësishëm mjekësor për të gjithë pacientët e pranuar në gjendje emergjente, stabilizimin e tyre dhe transferin në qendrën terciare pas stabilizimit”. Me këtë ligj thuhet, “autoambulanca që e merr të sëmurin në rrugë, e që ai e luan rolin kryesor që e ka marrë, ai kuadër që e ka marrë në rrugë, thotë “e çon deri në spital, në spital ia ndalin gjakun dhe mandej gjakderdhjen ose e stabilizojnë dhe nuk obligohet spitali regjional t'i japë trajtim shëndetësor edhe në bazë të kompetencave profesionale, por i thotë dërgoje menjëherë në Qendrën Universitare”. Sa është keq, e bën edhe më keq sot shërbimin shëndetësor në Qendrën Universitare.

Mandej, neni 9, thotë “veprimtaria e shërbimit mjekësor emergjent në kujdesin tretësor”, thuhet “klinika emergjente formohet si klinikë emergjente”, sepse e kanë përzier konceptin e shërbimit të klinikës emergjente, në çdo klinikë që është e shërbimit sekondar edhe terciar kanë klinika emergjente dhe traumatologjike. Do të thotë po formohet një institucion traumatologjik pa e ditur ne se në çfarë forme po formohet.

Më vonë, në nenin 10, kalon neni 9, nga sistemi traumatologjik, në nenin 12 thotë: “shërbimi traumatologjik është shërbim jetik, i cili zbatohet në kuadër të klinikës emergjente dhe traumatologjike”. Do të thotë, një herë e formon tani e devijon, e minimizon dhe e humb komplet kuptimin çka do të formohet me këtë klinikë.

Tjetër problem të cilin është shumë interesant ta dimë, unë nuk e kam kuptuar, thotë “shërbimi emergjent edhe në sistemin privat, edhe në sistemin publik”. Zoti kryetar, shërbimi emergjent mjekësor është njësi e veçantë e sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës dhe hyn në kategorinë që nuk përfshihet në ligj absolutisht. Përfshihet në situatat e krizave, përmendet në mënyrë shumë sipërfaqësore. Nuk përmenden as Forcat e Sigurisë së Republikës së Kosovës, roli i tyre, koordinimi i tyre se çfarë roli do të kenë këto në shërbimin emergjent dhe cilat janë rolet në rolin e komandimit dhe të referimit të situatave emergjente.

Pastaj, në nenin 27, thotë, “kushtet nga aspekti i karakteristikave teknike të mjeteve, cakton edhe tipin e autoambulancës”. Në ligj thotë sipas standardit N-17/89 të kodit, që nuk është i domosdoshëm. Në përfundim, e sipër kjo të jep të kuptosh sikur dikush ka folur me ata që kanë për t'i marrë ambulancat. Dhe, në pikën 3 të nenit 27 thotë, “numri i automjeteve të institucionit shëndetësor emergjent duhet të jetë i barabartë me numrin e ekipeve të kontraktuara të pajtuara”.

Domethënë kjo qenka, s'po e kuptoj nëse është private, a do të kontraktojnë privatisht autoambulanca. Është një mish-mash.

Për ta finalizuar komplet këtë farë mish-mashi tregon edhe kostoja financiare që e kanë paraqitur këtu. Kostoja financiare thotë, “diku 15 mijë euro në vitin e parë, në vitin e dytë të 23 mijë dhe në vitin e tretë është 23 mijë euro”. Do të thotë, për paga dhe mëditje është diku 8 mijë euro dhe 8 mijë euro në shërbimet tjera. Domethënë nuk e kuptojnë komplet rolin e esencës së shërbimit urgjent.

Shërbimi mjekësor urgjent është baza e shpëtimit të jetës së pacientit dhe në sistemet e ndryshme evropiane, amerikane dhe izraelite, ndryshon shërbimi në resurset humane. Nuk ka mjek specialist emergjent në autoambulancë, por ka bile teknikë, infermierë këtu që i përmendët, quhen paramedikë. Në Amerikë janë vullnetarë të Kryqit të Kuq, të cilët janë të profesionalizuar për dhënien e ndihmës së parë, stabilizimin me ndihmën e parë dhe një mjek eventualisht në bazë të thirrjes që e ka identifikuar. Këtu nuk paraqitet as roli i policisë, as i zjarrfikësve në thirrjet e trajtimit prioritar.

Nuk paraqitet as triazhimi me kode, që janë standarde, për atë edhe nuk e kanë arritur pajtueshmërinë, zonja deputete, sepse e kanë përzier, sepse që s'e kanë vënë për Ligjin e gjirit, por te sistemit mendor, e kjo tregon që nuk kanë pasur as sistem mendor të qartë tash që po bisedojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Fillimisht e përshëndes ardhjen në Kuvend të këtij projektligji dhe në rend të parë dua ta përshëndes menaxhmentin dhe stafin e shërbimit mjekësor emergjent, të cilët e bëjnë një punë të shkëlqyeshme kur i dimë sfidat me të cilat ballafaqohen ata dhe kushtet jo të mjaftueshme të punës. Kur e kemi parasysh mungesën e kushteve të punës, mund të themi lirisht se puna e tyre është astronomike në krahasim me kushtet që i kanë dhe me çka ballafaqohen ata çdo ditë, duke filluar nga kushtet e punës, po ashtu edhe nga presioni familjar që u bëhet kur ata kanë pacientë nëpër këto klinika.

Unë nuk do t'i përsëris ato çka i thanë kolegët e mi, mirëpo do t'i ngre vetëm dy çështje që kam hasur gjatë leximit të këtij projektligji. Është fillimisht te memorandumimi shpjegues, tek objektivat ku është pika e parë që thotë, “kjo fushë ndërlidhet me strategjinë sektoriale, korniza parimore, politika dhe strategji kombëtare, vizioni afatgjatë 2012-2025, objektiva e parë që ka të bëjë me uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë”. Konsideroj që fjala “sëmundshmërisë” është gabimisht në këtë rend dhe nuk e ka kuptimin që është menduar të thuhet në objektiva dhe konsideroj që në gjuhën shqipe kemi fjalë më të përshtatshme dhe më adekuate.

Gjithashtu, desha të ndalem edhe te neni 4, pika 13, që thotë, “gatishmëria për fatkeqësi dhe reagimi i gjithmbarshëm”, unë konsideroj se duhet të jetë “gatishmëria për reagimin e

gjithëmbarshtëm në raste fatkeqësie”, sepse është keq e përpiluar dhe unë do të bëj amendamentin dhe do ta dorëzoj në Komisionin Funkcional, ku pastaj ata do të marrin në shqyrtim, apo jo.

Prandaj, kërkoj që këto gabime të përmirësohen, sidomos kur kemi të bëjmë me përkthimin ndoshta të materialeve, ose thjesht në përpilimin në gjuhën shqipe, sepse shpeshherë na vihen fjalë ose terma, të cilët nuk kanë asnjë kuptim kur e kuptimin e mirëfilltë në gjuhën tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Si fillim, në opinionin që e ka dhënë Ministria e Financave, ky ligj ka kosto buxhetore dhe nuk parashihet që të financohet nga Republika, apo nga Ministria e Financave me këtë kosto buxhetore që e ka dhe në fakt ne, si deputetë, jemi lodhur duke sjellë ligje, të cilat kanë një kosto dhe nuk fillon të implementohet. E kemi rastin e njëjtë edhe me Ligjin për sigurime shëndetësore, i cili është dashur të fillojë të implementohet në janar të këtij viti, por fatkeqësisht do të kryhet ky vit e nuk do të kemi implikim dhe zbatim në praktikë të këtij ligji.

Shëndetësia është në një kaos, e njëjta është edhe me sistemin emergjent, jo për shkak të punës së punëtorëve shëndetësorë, të cilët punojnë me zell dhe me përkushtim në kushte të mjerueshme të punës, pa barna dhe pa ilaçe, por për shkak të një menaxhimi të keq që po i bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, dhe në këtë sistem duhet të bëhet një reformë totale. Edhe kështu në Qendrën Emergjente kanë ankesa për sistemin e referimit, sepse kanë ankesa se pacientët pa nevojë ndoshta nuk trajtohen në qendrat tjera referuese, ose në spitalet rajonale, dhe në qendrat kryesore të mjekësisë familjare, nuk përpunohen pacientët ashtu si duhen në vendin e ngjarjes dhe të gjithë sillen në Qendrën Klinike Universitare.

Domethënë, duhet të rregullohet sistemi i referimit, sepse edhe kështu Qendra Klinike Universitare ose Qendra Emergjente në kushtet dhe në situatën në të cilën gjendet nuk ka mundësi të trajtimit të pacientëve, sepse ata nuk ka shtretër për hospitalizim dhe pacientët në shumicën e rasteve, në mungesë të infrastrukturës së mjaftueshme, trajtohen nëpër korridoret e emergjencës.

Ashtu qysh po parashihet me këtë ligj, që të rregullohet trajnimi i stafit, e kjo klinikë të emërohet si klinikë emergjente dhe traumatologjike, nevojitet personel i shumtë shtesë, për çka nevojitet një buxhet shtesë dhe meqenëse Ministria e Financave prapë në fillim me atë që është llogaritur që ka implikime buxhetore, plus implikime tjera buxhetore, unë mendoj që nëse kalon ky ligj nuk ka mundësi të zbatohet, ose veç po kalohet një ligj sa për të thënë që po e kalojmë një ligj, ose e kemi sjellë një ligj sa për me thënë që e kemi sjellë një ligj, sepse me këto kushte që është sjellë nuk do të ketë mundësi të realizohet në praktikë dhe ky ligj edhe nëse kalon nuk do të ketë mundësi të implikimit.

KRYETARI: Faleminderit! Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryetar!

Unë fillimisht e mora fjalën, por prapë po e marr që do të kishte qenë mirë, siç thashë në fillim, po të ishte ministri që të jepte përgjigje. Sa i përket terminologjisë, që u cek paraprakisht nga deputeti Shaip Muja, pasi edhe unë jam eksperte e kësaj fushe, do t'ju them se termat “emergjenca” dhe “urgjenca” janë ashtu të tilla siç janë këtu në përdorim, që do të thotë dallon shumë termi sa për sqarim “emergjencës” prej “urgjencës”.

Është diçka tjetër që të jetë emergjente, që është diçka shumë e vështirë, më e rëndë, duhet intervenim i menjëhershëm, e urgjenca është diçka më e lehtë që nëse duhet të intervenohet, por jo në atë mënyrë që edhe nëse nuk intervenohet nuk e rrezikon jetën e pacientit.

Për këtë arsye e pashë të arsyeshme që të sqaroj që këta dy terma, që u tha që nuk janë mirë të përkthyer, janë mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Na doli punë ndërmjet ekspertëve, replikë ka kërkuar Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Unë nuk pretendoj që jam ekspert i shëndetësisë, por di të lexoj edhe di të klasifikoj, kur thashë që ky ligj është bërë nga disa ndërkombëtarë që kur mbeten pa punë u thonë vendorëve, “e di çka, e bëjmë një ligj edhe e gjejmë njëfarë forme dhe këta thonë ‘po’, prandaj hajt te përkthejmë”.

Nëse di zonja të thotë anglisht si është “urgjent” dhe “emergjent”, atëherë unë ia pranoj çka ka thënë, mirëpo nëse si profesionalist kur ofroresh afër pacientit, di të klasifikosh në shkallë, për këtë lëmi bile në aspektin ushtarak jam shumë i specializuar për këtë punë me edukim prej NATO-s, ndërsa për aspektin civil prej Organizatës Botërore të Shëndetësisë, merr e konsulto literaturën, këtë ta mbroj me certifikatë. Faleminderit!

KRYETARI: Armend, mos e deshe fjalën, lirisht, se edhe ti je ekspert. Në qoftë se ka dikush, se mbetëm të paqartë Profesor. Askush më nuk është lajmëruar për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë? Nuk dëshiron fjalën. Atëherë, të nderuar deputetë, e lëmë për më vonë, në qoftë se kishim pasur mirëkuptim në orën 18:30 të vijnë deputetët t'i votojmë këto pikat, të cilat na mbetën.

Ne po e vazhdojmë diskutimin e pikave, por në orën 18:30 i kisha ftuar shefat grupeve parlamentare t'i ftojnë deputetët të vijnë për votim, në mënyrë që të kemi kuorum, se tani nuk kemi kuorum.

Atëherë, vazhdojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në parim.

E ftoj ministrin e Punës, zotin Arban Abrashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mungesa e Ligjit për shëndetin mendor është vlerësuar si mangësi e sistemit shëndetësor të Republikës së Kosovës. Nevojat e përditshme të profesionistëve të shëndetit mendor për një dokument ligjor, i cili do t'i rregullonte shumë fusha të përgjegjësisë profesionale të tyre, duke filluar nga trajtimi i detyruar, trajtimi në masën e izolimit preventiv, si dhe nevoja për t'u siguruar respektimi i të drejtave njerëzore për personat me çrregullim mendor e kanë bërë nxjerrjen e këtij ligji si të domosdoshëm.

Të nderuar deputetë,

Me këtë ligj definohen parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor, të drejtat e personave me çrregullime mendore, organizimi i shërbimit të shëndetit mendor në të gjitha nivelet, shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentët, trajtimi, rehabilitimi, riintegrimi dhe risocializmi i personave me çrregullime mendore, si dhe përcaktohen mënyrat e ndërgjegjësimi të shoqërisë lidhur me këto çrregullime.

Ky ligj, po ashtu i rregullon edhe shërbimet e shëndetit mendor në institucionet e përmbarimit të vendimeve penale, si dhe në institucionet e posaçme psikiatrike, mekanizmat e monitorimit të brendshëm dhe të jashtëm të shërbimeve të shëndetit mendor, si dhe sanksionimin e shkeljeve procedurale dhe ligjore.

Ky projektligj është në harmoni të plotë edhe me strategjinë sektoriale të shëndetësisë 2015-2020, objektivi i parë, ruajtja dhe përparimi i shëndetit të pjesës që ka të bëjë me avancimin e shëndetit mendor dhe me strategjinë kombëtare kundër drogave.

Projektligji ka formën dhe strukturën standarde që përdoret në Legjislacionin e Republikës së Kosovës, është në pajtim me Kushtetutë dhe detyrime ndërkombëtare, si dhe është i përafërt me dispozitat e detyrueshme të 'acquis communautaire' të BE-së.

Prandaj, edhe ju ftoj që ta përkrahni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Flora Brovina e ka fjalën nga Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Gjithashtu në mbledhjen e përmendur, më 29 prill të këtij viti, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e shqyrtoi në parim Projektligjin për shëndetin mendor dhe dha mendimin për miratimin në parim të këtij ligji.

Kemi shumë arsye të kërkojmë që shërbimin shëndetësor për shëndetin mendor ta kemi në nivel të duhur, sepse jemi një shoqëri me shumë probleme, së pari shoqëri në tranzicion dhe si e tillë pra i ka nevojat e veta, pastaj një shoqëri e dalë nga lufta me shumë probleme sociale, me papunësi të lartë dhe me probleme që dalin edhe nga migrimi i lartë i popullatës. Shoqëri e përcjellë me shumë trauma të luftës, sidomos ekspertët vërtetojnë se sindromi post-traumatik i luftës është më i larti ndoshta në regjion, për shkak se lufta në Kosovë realisht nuk ka zgjatur

vetëm dy vjet sa mendohet, por shtypja dhe terrori kanë zgjatur shumë vite më shumë, prandaj edhe traumat janë në përqindje të lartë.

Çështjet e pazgjidhura sikur janë të ish-luftëtarëve, të viktimave civile të luftës, pasojat tjera sikur familjet e personave të pagjetur, pastaj gratë dhe burrat e dhunuar gjatë luftës dhe probleme të tjera e të tjera.

Në kohët e fundit, këtij problemi i shtohet në masë të madhe edhe përdorimi i të rinjve me probleme narkotike, e kjo është një çështje që gjithashtu na tërheq vërejtjen për shëndetin mendor dhe trajtimin e kësaj kategorie.

Komisioni mendon që ta shqyrtojë në detaj këtë ligj dhe ta japë kontributin e vet nëpërmjet amandamentimit, prandaj edhe e propozon që ta aprovojmë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga grupet parlamentare, Fadil Beka nga Partia Demokratike e Kosovës e ka fjalën.

FADIL BEKA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim e mbështet, kurse kontributin tonë do ta japim në Komisionin FunkSIONAL. Desha, zoti kryetar, t'i shtroj edhe disa çështje rreth rëndësisë së këtij ligji.

Shërbimet e shëndetit mendor janë afuar edhe paraluftës në Kosovë, kryesisht në Klinikën e Psikiatrisë, ambulancës specialistike dhe në nivelin e mbrojtjes parësore në njësitë e mjekësisë së punës, si shërbim i veçantë specialistik. Pas luftës, konkretisht në vitin 2000, me përkrahjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë ka filluar puna në reformimin e shërbimeve të shëndetit mendor - qasja e shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet, që në vete nënkupton largimi nga institucionet e mbyllura psikiatrike. Shërbimet e shëndetit mendor të bazuara në komunitet përfshijnë në vete, si: Klinikën e Psikiatrisë në QKUK, repartet psikiatrike në spitalet rajonale, qendrat për shëndet mendor në komunitet dhe shtëpitë integruese.

Klinika e Psikiatrisë është e nivelit tretësor e mbrojtjes shëndetësore kompetente për diagnostifikim dhe trajtimin e rasteve, të cilat nuk mund të zgjidhen në nivele më të ulëta. Është përgjegjëse për përpilimin e protokolleve të trajnimit dhe mbikëqyrjen e punës profesionale, si dhe edukimin e kuadrove të reja, përkatësisht psikiatrave të rinj.

Repartet e psikiatrisë në spitalet rajonale janë institucione të shëndetit mendor, ku bëhet trajtimi i rasteve, të cilat kanë nevojë për trajtim spitalor për një afat të caktuar kohor. Qendrat për shëndetin mendor, të bazuara në komunitet, janë institucione të shëndetit mendor, të cilat përkujdesen për risocializmin e pacientëve kronikë psikiatrikë, rehabilitimin dhe mbikëqyrjen e trajtimit të tyre nëpërmjet vizitave në terren. Bën psiko-edukimin e familjeve, të cilat kanë familjarë me probleme të shëndetit mendor.

Shtëpitë integruese janë institucione shëndetësore të shëndetit mendor, ku vendosen klientët me probleme të shëndetit mendor, të cilët e kanë kaluar një kohë më të gjatë në spitalin psikiatrik. Qëndrimi i tyre është deri në 6 muaj, kohë gjatë së cilës punohet në rehabilitime dhe risocializmin e tyre.

Dhe, së fundi, e kemi Institutin për Psikiatrinë Forenzike, që është një institucion specifik, i cili e ka rolin e veçantë në sistemin gjyqësor dhe në atë shëndetësor.

Pas përfundimit të rasteve, qendra për shëndet mendor dhe shtëpitë e mbrojtura duhet të jenë në shërbim të trajtimit të mëtutjeshëm të klientëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hatim Baxhaku e ka fjalën.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji për shëndetin mendor ka për qëllim ta rregullojë mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor dhe garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore.

Po ashtu, ka për qëllim t'i përcaktojë procedurat për mbrojtjen shëndetësore të shëndetit mendor nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, mjedise sociale të përshtatshme për persona me çrregullime mendore dhe politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Kosova si një vend i dalë nga lufta natyrshëm që përballet me një numër më të madh të personave me probleme mendore si pasojë edhe e traumave gjatë luftës, përveç faktorëve tjerë. Mungesa e Ligjit për shëndetin mendor ka paraqitur probleme, si për punëtorët shëndetësorë, ashtu edhe për pacientët të cilët vuajnë nga këto probleme. Për punëtorët shëndetësorë, mungesa e një ligji ka paraqitur vështirësi të mëdha në zbatimin e profesionit të punëtorëve shëndetësorë që merren me trajtimin e pacientëve me probleme të tilla, e për pasojë ofrimi i këtij shërbimi shëndetësor ka qenë i mangët dhe jo i kënaqur.

Po ashtu, edhe pacientëve me probleme shëndetësore, në mungesë të këtij ligji nuk ka mundur t'u garantohet e drejta elementare njerëzore, që është trajtimi profesional dhe i dinjitetshëm, idetë e garantuara ndërkombëtarë. Prandaj, ne mendojmë se miratimi i këtij ligji do të sjellë të mira, si për pacientët që vuajnë nga këto sëmundje, po ashtu edhe për profesionistët shëndetësorë. Prandaj, Grupi Parlamentar në parim e përkrah këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në vijim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Besa Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Fillimisht, edhe unë e kam një vërejtje për Sekretarinë, sepse kemi ndërrim të deklaratave të përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së. Te Projektligji për shërbimin mjekësor emergjent e kemi atë të shëndetit mendor, kështu që kjo është një vërejtje, me siguri ata do ta rregullojnë.

Në Republikën e Kosovës nuk kemi pasur Ligj për shëndetin mendor. Deri më tani janë cenuar rëndë të drejtat e pacientëve me çrregullime mendore, madje ka raportime të shumta për abuzime çnjerezore. Ato janë të keqtrajtuar jo rrallë edhe nga rrethi shoqëror, por çka është më e rënda edhe nga ata që quhen “profesionistë” të shëndetit mendor.

Edhe pse është vonuar shumë shqyrtimi i këtij projektligji, ende jemi në kohë për të marrë masa në rregullimin e kësaj fushe. Me këtë projektligj vendosen rregullativat bazike në fushën e shëndetit mendor, vendosen bazat për përmirësimin e shërbimeve në këtë fushë, po ashtu garantohen formalisht dhe legjitimohen detyrimet institucionale për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, si dhe u lehtësohet puna e profesionistëve të ndershëm e korrektë dhe u vështirësohet abuzuesve të deritashëm.

Ky projektligj e rregullon trajtimin e vullnetshëm dhe të pavullnetshëm, e rregullon trajtimin në institucione të vendimeve penale, rregullon mënyrat kur bëhet heqja e zotësisë dhe mënyrat e mbrojtjes së të drejtave të tyre.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosjes” do ta votojë në parim këtë projektligj, i cili e rregullon një fushë kaq të rëndësishme të lënë pas dore deri më tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë. Fatmirësisht, ky projektligj ka qenë edhe në legjislaturën e kaluar, është amandamentuar nga Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, por për shkak të shpërbërjes së Parlamentit ka ngelur në komision.

Unë e shoh se gati të gjitha ato amendamente që janë punuar në Legjislaturën e kaluar nga Komisioni Parlamentar janë përfshirë tash në këtë projektligj dhe ne si grup parlamentar do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shukrije Bytyqi, nga “Nisma”, e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka shqyrtuar me shumë vëmendje Projektligjin për shëndetin mendor, i cili vërtet është i domosdoshëm dhe ka qenë mungesë deri më tani, sidomos e shoqërisë sonë në Kosovë, meqë jemi një shoqëri e dalë nga lufta, jemi një shoqëri me probleme ekonomike, probleme sociale, probleme edukative, probleme narkotike kohët e fundit, e shumë probleme tjera.

Vërtet shërbimet e personave me probleme mendore i kanë kryer klinikat e neuropsikiatrisë dhe neurologjisë, por ka qenë mungesë e rehabilitimit të tyre dhe vërtet ka qenë mund i madh për familjet, të cilat kanë persona me sëmundje mendore. Miratimi i këtij projektligji dhe zbatimi i tij në të ardhmen vërtet i ndihmon edhe familjet, edhe personat, edhe gjithë shoqërinë, se jemi dëshmitarë që pothuaj nuk kalon ndonjë muaj që nuk raportohet për ndonjë incident që shkaktohet edhe në shkollë, edhe në rrugë nga personat me probleme mendore.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar e mbështetim në parim këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Nga “6+”, Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Sayın milletvekiller,

Ruh Sağlığı Yasa Tasarısı “6+” Parlamenter Gurubu tarafından incelendiğini ve ilk okunuşunu desteklediğimizi ifade etmek istiyorum. Bu yasa özel bir öneme sahip, çünkü toplumumuzun bireyleri olarak bu kişilere ayrı bir önemle bakılması gerektiğini, bunu da bu yasa taslağı içerisinde düzenlendiğini ve haklarının hangi şekilde koruyacaklarını ve düzenleyecekleri bu yasa içerisinde düzenlenmektedir, biz inanıyoruz ki bu yasa taslağına geçen yasama döneminden kalan bu yasanın gerekli düzenlemeler yaparak “6+” Parlamenter Grubu olarak önerilerimizi sunacağız. Teşekkür ederim!

KRYETARI: Faleminderit! Shaip Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që ligjet të cilat disa po i komplimentojnë dhe po i vlerësojmë si urgjent për kolegët tanë, të cilët i dëgjova, dua t’ju lexoj vetëm një diçka tek opinionin e Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave për vlerësimin e ndikimit buxhetor.

Thotë kështu: “Departamenti i Buxhetit, Ministria e Financave, në lidhje me vlerësimin e ndikimit buxhetor, të përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë, në vijim paraqet opinionin e pavarur, duke bërë të ditur se kostoja shtesë për zbatimin e këtij projektligji nuk është planifikuar me kornizën buxhetore 2015-2017”, që i bie se ky ligj duhet të fillojë të implementohet në vitin 2018. Prandaj, ne nuk është dashur ta sjellim këtë ligj këtu në Parlament, deri diku më 2017, e të kishim filluar implementimin për vitin 2018.

Pa hyrë për t’i shpjeguar në detaje disa probleme, në të cilat gjeneron ligji, edhe nga aspekti strukturor i funksionimit të shtëpive për trajtim të sistemit të shëndetit mendor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë na ka dëgjuar. Vazhdojmë deri në orën 18:00, për shkak të mungesës së kuorumit, kur t’i vëmë në votim.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj Zenun Pajazitin, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ta marrë fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 24 prill 2015, e shqyrtoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014 dhe Kuvendit ia paraqet rekomandimin që të miratohet ky raport.

Po ashtu, më lejoni ta shfrytëzoj rastin të ju them që Komisioni i Pavarur për Media e ka një varg aktivitetesh të rëndësishme në këtë kohë. Janë pasqyruar në raport të gjitha aktivitetet që i kanë kryer, janë të prezantuara po ashtu edhe disa sfida të tyre. Ndër aktivitetet më të rëndësishme paraqitet procesi i digjitalizimit, me çka do të merret ky komision, dhe përgatitjet që i kanë bërë në raport po ashtu janë pasqyruar dhe gjithashtu janë pasqyruar edhe vështirësitë që i ka pasur me mungesë stafit. Fatmirësisht, ky komision tash është më i kompletuar dhe shpresojmë që proceset në vijim, që janë të rëndësishme, siç është procesi i digjitalizimit, mund të tejkalohen më lehtë.

Po ashtu, do ta shfrytëzoj rastin si kryetar komisioni t'i shfaq edhe vështirësitë që i kanë paraqitur në mungesë të buxhetit. Ata konsiderojnë që mungesa në buxhet tash do t'u paraqesë vështirësi në punën e tyre të mëtutjeshme. Shpresoj që kjo do të reflektohet, në mënyrë që në rishikim ose në procesin tjetër të shikohet mundësia që këto vështirësi teknike financiare të mos paraqiten.

Edhe njëherë i ftoj grupet parlamentare, si dhe deputetët që të votojnë, ta miratojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Naser Osmani, si kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni i Pavarur për Media e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2014 brenda afatit ligjor.

Raporti pasqyron të dhëna për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimin e tyre nga viti paraprak. Në raport janë pasqyruar edhe të hyrat që i ka realizuar Komisioni i Pavarur për Media.

Për Komisionin e Pavarur për Media në vitin 2014 janë ndarë 1 milion e 483 mijë e 539 euro nga Buxheti i Kosovës, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë një shumë prej 1 milion e 415 mijë e 174 euro dhe ky ndryshim përfshin rritjen e pagave për 25% me vendimin e Qeverisë, po ashtu edhe zbritjen në kategorinë mallra dhe shërbime për 15%, gjithashtu nga vendimi i Qeverisë.

Komisioni i Pavarur për Media ka shpenzuar gjithsej 1 milion e 370 mijë e 440 euro, apo 97% të buxhetit të vet. Po ashtu, Komisioni i Pavarur për Media ka realizuar të hyra nga shitja, nga taksa

për licencë në shumën prej 325 mijë e 162 euro dhe këto mjete i ka derdhur në Buxhetin e Kosovës.

Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa konsideron që Komisioni për Media i ka përmbushur të gjitha kushtet formalo-ligjore dhe standardet e raportimit dhe i rekomandojmë Kuvendit për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kalojmë te kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Xhevahire Izmaku, nga Partia Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë Parlamentar e ka shqyrtuar raportin e Komisionit të Pavarur për Media. Duke e ditur faktin që kemi të bëjmë me një organ kushtetues, ne e kemi shqyrtuar punën e tij në vazhdimësi, posaçërisht ne si anëtarë të komisionit përkatës dhe mendojmë që ky komision në mënyrë gjenerale është duke e kryer një punë të mirë dhe për herë të parë i kemi anëtarët e bordit, të cilët janë kompetentë për fushën në të cilën operojnë.

Më lejoni të them se raporti është i tillë që përmban detaje prej të gjitha aktiviteteve, të cilat janë të obliguar si komision t'i kryejnë në bazë të ligjit, duke filluar nga miratimi i akteve nënligjore, me të cilin proces kanë ardhur në përfundim, me përjashtim të Rregullores për operimin e operatorëve kabllorë, të cilin po presim që do ta përfundojnë së shpejti.

Bashkëpunimi i Komisionit të Pavarur për Media me operatorët e licencuar ka qenë në vazhdimësi, ka vazhduar edhe tani. Ka qenë një proces i vështirë gjatë hartimit të strategjisë për digjitalizim, të cilin Komisioni i Pavarur e ka pasur si sfidë gjatë vitit 2014 dhe e ka përfunduar me sukses. Kjo vazhdon tani edhe me projektligjin që e kemi shqyrtuar në parim ne si Kuvend - Projektligjin për digjitalizimin. Duke pasur vërejtjet e tyre si anëtarë dhe si trup ekzekutiv, ne si deputetë do t'i përcjellim vazhdimisht vërejtjet e tyre, sepse vërejtjet e tyre janë profesionale dhe që vijnë nga njerëz kompetentë.

Pra, kemi të bëjmë me një kompetencë, të cilën ne si Kuvend ua kemi dhënë këtyre njerëzve dhe këtij organi, mirëpo me Ligjin për digjitalizim devijohet deri në masën kur ne duhet t'i ndryshojmë pastaj edhe disa ligje të tjera. Për këtë sigurisht që do të flasim në pjesën e dytë, kur e kemi Ligjin për digjitalizim.

Pajtueshmëria e shërbimeve mediale audiovizuale, të licencuara në KPM, me aktet nënligjore ne e kemi një statistikë, të cilën na e ka ofruar si Kuvend, ky komision, pra e kemi gjithsej këta operatorë të licencuar, janë 20 televizione, prej tyre një stacion publik, trembëdhjetë stacione që operojnë në gjuhën shqipe, pastaj pesë televizione në gjuhën serbe, një stacion në gjuhën turke. Dhe, gjithsej shtatëdhjetë radiostacione, disa prej të cilave operojnë në nivelin nacional e disa të tjera në atë regional dhe lokal.

Si problem më vete, Komisioni i Pavarur për Media në këtë raport potencon shfrytëzimin e spektrit frekuencor në territorin e Republikës së Kosovës. Këtu e kemi edhe një problem, që është një problem i cili vazhdon që nga paslufta, pra kemi problem me mbulueshmërinë e territorit të Republikës së Kosovës, me frekuenca dhe në këtë masë këto janë frekuenca

televizive. Ne kemi pengesë të veçantë mosshfrytëzimin e majës së Goleshit. Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, ndërsa ne si Kosovë nuk kemi mundësi ta përdorim. Këtë e përdor vetëm KFOR-i dhe atë për radiot në frekuenca FM, mirëpo kjo kërkesë duhet të adresohet, jo vetëm nga Kuvendi, por mendoj se duhet të shkojë edhe nga nivelet tjera, si Presidenca e të gjitha organet, pasi që në këtë mënyrë nëse ne arrijmë ta shfrytëzojmë majën e Goleshit, atëherë i gjithë territori i Republikës së Kosovës, mbi 90% do të ketë mundësi që të ketë mbulueshmëri të frekuencave televizive.

Ne si anëtarë të Komisionit dhe si Grup Parlamentar, sigurisht se jemi të shqetësuar edhe me kërkesat dhe sfidat e tyre, të cilat i përmendi në Komision, pra është mungesa e një stafi më të madh, staf i cili do të ketë shumë sfida gjatë realizimit të procesit të digjitalizimit. Procesi i digjitalizimit nuk është proces i lehtë dhe është proces që kërkon burime njerëzore të fuqishme profesionale, të cilat kanë nevojë që t'i rrisin, pra Komisioni i Pavarur për Media me këtë buxhet është e pamundur.

Po ashtu, Komisioni i Pavarur për Media ka obligim ligjor të procedojë me ndërtimin e Allotmentit "Kosova", i cili e mundëson pastaj të fillojë epoka e digjitalizimit në vendin tonë. Këtë nuk e ka të mundur, nëse në pjesën e dytë të rishikimit të buxhetit, ne si Kuvend nuk ia ofrojmë një buxhet të shtuar.

Komisioni i Pavarur për Media ka departamentet e veta, me të cilat funksionon. Kemi, për shembull, Departamentin e monitorimit tek çështja e mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve, shihet që kemi një raport më pozitiv, pra gjatë vitit të kaluar ka pasur vërejtje më shumë, këtë vit kemi më pak vërejtje në këtë drejtim. Ne përgëzojmë për punën e mirë, që ka bërë, duke i vrojtuar dhe përcjellë me vëmendje punëtorët, që përfundojnë këtë punë dhe janë pjesë e këtij ekzekutivi, ndërsa, vërejtjet shkojnë kryesisht tek çështja e reklamave, këtu i adresohen edhe transmetuesit publik edhe operatorëve privatë.

Pra, tejkalohet koha e reklamave, të cilat ua mundëson me ligj Komisioni i Pavarur për Media.

Kemi pastaj shkelje të të drejtave të autorit, të cilat janë gjithsej tetë raste, që janë hetuar në vitin 2014, por shihet se vetëm katër prej tyre janë zgjedhur, ndërsa rastet për shkeljen e Rregullores për nivelin dhe mënyrën e pagesës, unë që janë raste të rritura, sepse janë 80 raste dhe shumica nga to nuk kanë arritur të realizohen.

Në përgjithësi ne kemi një raport shumë real. Kemi edhe çështje të cilën e potencon Komisioni i Pavarur për Media, për shembull, janë radiot nacionale, që duhet të kenë mbulueshmëri në gjithë territorin, kryesisht në rrugët regjionale. Këtu shihet që nuk kanë mundësi të operojnë radiot tona nacionale dhe, vërejtja shkon nga Komisioni i cili thotë "i udhëzojmë". Unë mendoj, se Komisioni duhet të urdhërojë që të operohet në bazë të ligjit, e jo të udhëzojë, pasi që është punë ekzekutive dhe direkte, përfundimtare e tyre si organ kushtetues.

Sigurisht, që Grupi Parlamentar do të votojë për dhe do të jetë në mbështetje të vazhdueshme për këtë kategori kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për LDK-në flet deputeti Blerim Grainca.

BLERIM GRAINCA: Grupi Parlamentar i LDK-së përkrah rekomandimet e Komisionit dhe do të votojë për. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Blerim! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë do të flas për raportin që e ka dorëzuar KPM-ja e jo për punën që KPM-ja bën në vitin 2015, sepse çështjet që i përmendi zonja Izmaku, janë çështje të strategjisë që kryesisht ka të bëjë me aktivitetin e vitit 2015, se sa atë të 2014-ës.

Ndonëse, ky raport duket të jetë shumë voluminoz, në fakt ka shumë faqe, ka shumë tabela dhe të krijon përshtypjen se ka shumë të dhëna, por në fakt këtij raporti i mungojnë mu të dhënat korrekte. Në kuadër të Komisionit të Pavarur për Media, vepron Departamenti për Monitorim edhe Analiza, i cili në fakt, në këtë raport ka evidentuar një numër jo të vogël të shkeljeve ndaj Rregullores, në veçanti asaj për komunikime komerciale audio-vizuale. Këto shkelje janë bërë nga pothuajse, të gjithë ofertuesit e shërbimeve audio-vizuale, si nga ato nacionale, po ashtu edhe nga ato lokale, përfshirë këtu edhe Radiotelevizionin e Kosovës si institucion publik.

Edhe pse, gjendja është e tillë dhe përsëritet nga viti në vit, kjo është vërtetuar edhe në raportet e Komisionit të viteve të kaluara, po ashtu edhe në këtë raport, mirëpo mungon komplet pjesa analitike rreth këtyre shkeljeve. Asnjë lloj analize nuk është bërë, se cili është shkaku që kjo Rregullore vijon të shkelet rregullisht, gati nga të gjitha mediumet. A është për shkak se KPM nuk di t’i aplikojë masat e ndëshkimit siç thuhet, apo se vetë Rregullorja përmban probleme dhe operatorët nuk mund ta respektojnë atë.

Fakti që nga pothuajse të gjitha televizionet pa dallim, vijon të shkelet kjo Rregullore, duhet të ishte tepër alarmuese për Komisionin e Pavarur të Mediave, gjë që nuk duket as në raport e as në raportimet e tyre në Komision.

Tek pjesa e monitorimit të operatorëve kabllorë, në raport flitet se janë realizuar 53 monitorime, por nuk jepet as edhe një shpjegim se cilat janë të gjeturat nga këto monitorime. A kanë vepruar këta operatorë në pajtueshmëri me rregulloret apo ka shkelje? Nëse ka shkelje cilat janë ato dhe cilat janë veprimet që ka marrë KPM ndaj këtyre shkelësve?

Në raport, në një paragraf të vetëm përmendet vizita, gjegjësisht inspektimet që KPM i ka bërë në tërë territorin e Kosovës, por nuk jepet as edhe një shpjegim se sa inspektime apo vizita të tilla janë kryer, cili ka qenë qëllimi i tyre, kush i ka bërë këto inspektime dhe ku janë bërë dhe, sidomos cilat janë të gjeturat nga inspektimet e kryera dhe në fund, cilat janë veprimet apo masat e ndërmarra nga KPM-ja?

Pra, Departamenti i Monitorimit dhe Analizave nuk e ka bërë as edhe një analizë të vetme apo edhe nëse ka bërë ndonjë të tillë, ato nuk janë përmendur fare në këtë raport.

Një problem tjetër i evidentuar në këtë raport është mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional. Aktualisht, territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm me 62.7% me sinjal televiziv, pjesa tjetër prej 37% e territorit, e cila mbetet e pambuluar dhe këto janë pjesë të

banuara nga qytetarë, të cilët banojnë në këto lokacione e nuk marrin sinjalin e televizioneve, si pasojë e mos aktivizimit të pikës për transmetim primar në Golesh, e që përdoret vetëm nga KFOR-i.

Është e papranueshme që edhe pas 15 vjetëve KPM të mos jetë në gjendje të aktivizojë pikën në majën e Goleshit dhe të mjaftohet vetëm me informimin e organeve më të larta shtetërore, siç thuhet në këtë raport. Menaxhimi i frekuencave televizive është përgjegjësi primare e KPM-së. Prandaj, KPM ka dështuar disa vjet radhazi në këtë drejtim dhe në fakt, kjo është e papranueshme.

Probleme të ngjashme janë edhe me sinjalet e radiove FM. Komisioni i Pavarur i Mediave ka evidentuar zona të caktuara, ku nuk ka pranim të sinjalit të radiove nacionale, por nuk ka marrë masat efikase, që të sigurohet që radiot e nivelit nacional t'i ofrojnë shërbimet e tyre në përputhje me rregulloret në fuqi dhe licencat që posedojnë.

Licencimi për përdorimin e frekuencave nacionale nuk është vetëm një e drejtë që i është dhënë këtyre operatorëve, por është edhe një obligim, që ata marrin për të ofruar shërbime cilësore, në këtë rast po flasim për aspektin teknik dhe sërish, për këtë duhet të kujdeset KPM dhe ndaj këtyre ofruesve të shërbimeve, që nuk kanë respektuar rregulloret të merren masa të nevojshme, ashtu siç janë të përcaktuara me rregulloret e KPM-së. Ky është një dështim tjetër i Komisionit të Pavarur të Mediave.

Në këtë raport nuk përmendet asnjë masë e ndërmarrë nga KPM ndaj transmetuesve dhe mos përgjigjes së rekomandimeve të KPM ndaj këtyre transmetuesve. Nuk ka në raport të KPM-së as për vitin 2014 e as në atë të kaluarin në vitin 2013, ndonjë sqarim se si i kanë shkuar një rastit të tillë gjër në fund.

Në shtojcën 2 të këtij raporti paraqitet monitorimi i televizioneve gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2014. Është plotësisht e paqartë metodologjia, që KPM ka përdorur për monitorimin e televizioneve, në veçanti të ashtuquajturat analiza kualitative. Raporti është përplot tabela, që tregojnë vetëm kohën e alokuar për subjektet politike, që kanë garuar në zgjedhjet e qershorit, por mungon plotësisht analiza kualitative e përmbajtjes, qoftë e programeve informative apo kronikave zgjedhore.

Në dy paragrafët, në fund të këtij raporti përmendet, si vijon: gjetjet në dallim të hapësirave të ofruara për subjekte politike të certifikuara, por nuk jepet asnjë shpjegim, se cilat janë këto gjetje. Në përfundim thuhet se prezantimi i fushatës, në të shumtën e rasteve, ishte korrekt, por nuk përmenden rastet kur televizionet nuk kanë qenë korrekte, cilat kanë qenë këto televizione, cila ka qenë natyra e këtyre shkeljeve dhe çfarë masash janë ndërmarrë nga KPM-ja?

Ndonëse, Komisioni i Pavarur i Mediave gjatë vitit për të cilin raportohet, pra për 2014, ka pasur detyrë që të merret me përgatitjet për fillimin e procesit të digjitalizimit, kjo çështje përmendet vetëm kur flitet për listën e aktiviteteve.

Raporti nuk përmend fare cilat janë përgatitjet që ka bërë KPM për të realizuar me sukses procesin e digjitalizimit, cilat janë sfidat me të cilat është përballur, çfarë janë problemet e

evidentuara dhe si do t'u qaset zgjidhjes së këtyre problemeve, cilat janë rekomandimet e KPM-së, çfarë janë kërkesat e tyre ndaj Kuvendit apo ndaj Qeverisë?

Raporti për vitin 2014 i Komisionit të Pavarur për Media është i tillë që disa vjet rresht, pra i pasaktë dhe dëshmuar për punë të munguar nga ana e këtij institucioni. Kjo është vërtet shumë shqetësuese, prandaj Kuvendi duhet të marrë masa ndaj tyre.

Si rrjedhojë dhe duke pasur parasysh të gjitha vërejtjet e përmendura më lart, unë nuk mund të rekomandoj, që ky raport të votohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Xhevahire Izmau, plotësim apo çfarë...?

XHEVAHIRE IZMAU: Mendoj që kam të drejtë ta përdor një replikë, pasi që kolegja Shqipe përmendi emrin tim, si referencë në atë që unë fola për të ardhmen apo për vitin që jemi e jo për vitin e kaluar.

Por, realisht në kontekstin e procesit të digjitalizimit, është pra proces i cili është në kontinuitet dhe nuk ka mundësi që të shkëputet, pasi që ajo ka qenë në vitin 2014 si proces, ndërsa tani jemi në vazhdim të asaj, nuk ka përfunduar apo s'ka filluar ende asgjë.

Ndërsa, kam edhe unë vërejtje të mënyra se si i qaset raportit, konkretisht tek qasja e antenës së Goleshit, dua t'ia sqaroj koleges sime, sepse pjesët e ITU-së, po të ishim ne nuk kemi mundësi realisht të jemi, derisa nuk jemi shtet anëtar i OKB-së, pra këtu qëndron problemi, jo te KPM-ja dhe te mungesa e qasjes së tyre, mirëpo te problemi politik. Derisa nuk jemi anëtar shtet i OKB-së, nuk kemi mundësi të kemi qasje në ITU dhe realisht ajo monitorohet në këtë mënyrë.

Pra faktikisht, Goleshi aktualisht trajtohet si pjesë, fatkeqësisht themi, pjesë e ish-RSFJ-së dhe në këtë mënyrë edhe frekuencat e tilla na janë ndarë, pra nuk i kemi frekuencat tona si shtet, por i kemi si pjesë e ish-RSFJ-së. Deri në këtë moment KPM ka mundur të llojë përmes AMA, që është institucion homolog sikur KPM që është në Kosovë, mirëpo ende s'ka rezultat dhe në këtë drejtim duhet të përfshihemi të gjithë si institucione, pra nuk është çështja që është problem e mungesës së punës e efikasitetit të KPM-së. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Shqipe Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: E para, ne po shqyrtojmë raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe jo procesin e digjitalizimit. Pra, e gjithë ajo që përmenda është të gjeturat, që kanë dalë nga ky raport.

E dyta, me Kushtetutë është përgjegjësi e Komisionit të Pavarur të Medieve si organ Kushtetues, që të merret edhe me menaxhimin e frekuencave. Nëse një problem i tillë vazhdon që 15 vjet dhe KPM nuk ka ardhur asnjëherë me një rekomandim, a me një kërkesë, qoftë te Kuvendi, qoftë te Presidenca, qoftë te Qeveria, për të gjetur një zgjidhje, unë mendoj se dështimi i takon sërish KPM-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, mos e bëni me sedër, se s'jeni duke zgjedhur asgjë, po më duket. Hajde Xhevahire!.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit për mundësinë, kryesues, por, duhet të sqaroj, pasi që jam pjesë e këtij Komisioni që dy mandate dhe është shumë e padrejtë, jo pse dua ta mbrojë, s'kam pse e mbroj unë punën e Komisionit të Pavarur për Media, sepse është organ i pavarur, por është e padrejtë nëse nuk e potencoj, se ky komision ka tentuar më së paku që pesë vjet dhe ka kontaktuar, jo vetëm me institucionet vendore, po me çdo institucion ndërkombëtar që ka pasur mundësinë dhe ka kërkuar lobim dhe ka kërkuar mbështetje, që Kosova të ketë mundësinë që të ketë qasje në institucionet ndërkombëtare mediale. Pra, nuk është fare e vërtetë kjo, apo s'ka informacion Shqipja.

KRYESUESI: Pal Lekaj flet për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës për vitin 2014, të paraqitur nga Komisioni i Pavarur i Mediave. Për nga volumi dhe përmbajtja ne pajtohemi, por ajo që na shqetëson janë të gjeturat që i ka bërë ky komision nga operatorët legalë dhe ilegalë, mendoj që nuk ka treguar zbatueshmërinë e tyre dhe nëse nisemi nga ajo që shumë operatorë, që janë të licencuar, kanë bërë shkelje dhe ato të gjetura nuk janë dënua dhe përpos një... të themi, ajo që vetëm është përmendur në këtë raport, mendoj se Komisioni i Pavarur për Media duhet të jetë më efikas në zbatueshmërinë e shkeljes së Ligjit për media.

Ajo që mund të them është edhe shqetësuese edhe hapësira frekuentuese në gjithë hapësirën, sepse diku vetëm 60% të frekuencave të zbatohen dhe janë prezentë në Kosovë dhe kemi mjaft edhe te televizionet nacionale dhe shumë televizione tjera, që janë të licencuara, por sa i përket teknikës, nuk i përmbushin as kriteret që janë licencuar.

Në këtë drejtim, ne mendojmë që Komisioni i Pavarur për Media duhet të jetë më efikas dhe që të shkojë në favor të asaj, për çka është i thirrur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Lekaj. Për Nismën flet deputeti Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Edhe unë si anëtar i Komisionit funksional për këtë çështje, them se në fakt disa nga debatet që u bënë këtu janë diskutuar me Komisionin e Pavarur për Media dhe janë dhënë disa sqarime.

Natyrisht, ky Komision përballet me shumë probleme, si shumë agjenci të tjera. Sido që të jetë, në Komision jemi pajtuar që të sillen në Kuvend dhe të kërkohet miratim me sugjerime dhe vërejtje që janë diskutuar në Komision dhe me mundësitë që ne si anëtarë të Komisionit të llojmë, që në rishikim të buxhetit të plotësohen disa nga kushtet, që defektet që janë paraqitur në raport, në të ardhmen të mos jenë prezentë.

Sido që të jetë, në emër të Grupit Parlamentar do ta mbështesim këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë, që dëshirojnë të bisedojnë për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e tetë:

8. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014

Komisioni funksional për Legjislacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014 dhe, Kuvendit i ka rekomanduar që ta miratojë.

Në fillim e merr fjalën kryetarja e Komisionit Funksional për Legjislacion, Albulena Haxhiu, ose jo, Albulena nuk është këtu, por në emër të Komisionit, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria s'është këtu, fatmirësisht, pra kemi të bëjmë me një raport të Agjencisë Kundër Korrupsionit, i cili më shumë prek edhe Administratën Publike për vitin 2014.

Në raportin e paraqitur nga drejtori i Agjencisë dhe i shqyrtuar nga Komisioni për Legjislacion, është parë që është bërë një progres sa i përket Ligjit për deklarimin e pasurisë, duke bërë harmonizimin me Kodin Penal dhe me Kodin e Procedurës Penale, ku deri atëherë deklarimi i pasurisë ishte vetëm shkelje administrative, kurse me Ligjin e ri në fuqi, ndryshimet e reja, është bërë vepër penale.

Sa i përket parandalimit, gjatë vitit 2014 në raportin e paraqitur është thënë se janë dhënë 248 informata, ku 56 të bartura nga viti paraprak dhe prej tyre 124 janë trajtuar sipas detyrës zyrtare.

Agjencia Kundër Korrupsionit gjatë vitit 2014 ka ushtruar 131 kallëzime penale kundër 163 personave dhe në 8 raste të përcjelljes prej Policisë së Kosovës, ku është bërë edhe identifikimi i numrave dhe personave.

Që nga viti 2013 janë ushtruar në vazhdimësi diku 551 kallëzime penale dhe edhe në këtë raport nuk është bërë ndarja e tyre, sepse ka akumulim, që procedohet në prokurori dhe kjo ka qenë edhe vërejtje për Prokurorinë dhe gjyqësorin në procedimin e lëndëve, që bëhen nga Agjencia Kundër Korrupsion.

Gjatë vitit 2014 në procedimin kallëzimeve penale 102 raste janë paraqitur si të mbyllura, 56 në procedurë dhe 56 të tjera si shkelje administrative tek institucionet.

Struktura e veprave penale të trajtuara nga Agjencia janë keqpërdorimi i detyrës zyrtare ose autoritetit zyrtar, ushtrimi i ndikimit, mashtrimi në detyrë, përvetësimi në detyrë, marrja e ryshfetit, mos raportimi i pasurisë apo raportimi i rrejshëm.

Në aspektin e mbikëqyrjes së monitorimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit 2013-2017 dhe në raportimet, që bëhen çdo vjet është rishikuar edhe plani i veprimit, sepse po ashtu është edhe obligim i Agjencisë, por edhe institucionit të Kuvendit, i cili është mbikëqyrës i këtij institucioni.

Sa i përket bashkëpunimit me institucione tjera është bërë, është paraqitur si problematikë pozitat e shumëfishta në institucionet publike, ku është bërë identifikimi i 1509 zyrtarëve të lartë, të cilët ushtrojnë apo mbajnë dy e më shumë funksione. Kjo është vërejtje edhe për Komisionin, por edhe për Qeverinë në hartimin e legjislacionit të ri për eliminimin e pozitave të dyfishta përmes Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit.

Komisioni për Legjislacion ka shprehur përkrahjen sa i përket Agjencisë Kundër Korrupsion, por njëherësh ka kërkuar edhe punë dhe angazhim maksimal, qoftë në evidentimin e shkeljeve ligjore, qoftë në parandalimin si preventivë të korrupsionit në institucionet publike.

Komisioni për Legjislacion e ka përkrahur raportin. Ju fton edhe juve që ta përkrahni, njëherësh edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë raport për vitin 2014. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj! Fjalën e merr kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Po ashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin në fjalë dhe në përfundim kemi bërë edhe rekomandimin për aprovim, pasi që Agjencia Kundër Korrupsionit ka respektuar të gjitha afatet ligjore dhe ka sjell raportin, ashtu siç e parasheh edhe Ligji mbi menaxhimin e financave publike lidhur me raportimin dhe standardet e raportimit për çdo aktivitet financiar, që ka ndodhur me buxhetin e këtij institucioni.

Agjencia në fjalë ka pasur në dispozicion një shumë prej 472 801 euro, normalisht këtu duke u respektuar edhe shtesa prej 25% me vendim të Qeverisë për rritjen e pagës, po ashtu edhe zbritja 15% në kategorinë mallra dhe shpenzime, po ashtu me vendim të Qeverisë dhe kjo ka rezultuar që agjencia të shpenzojë 453 079 euro e 7 centë, ose 95.8% të buxhetit në dispozicion.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar në detaje dhe ka bashkëbiseduar me drejtorin dhe ka pasur vërejtje, sidomos sa i përket çështjes së formularëve, meqenëse në mbushjen e formularëve deputetët janë ankuar se në disa rubrika duhet dhënë prejdhikim dhe jo të dhëna konkrete dhe, kjo qet në dyshime. Po ashtu, ka pasur vërejtje edhe për shkak të privatësisë, meqenëse kjo është krejtësisht në kundërshtim me mbrojtjen e të dhënave personale, që është dashur të respektohet, që ka të bëjë me publikimin e këtyre formularëve.

Konsiderojmë që Komisioni Funkcional për Legjislacion duhet të merret me këtë çështje, që ta rregullojë këtë çështje, në mënyrë që të mos kemi ngritje të procedurave për ato çështje të cilat nuk mundet kurrkush të japë një shumë të caktuar të pasurisë, që e disponon ai që ka obligim ligjor për ta mbushur deklaratën financiare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Osmani. Nezir Çoçaj flet në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me vëmendje raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe do ta mbështesë këtë raport.

Raporti është i hartuar mirë dhe pasqyron punën dhe angazhimin e Agjencisë për vitin 2014.

Nëse i referohemi të dhënave të paraqitura në këtë raport, rezulton se ka përmirësim të gjendjes në këtë vit të raportimit dhe për nga numri i rasteve të shqyrtuara dhe të proceduara tek organet kompetente, si dhe për nga vlera e tyre.

Agjencia Kundër Korrupsionit ka bërë një punë në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekje për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe sensibilizimit të opinionit publik mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktualë, të cilët merren me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Pozitivisht ka ndikuar edhe amandamentim i Kodit Penal të Kosovës në vitin 2013, ku mosdeklarimi i pasurisë dhe deklarimi i rremë i saj parashihet si vepër penale, gjë që po ndikon pozitivisht në parandalimin e këtyre dukurive, edhe pse ende ka punë në këtë drejtim.

Agjencia pasi që ka detyrë të ndjeshme për shoqërinë dhe shtetin tonë, nevojitet përpjekje e përbashkët e të gjithë mekanizmave, që kanë për mision luftimin e korrupsionit në të gjitha format, në mënyrë që të ndërtohet një sistem i fuqishëm institucional.

Ne si Grup Parlamentar ftojmë të gjithë aktorët, e në veçanti qytetarët, që të ndihmojnë në këtë proces me angazhimet e tyre, për t'i paraqitur rastet për të cilat kanë dyshime për keqpërdorimin e detyrës zyrtare, keqpërdorimin e parasë dhe pasurisë publike, e tjerë.

Në fund fare, inkurajojmë Agjencinë që të vazhdojë pa kompromis këtë betejë dhe, gjithashtu ftojmë edhe organet prokurore e gjyqësore që të jenë më azhur në punën e tyre, sa i përket kësaj dukurie negative. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Glauk Konjufca, kryetar i Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Po, ky raport i Agjencisë Kundër Korrupsionit nëse shihet nga aspekti i asaj se çka tregon se ka punuar, atëherë mund të konsiderohet një raport deri diku i mirë. Mirëpo, nëse trajtohet nga aspekti i asaj që nuk ka bërë e që do të duhej ta bënte një Agjenci kaq e rëndësishme për Kosovën, sepse merret me një dukuri e cila është, le të themi, e shprehur në mënyrë kronike këtu në vendin tonë, me korrupsionin i cili, le të themi, ka metastazuar në çdo nivel institucional, prej nivelit lokal e deri te ai qendror. Dhe, ka qenë një problem për Kosovën, i cili nuk është shfaqur kohëve të fundit, po i cili ka mbretëruar prej kur ne kemi pasur institucione të karakterit publik.

Çka po dua të them me këtë? Po dua të them, që raporti do të mund të kishte qenë shumë më informues, sa u përket shumë çështjeve që nuk i ka prekur. Është tejet shqetësuese, më së pari problemi i mosdeklarimit apo deklarimit të rrejshëm të pasurisë. Siç e dini, me Kodin e ri Penal kjo sanksionohet si vepër penale dhe këtu tregohet për një varg rastesh të mos deklarimit të pasurisë apo të deklarimit të rrejshëm, me ç'rast sanksionimi i kësaj çështjeje është më se qesharak.

Kur një person publik, për shembull, merr korrupsion apo ryshfet të majmë nga dikush, është banale qysh rastet që kryesisht janë trajtuar, kanë të bëjnë me gjoba që sillen prej 150 euro deri në 1000 euro. Kurse, ne e dimë fare mirë, që korrupsioni në Kosovë është edhe i karakterit milionësh, prej të cilit ndonjëherë përfitojnë zyrtarë të ndryshëm publikë.

Pra, trajtimi i kësaj problematike me një gjobë kaq simbolike, unë mendoj që i kontribuon në mënyrë të hatashme korrupsionit dhe nuk ndikon fare në luftimin e tij.

Çështja e dytë, është që Agjencia Kundër Korrupsionit është shumë i koncentruar vetëm në deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publikë, e cila pasuri ka lidhje vetëm me ato që i deklarojnë zyrtarët publikë brenda Kosovës. Ka dyshime të bazuara mirë, jo vetëm nga Kosova, por edhe ajo që u ka ndodhur vendeve të rajonit, se kur zyrtarët politikë dhe publikë korruptohen, ata shpeshherë aplikojnë edhe një praktikë të zhvendosjes së aseteve të tyre jashtë vendit.

Domethënë, pasuritë apo ryshfetet të cilat ata i marrin, shpeshherë nuk figurojnë në Kosovë dhe nuk i lënë në Kosovë, as nëpër konto të tjetërkujt, as me emra të maskuar, por i qesin ndonjëherë edhe jashtë, shpeshherë edhe në vende të cilat quhen ndonjëherë edhe “parajsë të shpëlarjes së parave” apo që kanë sistem shumë të favorshëm, që asetet të cilat janë burim i korrupsionit, i deponojnë nëpër vende që kanë edhe mbulimin ligjor, që ato të mos zbulohen kollaj.

Dhe, mendoj se Agjencia Kundër Korrupsionit ka qenë shumë e dobët në këtë drejtim dhe nuk ka pasur kurrfarë aktiviteti, që ka zhvilluar në këtë drejtim.

Unë mendoj, se inicimi i hetimeve për shkak të shpërputhjes mes pasurisë së deklaruar dhe pasurisë faktike është një indikacion i mjaftueshëm, që institucionet përkatëse të nisin hetime, për të cilat nuk kanë nevojë që dikush të ankohet apo që dikush të ngre dyshimin. Vetë institucionet duhet të jenë në krye të zbulimit të këtyre shpërputhjeve.

Çka po dua të them me këtë? Po dua të them, që drejtësia në këtë aspekt nuk duhet të funksionojë si Gjykata Kushtetuese. Ju e dini që Gjykata Kushtetuese thotë “ në momentin që dikush nuk është ankuar për një çështje, ne nuk e hetojmë atë çështje.” Po, drejtësia e karakterit penal dhe kjo anti-korrupsion sidomos, nuk duhet të funksionojë sikurse Gjykata Kushtetuese, “Askush nuk është ankuar për një çështje dhe kjo çështje nuk mund të ndiqet”. Përkundrazi, në këtë aspekt ka më shumë hapësirë për iniciativë vetjake.

Tjetra që desha të ngre, është se siç e dini, Kosova ka një Ligj për mbrojtjen e informatorëve, informatorë të cilët faktikisht, le të themi, e lajmërojnë korrupsionin apo shkeljen. Dhe, jemi dëshmitarë që kohëve të fundit është raportuar për shumë parregullsi brenda institucioneve publike edhe në aspektin e korrupsionit dhe, kur informatorët kanë treguar për këso gjërash, siç

është edhe rasti i disa gazetarëve, për institucionet në të cilat punojnë, ata janë shkarkuar, janë nxjerrë nga puna, domethënë, nga punëdhënësit e tyre, që në këtë rast janë edhe institucione publike. Informatorët në këtë rast nuk kanë mbrojtje adekuate. Çka i bie kjo?

Kjo i bie, që u jepet një leksion të gjithë atyre që kanë informacione dhe janë të gatshëm t'i qesin ato informacione, ata frikësohen që të mos e bëjnë një gjë të tillë, sepse vetë institucionet e drejtësisë apo Ligji nuk i mbron në mënyrë të mjaftueshme, që ata të jenë lajmërues efektivë të korrupsionit dhe që, pas lajmërimit të korrupsionit të mos pësojnë me ndëshkime të tilla, siç është për shembull, edhe ndëshkimi më i rëndë siç është humbja e vendit të punës, pse po e bën një gjë të tillë.

Një segment tjetër i strategjisë anti-korrupsion është edhe hetimi dhe parandalimi i korrupsionit në rastet e dhënies së lejeve dhe licencave të caktuara, sidomos në industrinë e ndërtimeve ndodhë kjo. Siç e dini, në Kosovë kjo ka ndodhur shumë shpesh, mirëpo kjo është një domen i paprekur pothuajse, prej Agjencisë Kundër Korrupsionit. Edhe këtu, bile në një dëgjim publik, ka qenë shumë indikativ rasti i një prokurori, Shqipdon Fazliu, quhej ai, i cili nuk e ka ditur që kemi lëndë shtatëdhjetë e sa lëndë në Prokurori lidhur me rastin e korrupsionit, që ka ndodhur e që është i karakterit milionësh në komunën e Prishtinës, lidhur me mijëra ndërtime pa leje, që janë bërë në komunën e Prishtinës. Dhe, ai thotë që nuk ka kurrfarë informacioni lidhur me këtë gjë, kurse Agjencia Kundër Korrupsionit as që është marrë me një domen të tillë, që është shumë i rëndësishëm, mund të thuhet njëri prej burimeve më të mëdha të korrupsionit në Kosovë.

Pastaj, mendoj që Agjencia Kundër Korrupsionit nuk e ka prekur edhe një fushë tjetër shumë të rëndësishme. Cila është kjo? Është mënyra e financimit të partive politike.

Me partitë politike dhe mënyrën e financimit të tyre i kemi pasur disa probleme në Kosovë. Njëri prej problemeve më seriozë ka qenë kjo i rasteve kur është argumentuar, që dhënia e tenderëve të caktuar për kompani që marrin punë prej Qeverisë së Kosovës, më pastaj janë evidentuar nëpër raporte të financimit të partive politike, si prej financuesve të tyre kryesorë.

Kjo ka paraqitur një konflikt shumë serioz të interesit dhe të shfrytëzimit të fondeve publike, për përfitime klanore dhe partiake, gjë që në njëfarë mënyre mund të trajtohet si keqpërdorim i buxhetit të Republikës së Kosovës. Edhe në këtë aspekt e kemi parë Agjencinë Anti-Korrupsion shumë të dobët dhe kjo është një indikacion, që ndoshta edhe ngre pikëpyetje për kredibilitetin e kësaj agjencie e në anën tjetër edhe për ndoshta ngritjen e disa dyshimeve, se mund të ketë edhe influenca politike në këtë agjenci, në kuptimin e asaj, se çka ngrit e çka nuk ngrit.

Mirëpo, është një informacion i vlefshëm këtu në raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, unë po e lexoj vetëm një pjesë të tij, i ka tre rreshta. Raporti thotë kështu: “Prokurorët kanë vazhduar së kërkuari nga Agjencia Kundër Korrupsionit, që ta provojë qëllimin e veprave penale, si element konstitutiv i figurës së tyre. Përderisa në asnjë rast, edhe përkundër mundësive ligjore të njëjtat nuk kanë ndërmarrë veprime hetimore të nevojshme dhe nuk kanë arritur që ta provojnë vetë qëllimin”.

Tjetra është “Prokuroritë në shumë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Përpiqu ta kryesh, nëse e ke kah fundi, sepse koha shkoi.

GLAUK KONJUFCA: Jo, veç desha të them, që tash kjo i hedh dy dyshime shumë të mëdha, dy probleme shumë të mëdha na i hap në shtetin tonë.

Agjencia Kundër Korrupsionit është duke paraqitur kaq argumente të dobëta, që po hidhen poshtë prej gjyqësisë, kjo mund të jetë njëra e vërtetë dhe problemi këtu po është vetë Agjencia Kundër Korrupsionit apo, nëse kjo nuk është e vërtetë, është gënjeshtër, atëherë vetë gjyqësia po hedh poshtë lëndë pa arsye, edhe në ato raste kur ka fakte të qarta. Tash, njëra prej këtyre është e vërtetë, por, për të dy rastet shqetësimi është shumë i madh.

Edhe këtu te harxhimet kemi disa probleme me këtë raport, kështu që mendoj, në fund të fundit, ky raport mendoj se nuk ia vlen të votohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës shefja e Grupit, Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tash në gjendjen në të cilën gjendet Kosova dhe në raport me korrupsionin, të kërkosh prej një Agjencie të vetme që të ketë një performansë të jashtëzakonshme në një zinxhir, ku asgjë nuk funksionon, ose të them, ku sundimi i ligjit është në pikën në të cilën është, është ndoshta në kundërshtim edhe me vetë situatën.

Por megjithatë, kur njerëzit marrin përgjegjësi dhe janë në një institucion të tillë, atëherë pritet që të japin edhe ndonjë rezultat.

Agjencia Kundër Korrupsionit po duket si një organizatë, e cila është kthyer dhe ka marrë një rol më tepër krejt teknik, shumë sipërfaqësor, ku zyrtarët e lartë deklarojnë çka duan dhe Agjencia, në njëfarë mënyre, veç e legjitimon këtë deklaram, pa e verifikuar asnjëherë, ose pa filluar hetimet për çështje të cilat të gjithë ata që i kanë sytë në ballë e nuk ka nevojë të jesh as prokuror, shihet që lidhen me afera korruptive, për shembull: pasurimi brenda natës, deklarimi i një kryeministri që për tri vjet s'e ka prekur fare rrogën e vet, ndërkohë që është pasuruar, ndërkohë që i është shtuar prona, kishte qenë një bazë mbi të cilën Agjencia ishte dashur të fillojë hetimet.

Po, në disa raste, në fakt edhe kur kanë filluar disa hetime të zyrtarëve më të ulët, ose të ish-zyrtarëve, jo të atyre që tani janë në pushtet, më tepër është marrë ndoshta me çështje si mëditjet, deklarimi i tyre i rregullt, i parregullt, gjëra të cilat kalojnë nëpër bankë dhe shumë lehtë të evidencohen.

Përndryshe, ka shumë paradokse në vetë funksionimin, po edhe në ligjin përkatës. Për shembull, Agjencia nuk ka qasje në xhirollogari të zyrtarëve të lartë. Dhe tash çka ndodh? Një zyrtar i lartë me marrjen e detyrës, duke paramenduar që do të korruptohet, deklaron që i ka dy-treqind mijë euro në bankë dhe Agjencia nuk e ka të drejtën ta verifikojë, madje as nuk e pyet se prej nga

është prejardhja e këtyre parave, mjafton të thotë që “m’i ka dërguar vëllai prej Gjermanisë”. Dhe pastaj, gjatë qëndrimit të tij në pushtet, në njëfarë forme Agjencia shfrytëzohet si “lavatriçe” për legalizimin e këtyre parave të pista, që krijohen duke abuzuar me pushtetin.

Do të thotë, ka shumë mangësi. Ne duhet t’i qasemi shumë seriozisht edhe plotësim-ndryshimit të ligjit. Sigurisht, nga raporti i cili ka ndodhur para Komisionit dhe raportimi i drejtorit të kësaj Agjencie, ka pasur edhe shumë ankesa për një mungesë të koordinimit ndërmjet prokurorit, gjyqësorit, policisë, organizatave joqeveritare, mediave. Pra, të gjitha anët, të gjitha palët po e akuzojnë njëra-tjetrën edhe gjatë raportimit, ndërkohë, që Kosova dhe në Kosovë po vazhdon të rritet korrupsioni.

Prandaj, si Aleancë nuk mund t’i japim notë pozitive as raportit, sepse performansë kundruall gjendjes në të cilën është Kosova, lë shumë për të dëshiruar dhe do të votojmë kundër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kadaj. E ka fjalën Enver Hoti, për Grupin Parlamentar “Nisma”.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Është shqetësuese, sikurse tani që po e trajtojmë dhe shqyrtojmë raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit edhe dje, kur e shqyrtuam raportin e Auditimit të Përgjithshëm, munguan qeveritarët në përgjithësi. Kjo është shqetësuese, sepse po shihet qartë se nuk janë të interesuar për t’i trajtuar dhe për t’i dëgjuar këto të dhëna, që përcjellin këto raporte.

Sidoqoftë, Grupi “Nisma” e ka trajtuar raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe ky raport paraqet shumë të dhëna për nivelin e korrupsionit, keqpërdorimin e pozitave zyrtare e veçmas, në ato të konfliktit të interesit.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Raporti jep të dhëna, unë do të ndalem vetëm tek ato që kanë të bëjnë me konflikt interesi. Janë 1509 zyrtarë, të cilët mbajnë nga dy e më shumë pozita. Është shumë interesant të trajtohet dhe të zbërthehet kjo shifër, kujtoj unë, sepse vetëm një zyrtar i lartë mban mbi 6 pozita zyrtare.

Tani duhet të ngritët pyetja, cili është ai zyrtar dhe çfarë aftësie ka ai, që mban 6 funksione në të njëjtën kohë?

Shkojmë më tutje. Kemi 10 zyrtarë, që mbajnë nga 5 pozita funksionale, kemi 31 zyrtarë që mbajnë nga 4 pozita zyrtare, kemi 312 zyrtarë që mbajnë nga 3 pozita funksionale, pra funksione, detyra, pozita zyrtare, kemi 1155 zyrtarë, të cilët mbajnë nga dy pozita zyrtare, pra do të ishte mirë që ta dinë qytetarët, se sikur këta zyrtarë të spostoheshin në vetëm nga një pozitë, në mënyrë automatike do të liroheshin mbi 2000 vende të lira apo pozita tjera zyrtare.

Duhet të trajtohen këto, se kjo nuk paraqet ndonjë vepër penale, por sigurisht se paraqet burim potencial të konfliktit të interesit.

Raporti po ashtu, është shqetësues edhe në bashkëpunimin ndërinstitutional për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Nga raportuesi kemi marrë një informatë, e cila në Komisionin për Buxhet dhe Financa, për mua ka qenë shqetësuese, sepse raportuesi thotë se ka mungesë të kuadrove, kur dihet se në Kosovë ka kuadro të mjaftueshme të fushës përkatëse dhe ka një papunësi të madhe dhe, thirrja nga Agjencia e Korrupsionit për punësim, njerëzit pretojnë të shkojnë të punojnë apo nuk gjejnë gatishmëri dhe vullnet për të punuar në këtë institucion. Kjo lë dhe nënkupton diçka tjetër, sepse ata mund të ndjehen edhe të kërcënuar në kryerjen e detyrës së tyre.

Po ashtu, reagimi apo mosreagimi i organeve kompetente nuk i ndihmon parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Prandaj, krejt në përfundim, unë mund të konkludoj se Qeveria edhe nga mos prezenca nuk është e interesuar për t'iu qasur, por vetëm e ka pasur si deklaratë në fushatat elektorale parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Ne mbështesim dhe inkurajojmë Agjencinë, që të punojë akoma më shumë dhe të sjellë edhe më shumë informacione, të cilat do t'i ndihmonin parandalimit dhe ndalimit të kësaj dukurie shqetësuese në vend. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Parimisht e mbështes raportin e Agjencisë Anti Korrupsion, mirëpo ajo që më shqetëson mua është praktika e shqyrtimit të raporteve të agjencive të themeluara nga Kuvendi dhe që i përgjigjen Kuvendit në seanca plenare, sepse më shumë është bërë një rutinë, se sa që po na sjell ndonjë rezultat. Këtë e tregon më së miri edhe vetë interesimi i deputetëve për të qenë prezentë në seanca plenare.

Unë konsideroj, që raportet e tilla mjafton të shqyrtohen në komisione përkatëse dhe vetëm atëherë, kur komisioni has në parregullsi t'i rekomandojë seancës për shqyrtim dhe, pastaj seanca pas shqyrtimit në rast se nuk kalon një raport i një agjencie, atëherë të marrë masa konkrete, qoftë edhe me shkarkimin e bordit dhe emërimin e anëtarëve të bordit, anëtarëve të rinj të bordit.

Konsideroj se shqyrtimi në këtë mënyrë i këtyre raporteve nuk sjell asnjë rezultat. Është veç humbje kohe dhe, thjesht është një komoditet i krijuar për mos punë dhe mos përgjegjësi nga aktorët përgjegjës, kështu që, kjo praktikë besoj se në të ardhmen duhet të ndryshojë, për shqyrtimin e këtyre raporteve. Faleminderit!

KRYESUESI: Milazim Haliti e ka fjalën.

MILAZIM HALITI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Agjencia Kundër Korrupsionit si institucion i pavarur ka për mandat zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, veprimet për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, si dhe sensibilizimin e opinionit me qëllim të ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë, raportin e së cilës Agjenci për vitin 2014 po e shqyrtojmë sot.

Agjencia ka krijuar mundësi për qytetarët, që duan t'i raportojnë rastet e dyshuara për korrupsion dhe këtë mund ta bëjnë duke raportuar drejtpërdrejt në Agjenci dhe atë, në mënyrë anonime, të cilët mund të kontribuojnë shumë në efikasitetin e punëve të Agjencisë.

Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014 është i mirë, gjithëpërfshirës, që paraqet në detaje punën njëvjeçare dhe përmes tabelave për të gjitha rastet e evidentuara dhe të raportuara, veç e veç.

Në raport thuhet, se të gjitha rastet që janë pranuar gjatë vitit 2014 janë 248 raste, ku prej tyre 133 raste janë përcjell në Prokurori dhe Polici, duke i specifikuar të gjitha ato veç e veç, siç janë: keqpërdorimi i detyrës zyrtare, ushtrimi i ndikimit, mashtrimi në detyrë, punimet ndërtimore, veprimtaria e pandërgjegjshme, përvetësimi në detyrë, marrje ryshfeti, mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë dhe, të gjitha këto raste në mënyrë tabelore shumë mirë janë të prezantuara në këtë raport.

Edhe pse të raportuara në institucionet përkatëse, si në Prokurori e tjera, nëse analizohet vetëm trajtimi i rasteve për korrupsion, shihet se efektet nuk janë të nivelit të duhur. Me këtë rast po veçoj trajtimin e rasteve të dyshuara për korrupsion, ku me aktgjykime dënuese gjykatat kanë shqiptuar dënime kumulative me gjobë dhe burgim, dhe atë dënimet me gjobë janë shqiptuar prej 150 deri në 1000 euro, ndërsa dënimet me burgim në kohëzgjatje prej dy muaj deri në gjashtë muaj, ku janë përfshirë edhe rastet e mosdeklarimit të rregullt të pasurisë, që mendoj se janë tejet minimale.

Vlen të theksohet, se nga raporti edhe dukuria e funksionimit të shumëfishtë, ku janë identifikuar 1509 zyrtarë të lartë, që ushtrojnë apo mbajnë dy e më shumë funksione apo pozita, duke filluar nga rasti kur një zyrtar i lartë i mban 6 funksione apo pozita, 10 zyrtarë i mbajnë nga 5 funksione, 31 zyrtarë nga 4 funksione, 312 nga 3 funksione dhe 1155 zyrtarë nga 2 funksione apo pozita, që janë të tepërta, mendoj, kur dihet se sot në Kosovë ka shumë kuadro me kualifikime superiore dhe me grada shkencore, të kryera në vend dhe jashtë vendit dhe shumë prej tyre aktualisht janë të papunë.

Besoj se kjo çështje do të rregullohet përmes Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit.

Të gjitha angazhimet dhe përpjekjet e Agjencisë Kundër Korrupsionit për ta ndalur hovin e korrupsionit, i cili ka kapluar vendin, janë të pamundura, pa përkrahjen dhe mbështetjen institucionale dhe koordinimin e mirë dhe të duhur ndërmjet Agjencisë, në njërën anë dhe të Prokurorisë, Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor, Njësisë për Hetime Financiare dhe gjykatave kompetente, në anën tjetër.

Dhe për fund, unë e përkrah raportin e detajuar duke besuar në vazhdimin e punëve me intensitet të shtuar të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Faleminderit!

KRYESUESI: I fundit që ka kërkuar fjalën, deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje për kolegët deputetë!

Është një raport mjaft interesant, që e shqyrtojmë dhe mendoj që deputetët nuk e kanë lexuar mirë, ose nuk e kanë kuptuar për çka ka të bëjë.

Kur e them këtë, kam pasur rastin të jem pjesë e gjyqit të anti korrupsionit, kam pasur rastin të jem prezent, që ata i kanë prezantuar atje në Gjykatë të dhënat e tyre hetuese paraprake dhe të plota të anti-korrupsionin për deputetët. Nuk di si e kuptojnë, por ata thonë që ne i kemi 80 raste të hetimeve të zyrtarëve publikë për vite të caktuara dhe 80 raste, ne këtu jemi 120 zyrtarë, ata nuk kanë një formë të kontrollit, ata kanë formën e shabllonit, ata kanë formën politike të kontrollit. Nëse i kanë këto, cila është anti-korrupsioni që do të hetojë rastet e korrupsionit?

Jemi akuzuar deputetët e Kuvendit të Kosovës për pagat që kemi marrë nga Kuvendi i Kosovës. Jemi akuzuar deputetët e Kosovës që marrim përmes bankave dhe llogarive bankare. Cila është arsyeja të miratojmë ne raportet e anti-korrupsionit, për kë t'i miratojmë këto?

Nëse deputetët janë të gatshëm të miratojnë edhe mashtrimet që bën ai, atëherë e paçi veten në qafë.

Jemi akuzuar për 284,04 euro. Është tmerr. Një anti-korrupsion del dhe thotë: “të shkojnë në Gjykatë deputetët e Kuvendit të Kosovës, për që kanë kaluar, ose i kanë marrë nga 284,04 euro më tepër, që ka mundësi gabohet, gabime teknike. Cila është arsyeja, që nuk thirret deputeti ose zyrtari, me thënë sa para, ose a i ke deklaruar drejt apo nuk është drejt, e kemi këtë raport. A vetë do të na çojnë në Prokurori neve? Të na çojnë në gjyq atje dhe të merren mediat me ne dhe të thonë: “ja, çka keni bërë ju!”

Po, kjo është e tmerrshme! Ai duhet të shkarkohet, nuk duhet për t'ia miratuar raportin. Ai është rast për të shkuar në burg, se ai nuk i heton rastet e korrupsionit në Kosovë, që janë publike, e merret me deputetët e Kosovës, me 284,04 euro.

Unë kërkoj t'ia ktheni raportin dhe ai të përgjigjet për përgjegjësitë e tyre.

KRYESUESI: Nuk ka të tjerë. Po e shfrytëzoj rastin, meqë jam këtu e s'mund ta zgjas fjalën, vetëm për dy vlerime, se dua t'i lë të regjistruara këtu në Kuvend.

Çështja e kësaj paraqitje të ardhurave, si thonë këta, është problematike për një arsye, deklarimi vullnetar e çmimit të një pasurie.

Është në natyrën e njerëzve që një shtëpi, ose një banesë që e kanë të atyre që me figura u thonë flasin me hiperbola, që kanë qejf për ta rritur, kanë qejf për të thënë: unë e kam shtëpinë që vlen kaq.

Dhe, ke të njëjtën shtëpi, një natyrë tjetër që ka merak zvogëlimin ose litotën, thotë: jo bre një copë shtëpi e kam.

Kjo ndodh edhe në deklarim, sepse është voluntarizëm total i çmimit të një vlere. Kurrkush s'ka kurrfarë standardi kështu që nganjëherë del, kur i këqyr, kojshia që e ka shtëpinë sa pesë herë ti,

është më e lirë se ti që je pesë herë më i vogël. Dhe, këtë mund ta provojë kush të dojë, për çka të dojë, pra, voluntarizmi i paraqitjes së pasurisë.

E dyta është- tipi i deklarimeve të pasurisë. Unë këtu e kam përvojë personale. Unë zakonisht, edhe hala mendoj që pasurinë më të madhe që e kam bërë për 40 vjet punë intelektuale, është një bibliotekë që i kam nja dhjetë mijë tituj libra. Kjo është bërë pak çudi për ta dhe ka dalë që është edhe një ministër i kësaj Qeverie që ai i ka, i ka paraqitur si vlerë edhe ai nja njëmijë tituj.

Tek ai kanë shkuar, po te unë erdhën, dhe erdhën gazetarët me detyrime investigative. Thashë, bravo ju qoftë që jeni kujtuar.

Problemi ishte, prapë po luaj, me problemin qysh është banalizuar voluntarizmi i qitjes së çmimit. Ajo zonjusha a zonja gazetare që ishte, bisedën që e kam bërë, por s'e ka botuar tekstin mbasandaj, se s'ka qenë atraktive. Atëherë, ajo thotë: ma jep çmimin e librave, sepse je i detyruar sipas filan nenit të Agjencisë ti t'ia dërgosh. Unë them, nuk di t'ju jap çmim. Ajo thotë, qysh s'di!? Matematikë e thjeshtë, nëse i ke dhjetë mijë, qitja një çmim një libri dhe e shumëzon dhe del, sepse ajo mendon që është çdo titull njësoj. Ajo mendon që çdo libër e ka njëjtën vlerë.

Ajo ose ata që e porosisin, ata nuk e dinë që një libër i botuar i shekullit të kaluar, po e zëmë i Kristoforidhit, ka vlerë sa një bibliotekë e sivjetme.

Domethënë, vazhdon mosmarrëveshja totale e njohjes së asaj që paraqitet e vlerave, e kulturave, e tjera.

Dhe vënerimi i fundit, kjo që e tha Naiti. Shifrat që shkojnë nëpër xhirollogari prej institucioneve ai është sendi më i lehtë për t'u parë dhe s'ka nevojë për t'u marrë me ato punë.

E dyta. Është njëfarë keqkuptimi në mes të ne vetë deputetëve. Në një anë e mbrojmë Ligjin për mbrojtjen e të dhënave, në tjetrën anë thonë pse s'po i shti hundët gjithkush kudo. Ose njëri, ose tjetri, ose bëhet ligj specifikum, qysh po prodhojnë amerikanët për ta bërë, ose francezët kohën e fundit për ta dhënë lirinë personale për siguri kolektive, që po thonë ata. Po njëra është. Nuk munden dyat. Duhet të studiohet çka po domi, edhe në këtë rast.

Dhe ky tip agjencioni që e ka emrin çfarë e ka, nuk guxon të bëjë kërkime politike. Assesi.

Është edhe një problem tjetër, që ne na e kanë shitur si tip të transparencës për t'i qitur në internet pasuritë e ashtuquajtura të zyrtarëve. Gabim. Ata që na e kanë shti, vetë s'i bëjnë.

Në Belgjikë, që kanë qenë kumar të ligjit të tillë te ne, sponsorizues në Kuvend tonin, e kanë të ndaluar për t'i kallëzuar të ardhurat kolegu ynë. Bile, ata thonë, kjo është rrezik i madh, përfaqësuesit e shtetit sidomos jashtë, po e zëmë në diplomaci e krejt, për t'i figuruar lekët që i kanë ata nëpër internet. Ata kështu thonë, thonë është rrezik. Te ne po thonë s'është.

Po kjo është për një pikëpyetje për këtë vend. Ky nuk do të zgjidhet sot.

Si do që të jetë, edhe një herë po them, problemi i voluntarizmit të caktimit të çmimeve, relativizon çdo gjë. Faleminderit!

E shfrytëzova rastin sepse në ndërkohë erdhi kryetari, po më duhej t'i them dy fjalë.

Tash edhe këtë temë e kryem.

Unë i thërras. Koha është kur i kemi lutur deputetët që të jenë këtu për votime. I thirrni të gjithë deputetët që sillen kësajde, a i kemi 61 deputetë?

Bjeri ziles, bjeri tupanit e çka të keni bjeri, po... Qe, po vijnë edhe disa, e të shohim.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Unë ju propozoj që t'i kryejmë edhe këto dy pika dhe le të mbetet vetëm votimi se ne të hënën kemi seancë të re dhe mendoj të vazhdojmë.

Pra, vazhdojmë me pikën e radhës:

10. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit, e ka shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka paraqitur raport me rekomandime.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet e Financa, e ka shqyrtuar këtë raport financiar dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandime.

Zëvendëskryetari i parë i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri, Visar Ymeri e ka fjalën. Fjalën e ka Raif Qela, nënkryetar apo anëtar i Komisionit. Urdhëro, Raif.

RAIF QELA: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2015, shqyrtoi Raportin vjetor të punës për vitin 2014 të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

Të miratohet raporti vjetor i punës për vitin 2014 i Autoritetit të Aviacionit Civil, me rekomandimet si në vijim:

Qeveria, Ministria e Infrastrukturës dhe AAC-ja, të bëjnë zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Aviacionin Civil, të datës 5 maj 2014, në afatin prej 6 muajsh pas miratimit të këtyre rekomandimeve dhe që Ministria të propozojë dhe Qeveria të zgjedhë bordin mbikëqyrës të AAC-së në afatin prej 3 muajsh pas miratimit të këtyre rekomandimeve.

Komisioni vlerëson se moszbatimi i rekomandimeve të Kuvendit, me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Aviacionin Civil në legjislaturën e kaluar nga ana e Qeverisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe AAC-së, si dhe mungesa e bordit mbikëqyrës të AAC-së, mund të ndikojë në mbarëvajtjen e punës së AAC-së dhe në zbatueshmërinë e Ligjit për Aviacionin Civil.

Komisioni vlerësoi se raporti vjetor i punës për vitin 2014, i parashtruar nga AAC-ja është në pajtim me nenin 15.2 të Ligjit numër 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe i rekomandon Kuvendit për miratim, me rekomandimet e cekura më lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet e Financa, për të arsyetuar raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Po ashtu edhe Autoriteti i Aviacionit Civil, sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike e ka dorëzuar me kohë brenda afatit ligjor raportin për vitin 2014 ku janë paraqitur të gjitha aktivitetet financiare që kanë të bëjnë me shpenzimin e mjeteve të dedikuara për këtë institucion nëpër kategori dhe nënkategori ekonomike.

Buxheti përfundimtar i Autoritetit të Aviacionit për vitin 2014 ka qenë 841 375 euro, ndërsa i kanë shpenzuar 822 116 euro, që do të thotë 98% të buxhetit duke marrë parasysh edhe rritjen prej 25% të pagës sipas vendimit të Qeverisë dhe zbritjen 15% të kategorisë së mallrave e shërbimeve sipas vendimit të Qeverisë.

Po ashtu ky autoritet ka realizuar të hyra në shumë prej 1 364 546 euro, nga të cilat, nga taksat e sigurisë së udhëtarëve në vlerë prej 1 359 146 euro dhe nga tarifa e certifikimit dhe licencimit në shumë prej 9 400 euro dhe këto mjete janë bartur në buxhetin e Kosovës.

Komisioni konsideron se raporti i përmban të gjitha kushtet sipas standardeve të raportimit dhe i rekomandon Kuvendit për votim.

Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK, rekomandojmë që ky raport të votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Për PDK-në, janë të paraqitur disa. Kush është? E ka fjalën Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje kolegë deputetë dhe ju të pranishëm.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar dhe e ka shqyrtuar me vëmendje Raportin e Autoritetit të aviacionit civil të Kosovës dhe që në fillim dëshiroj të deklarohej në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike se e mbështesim këtë raport.

Vlen të përmendet se është njëri ndër raportet më të mira që e pasqyron punën e tij njëvjeçare në të gjitha institucionet e pavarura që i përgjigjen Kuvendit.

Autoriteti i Aviacionit Civil është një agjenci e pavarur rregullatore, e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror.

Vlen të përmendet që në fillim se si ngjarje qendrore e vitit 2014 për këtë institucion në sektorin e aviacionit civil, ka qenë rihapja e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës për mbi fluturime në muajin prill të vitit që shkoi. Siç dihet, kjo hapësirë ka qenë e mbyllur për fluturimet civile që nga paslufta.

Më lejoni që të shkoj në mënyrë telegrafike nëpër raportin në fjalë. Vlen të përmendet faqja 17 ku bëhet fjalë për normalizimin e hapësirës ajrore të Kosovës, thuhet se hapësira ajrore e Kosovës që nga viti 1999 është pjesë e hapësirës së përbashkët operacionale të Ballkanit, nën kontrollin operacional të Qendrës së kontrollit të operimeve të kombinuara ajrore.

Kjo hapësirë ajrore është hapësirë e kontrolluar dhe në të cilën ofrohen shërbime pa trafik ajror.

Gjithashtu hapësira e ulët ajrore e Kosovës, kontrollohet nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” i cili afron shërbime të navigacionit ajror për aeroplanë civil gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës, me qëllim të aterimit dhe ngritjes nga Aeroporti i Prishtinës.

Gjithashtu shërbime afrohen edhe për fluturime të KFOR-it, EULEX-it dhe fluturime të aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të vendit.

Në faqen 20 të këtij raporti bëhet fjalë për rihapjen e hapësirës së lartë ajrore dhe zhvillimet rreth hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës.

Që nga përfundimi i luftës, hapësira e lartë ajrore e Republikës së Kosovës ka qenë e mbyllur për mbikalimet e avionëve civilë dhe është nën autoritetin e NATO-s.

Kontrollorët tanë të trafikut ajror afrojnë shërbime për ngritje dhe aterime nga Prishtina si dhe për fluturime tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Normalizimi i plotë i hapësirës së ulët ajrore të Kosovës, ndër të tjera, do të përfshijë hapjen e korridoreve të reja ajrore midis Republikës së Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë, që do të shërbenin për të gjithë avionët që fluturojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Tash për tash, të gjitha fluturimet në Prishtinë kryhen vetëm përmes një korridori ajror që e lidh Republikën e Kosovës me Maqedoninë.

Korridoret e reja do të shkurtonin kohën e fluturimit për rreth 15 deri 20 minuta, do ta ulnin koston e operimit për kompaninë ajrore që rrjedhimisht do të duhej të refleктоhej edhe në biletat më të lira për udhëtarët tanë, sepse ne jemi dëshmitarë të asaj që dëgjojmë se nga qytetarët që udhëtojnë me aeroplan gjithmonë ankohen për çmime të larta të biletave.

Prandaj, ky normalizim do të mundësojë edhe mbikalimin transit nëpër hapësirën tonë të ultë të shumë avionëve që fluturojnë në aeroporte tjera të rajonit.

Është interesant të shpreh se si sfida gjatë raportimit e kanë paraqitur edhe një shkelje të marrëveshjes së kësaj sfere, që e bën Maqedonia, duke iu ofruar kompanive fluturuese ndihmë shtetërore e cila është e ndaluar në bazë të Marrëveshjes së shteteve që janë pjesë e këtyre asociacioneve. AAC-ja ka bërë një ankesë në Komisionin Evropian dhe ata janë në shqyrtim të kësaj sfide dhe natyrisht se Maqedonia t'i marrë ndëshkimet e merituar që janë të rregulluara.

Vlen të përmendet se në faqen 23 të raportit, ku paraqiten opinionet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, i publikuar me 8 tetor 2014, ka vlerësuar punën e bërë nga autoritetet aeronautike të Kosovës në transponimin e legjislacionit të nevojshëm për të përmbyllur fazën e parë të marrëveshjes. Po ashtu është vlerësuar edhe miratimi i Ligjit për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror si dhe rihapja e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës, në prill të vitit 2014.

Sidoqoftë vihen në pah disa çështje që pritet të adresohen prej nesh, siç është certifikimi i ofruesve të shërbimeve.

Raporti i Progresit e ka radhitur Kosovën ndër të parat, sa i përket plotësimit të standardeve dhe kërkesave që kërkohen nga Bashkimi Evropian.

Faqe 33, e kemi një aktivitet të këtij institucioni që ka të bëjë me licencimin e 'paragllajdistëve' të parë në Republikën e Kosovës. Kjo e arritur vjen si rezultat i një pune madhore që e ka bërë ky institucion.

Në faqe 35, kemi mbikëqyrjen e vazhdueshme të ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror, që në kuadër të mbikëqyrjes së vazhdueshme të shërbimeve të navigacionit ajror gjatë vitit që shkoi AAC ka realizuar dy auditime dhe një inspektim në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari".

Ekipi auditues, është ndarë i kënaqur, thuhet në raport, sidomos në përkushtimin dhe angazhimin e menaxhmentit dhe stafit të tij.

Në faqen 36, kemi të bëjmë me lëshimin e licencave për kontrollor të trafikut ajror dhe vlerësimin e gradimeve. AAC është përgjegjëse për lëshimin dhe ripërtëritjen e licencave të kontrollorit të trafikut ajror, të cilët ofrojnë shërbime të kontrollit ajror në territorin e Republikës së Kosovës.

Vlen të përmendet se më 31 dhjetor 2014 AAC-ja ka ripërtërirë licencat e 23 kontrollorëve të trafikut ajror, të cilët aktualisht shërbejnë në Shërbimin e kontrollit ajror të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".

Mbikëqyrja e vazhdueshme e sigurisë së Aeroportit ndërkombëtar që bëhet nga kjo Agjenci. Ky raport është i përfshirë me të gjitha aktivitetet detale që vlen dhe është mirë që secili ta shohin, por është mirë edhe për qytetarët e Kosovës ta dinë se çfarë pune e madhe bëhet nga ky institucion.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet dhe ju ftoj që ta mbështesni edhe ju si raport vjetor të punës. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Për “Vetëvendosjen” flet deputetja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Prej vitit 1999, hapësira e lartë ajrore e Kosovës ishte e bllokuar. Ajo u rihap me 3 prill 2012, me vendim të Këshillit të NATO-s në bazë të përgjegjësi që NATO-ja për hapësirën ajrore të Kosovës dhe u la nën përgjegjësi për ofrimin e shërbimeve ‘Hungaro-kontrollit’, edhe pse për këtë kishte aplikuar Shqipëria, Italia, Austria, Maqedonia dhe Serbia.

Kontrolli i hapësirës së lartë ajrore është administruar prej 2003 nga NATO. Përgjatë këtyre viteve, siç deklarohet zyrtarisht prej autoriteteve të Aleancës, është punuar për të mbërritur konsensus me anëtarët tjerë në gjetjen e zgjidhjes për të hapur hapësirën e lartë ajrore të Kosovës që shërben për fluturime transit.

Pas bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavi, NATO dhe Republika Federale Jugosllave nënshkruan Marrëveshjen tekniko-ushtarake të Kumanovës, ku midis të tjerash u transferuan kompetencat për menaxhimin e hapësirës tokësore dhe ajrore të Kosovës nga ish-Jugosllavia tek autoritetet e NATO-s duke përfshirë edhe një pjesë të territorit brenda Serbisë që njihet si zona tampon.

Në pikën 3, germa c) të nenit 2, vendoset për rolin e KFOR-it. Komandanti i forcës ndërkombëtare të sigurisë, do të thotë të KFOR-it, do të kontrollojë dhe koordinojë shfrytëzimin e hapësirës ajrore mbi zonën ajrore të sigurisë, duke filluar nga dita e hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Për arsye të sigurisë, NATO ka mbyllur hapësirën ajrore të Kosovës, duke pezulluar të gjitha korridoret mbi Kosovën, pas... të UNMIK-ut, sipas rezolutës 1244 nga KFOR-i iu deleguan përgjegjësitë për administrimin e hapësirës ajrore për fluturime civile. Për këtë ka edhe marrëveshje në formë deklarate të nënshkruar më 12 shtator 2002 nga ku nisi edhe themelimi i Zyrës mbikëqyrëse të Aviacionit Civil në Kosovë, e që sot është sipas ligjeve në fuqi, autoriteti civil i Kosovës.

Edhe Marrëveshja e Kumanovës është ende në fuqi, ashtu si Rezoluta 1244. Në planin ndërkombëtar e shtetëror, kalimi i kompetencave për kontrollin e hapësirës ajrore të Kosovës, tek vetë Kosova, është një çështje shumë e rëndësishme, sa politike aq edhe ekonomike. Formalisht e juridikisht ato janë të sanksionuara nga ligjet e Kosovës për këtë fushë.

Edhe në kuptimin kushtetues, Kosova ka sovranitetin plotë në hapësirën e vet ajrore, por defakto kjo çështje është e lidhur ngushtë me avancimin që bën Kosova në një marrëdhënie të re me KFOR-in, gjegjësisht NATO-n si dhe me përpjekjet intensive për të vendosur marrëdhënie me Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil apo ICAO. Sipas raportit, autoritetet kanë ndihmuar Ministrinë e Punëve të Jashtme për të mbushur aplikacionin dhe kjo është në faqen 17 të raportit dhe pjesëmarrja në hapësirën e përbashkët evropiane të aviacionit. Në raport thuhet se

vetëm pas anëtarësimit në ICAO mund të aplikohet për ECAC dhe përgjegjësia i bie Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Integritetit, dhe kjo paraqitet në faqen 21 të raportit.

Problemet me dhënien në menaxhim të hapësirës së lartë ajrore të Kosovës ‘Hungaro-kontrollit’ janë në tri rrafshë, atë teknik, operacional, por edhe politik. Për këto çështje, secili shtet vepron me plane të sigurta dhe të mbështetura në disa variante apo skenar. Kush përgjigjet se çfarë ndodhë nëse për arsye teknike shërbimi, ose për çfarëdo situatë jo të përshtatshme politike nga Hungarian-kontroll, dështon qoftë për periudhë të shkurtër e aq më tepër të gjatë kontrolli i hapësirës së lartë ajror të Kosovës, ndërkohë që Autoriteti civil i Kosovës nuk është ende gati.

Ende nuk ka përgjigje për sa kohë do të merrte t’i përgatisnim kushtet për drejtime nga vetë autoriteti civil i Kosovës, si do të jenë pra të mbuluara e të garantuara këto 5 vite për të cilat i është dhënë ‘Hungaro-kontrollit’ menaxhimi i hapësirës sonë ajrore.

Menaxhimi i trafikut ajror është një problem tjetër me rëndësi e që paraqet rreziqe të mëdha në kushtet që jemi. Çfarë ndodh nëse ka një situatë emergjente me fluturim, ku një ose më shumë aeroplanë u duhet të aterojnë në Prishtinë? Sistemi që ka autoriteti ynë civil as nuk është i automatizuar që të lejojë e drejtojë ulje në rast rreziku e as nuk i ka kushtet që të shkëmbejë e koordinojë të dhëna në një sistem të integruar të dhënash me autoritetet tjera.

Ne ende nuk kemi procedura të standardizuara të shkëmbimit të të dhënave dhe kemi mungesë të një sistemi automatik të integruar të të dhënave për fluturim. Deri më tani janë bërë vetëm dy trajnime të nivelit të lartë të cilat në raport janë paraqitur në faqen 54 dhe 55.

Përfitimet e munguara ekonomike e financiare dhe tani për tani nga raporti financiar dihet se janë mbledhur 1 359 000 euro nga tarifa e sigurisë së udhëtarëve dhe nga tarifat e licencimit që s’ka shumë që kanë filluar, do të thotë 9.400 euro, sasi tepër qesharake për një aeroport ku kalojnë 1 004 000 udhëtarë. Nga zonat e taksuara lidhet me faktin se euro-kontrolli e ka vendosur hapësirën ajrore të Kosovës në zonën e taksuar të rajonit informativ të fluturimeve në Beograd. Ende sot nuk jepet përgjigje dhe qëndrim zyrtar se pse nuk është ndërruar ky fakt tepër dëmtes dhe si e çfarë po bisedohet me KFOR-in.

Në raport nuk thuhet asgjë përveç një fjalie: vazhdon bashkëpunimi me KFOR-in dhe që ai ka qenë autoriteti nënshkrues në emër të Kosovës. Pra, të ardhurat nga taksimi duhet të kalojnë veçmas dhe drejtpërdrejt për Kosovën dhe në raport kjo nuk është sqaruar.

Të gjitha të ardhurat në këtë fushë, që gjenerohen nga shfrytëzimi dhe përdorimi i hapësirës së lartë ajrore të Kosovës, do të mund të përdoren për ngritjen e kapaciteteve, të infrastrukturës, të përgatitjes njerëzore nga ana e Kosovës, meqenëse ‘Hungarian-kontroll’ do të mbulojë të gjitha shpenzimet vetë. Nuk ka asnjë shpjegim serioz e të qëndrueshëm pre Kosova mos t’i përdorë këto mjete për t’i zhvilluar kapacitetet e saj brenda autoritetit civil ajror.

Duhet të kemi parasysh se janë afërsisht 425 fluturime brenda ditës në hapësirën tonë të lartë ajrore.

Edhe pse pretendohet që kanë për qëllim trajnimin e stafit, autoriteti civil përgjatë vitit 2014 ka bërë vetëm 24 trajnime brenda dhe jashtë vendit, ku një pjesë janë për çështje administrative-juridike, një pjesë janë bërë nga vetë qendra e trajnimeve këtu në Kosovë dhe vetëm një pjesë shumë e vogël është e nivelit të lartë profesional. Për deri sa për paga dhe mëditje, apo rroga janë shpenzuar 594.000 euro, janë vetëm 23 000 të shpenzuara për arsimim dhe trajnim të stafit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pal Lekaj për AAK-në. 10 minuta i ke Pal, por mundesh edhe 2 a 3.

PAL LEKAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë po e kursej në këto orë të vona nga historia dhe strategjia, por do të fokusohem në raport. Ne e kemi shqyrtuar raportin me vëmendje. Është mjaft përmbajtjesor dhe si Grup Parlamentar i Aleancës, do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESI: Shkurt e shqip, faleminderit! Për Grupin “Nisma”, Enver Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “Nisma” e mbështet raportin e Autoritetit të Aviacionit civil.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë!

Unë e kam lexuar raportin dhe desha të jap një opinion timin rreth këtij raporti.

Raportin e Autoritetit të aviacionit civil të Republikës së Kosovës, për aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2014 e vlerësoj si shumë cilësor dhe gjithëpërfshirës, si përnga struktura ashtu edhe për nga përmbajtja.

Përmes këtij raporti na është mundur kuptimi i qartë i aktivitetëve të arritura, por edhe sfidave me të cilat po ballafaqohet sektori i Aviacionit civil i shtetit tonë.

Pjesë integrale të raportit janë edhe shtojcat shumë domethënëse që flasin, mes tjerash, për realizmin e planit të veprimit, matjen e kënaqshmërisë së shfrytëzuesve të shërbimeve si dhe statistikave të transportit ajror.

Auditimet, inspektimet dhe vëzhgimet e shumta të ndërmarra gjatë vitit tregojnë se shteti ka një rregullator serioz të Aviacionit civil, që kujdeset për mbajtjen e një niveli të lartë të sigurisë në përputhje me standardet në fuqi në operimet e aviacionit civil që zhvillohet në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Në raport reflektohen disa herë fakti që mbikëqyrja rregullatore bëhet në partneritet me operatorët siç janë Aeroporti, shërbimet e kontrollit ajror, si dhe kompanitë ajrore dhe unë e vlerësoj lartë këtë fakt sepse nëse sektorët delikat si ky bashkëpunimi i mirëfilltë rregullator-operator është kyç për të arritur sigurinë e standardeve ndërkombëtare.

Ky autoritet me punën e vet ka arritur në vazhdimësi të vlerësohet në raportet e progresit të Këshillit të Evropës për Kosovën dhe kjo para se gjithash për nivelin e transpozicionit dhe zbatimit të kuadrit ligjor të BE-së në rendin tonë ligjor. Ky përkushtim në respektimin e legjislacionit evropian ka bërë që sipas rregullave të njëjta të licencohet, për shembull, një kontrollor i trafikut ajror apo certifikohet një aeroport në një vend të BE-së ashtu si edhe në Kosovë.

Është për t'u përshëndetur bashkëpunimi me institucionet tjera të shtetit, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, që ka ky autoritet me autoritetet homologe, gjithandej si me Shqipërinë, Maqedoninë, Kroacinë, Francën, Hungarinë e tjera.

Më gëzon fakti se inspektorët e AAC-së së Kosovës janë ftuar në vazhdimësi për të ndarë eksperiencën e tyre me vendet fqinje, autoritetet e aviacionit të cilave janë shumë më herët të krijuara dhe kanë një përvojë shumë më të gjatë se ky i yni. Ky fakt ilustron se ngritja profesionale e personelit të AAC-së përmes trajnimeve të vazhdueshme që janë reflektuar në mënyrë shumë transparente, në njërin nga shtojcat e raportit, janë investim që shpërblehet me vlerën e shtuar për vendin tonë.

Raporti thekson rihapjen e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës, si dhe përpjekjet që po bën ky autoritet në koordinim me ministrinë përkatëse dhe në bisedime me NATO-n për të normalizuar hapësirën e ulët ajrore të Kosovës. Shihet qartë nga raporti se autoriteti ka intensifikuar punën në zhvillimin e aviacionit të përgjithshëm duke vënë në dispozicion legjislacionin përkatës, duke përkrahur Federatën Aeronautike të Kosovës dhe duke lëshuar licencat e para për pilotët kosovar pas një procesi shumë kërkuar dhe transparent të vlerësimit.

Autoritetit të Aviacionit Civil fatkeqësisht po i pamundësohet anëtarësimi në organizma evropian e ndërkombëtar të aviacionit civil, por është për t'u theksuar insistimi i tyre i pareshtur ndaj këtyre organizatave, i përshkruar në raport.

Mendoj, edhe si deputetë, edhe Qeveria duhet të vazhdojmë t'i japim shtytje të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare të Aviacionit civil duke marrë parasysh natyrën ndërkombëtare dhe të ndërlidhur me sigurinë publike të këtij sektori.

Dy çështjet e fundit, por shumë me rëndësi, që kisha pasur dëshirë t'i theksoj, janë efikasiteti i lartë i AAC-së në realizimin e buxhetit të miratuar, që ka arritur vitin e kaluar 98%, si dhe raportet pozitive që në vazhdimësi ka marrë ky autoritet për menaxhimin e financave publike nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të respektuar kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar,

Unë e kam lexuar me vëmendje raportin e Autoritetit të Aviacionit Civil dhe u tha edhe nga parafolësit që vërtet është një raport i përgatitur mirë, por unë nuk do të ndalem në atë pjesë, por

desha të ndalem vetëm në këtë pjesën e buxhetit – raportit financiar për vitin 2014, të cilin e kemi përpara.

Në qoftë se ndalemi dhe e analizojmë me vëmendje, del se në periudhën janar-dhjetor të vitit 2014 Autoriteti i Aviacionit civil ka shpenzuar 822.116 euro, ndërsa si organizatë buxhetore ka realizuar të hyrat prej 1.368.546 euro që do të thotë diku 60% prej këtyre të hyrave faktikisht janë shpenzuar për nevoja buxhetore të vetat, brendapërbrenda, si njësi buxhetore.

Unë do të shkoj pak me radhë dhe t'i analizojmë disa gjëra. Në tabelën 4 c) te shërbimet dhe mallrat, te kodi i shpenzimeve tjera të udhëtimeve zyrtare, ka dalë një shumë se është shpenzuar 69% që në realitet nuk është 69% por është 98% të buxhetit të paraparë për këtë kategori.

Po ashtu, në të njëjtën tabelë, në një faqe pas, te shërbimet e telekomunikacionit. Në qoftë se marrim e shikojmë dhe analizojmë, këtu i kemi diku 28 veta të punësuar, në këtë agjenci dhe këta 28 vetë të punësuar në vitin buxhetor 2014 kanë shpenzuar hiq më pak se 9 942 euro shpenzime të telefonisë mobile, që i bie përafërsisht se çdonjëri prej këtyre punëtorëve mesatarisht nga 100 euro telefoni mobile i kanë shpenzuar brenda një viti.

Te shpenzimet e arsimit dhe trajnimit, është po ashtu një shumë relativisht e vogël e shpenzuar, në fakt, në qoftë se i kemi parasysh kërkesat që kanë pasur këtu për t'u realizuar, por më vonë, në një kategori tjetër na del edhe një shpenzim telefonik që gjithashtu është një shumë relativisht e madhe dhe që është shpenzuar në emër të këtyre shpenzimeve.

Është për t'u brengosur se një buxhet që është paraparë, për shembull, për shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse është shfrytëzuar vetëm 36%, domethënë nuk kanë pasur nevojë fare të avancohen në këtë aspekt, ose eventualisht të marrin përvoja të reja.

Do të shkojmë më poshtë në një tabelë dhe do të shohim se është interesant që të gjitha shpenzimet për udhëtime jashtë vendi, janë shpenzuar gati në masën prej 110 deri në 113% nga ajo që është paraparë, që vërtet janë një shumë relativisht e madhe e shpenzimeve.

Dalim te tabela 4 f) personeli dhe struktura e pagave për vitin 2014, dhe vetëm në qoftë se këtu bëjmë një analizë të vogël, në shikim të parë, realisht te niveli i menaxhmentit të lartë ka qenë një pozitë që është aprovuar nga Ligji për buxhet. Realisht është plotësuar edhe një pozitë që është shtuar një pozitë shtesë këtu dhe janë bërë dy pozita. Dhe në qoftë se i marrim këto dy pozita dhe shuma që është shpenzuar diku për paga 60 642,50 euro, na bie që mesatarisht njëri prej këtyre të punësuarve ka realizuar një shumë mesatare të hyrave mujore prej 2 526,77 euro, që është një shumë jashtëzakonisht e madhe, marramendëse.

Niveli i menaxhmentit, domethënë, kategoria e dytë, që janë 6 të punësuar, kanë shpenzuar 153 137,50 euro, që nëse e marrim dhe e kthejmë në mesatare mujore pagën e krejt këtyre punëtorëve, na del se paga mesatare mujore e këtyre punëtorëve është 2 126,9 euro - 2 127 euro.

Shkojmë te niveli profesional, që janë të punësuar 19 të punësuar. Kanë shpenzuar një buxhet prej 371 699 50 euro. Në qoftë se e marrim dhe e kthejmë në mesatare, tash nuk e di ky niveli profesional çfarë e kanë përgatitjen e tyre, por mesatarja e rrogës mujore e këtyre njerëzve është

1 630,26 euro. Dhe që është një kategori shumë interesant, niveli mbështetës, që prapë nuk po di cilin funksion e kryen ky, ka shpenzuar 8 977,50 euro që mesatarja mujore e këtij niveli që është vetëm një njeri e ka marrë një pagë mesatare diku 750 euro mujore. Dhe në qoftë se e marrim në total dhe e analizojmë pagën mesatare të krejt këtyre 28 të punësuarve në këtë autoritet, faktikisht na del se është 1 770 euro mesatarja mujore.

Realisht, ne shumë herë po kritikohemi si deputetë të Kuvendit për paga të mëdha, mirëpo për fat të keq po na del që edhe një agjenci shumë e vogël, me një numër shumë të vogël të njerëzve të punësuar po realizojka paga maksimaliste të cilat realisht janë më të mëdha edhe se të kryeministrit të Kosovës e ndoshta edhe të presidentes, se nuk e di sa e ka presidentja dhe do të thotë se është mbi nivelin mesatar të Kosovës. Faleminderit, zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Faleminderit! Mexhide Mjaku-Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Dikur aktive në sportin e parashutizmit dhe anëtare e një klubi të aeronautikës më shtyri që të marrë fjalën dhe të them disa fjalë në lidhje me raportin e Autoritetit të Aviacionit civil.

Është për t'u përmendur përmbushja e përgjegjësisë së licencimit të personelit ku Autoriteti i Aviacionit Civil ka lëshuar një numër licencash duke përfshirë këtu licencimin e kontrollimit të trafikut ajror në bazë të kërkesave të BE-së, si personel të rëndësishëm në ofrimin e sigurt të shërbimeve për kompanitë ajrore që fluturojnë në qiellin e Kosovës e tutje.

Po ashtu është për t'u vlerësuar edhe licencimi i personelit apo pilotëve të Delta-planit dhe 'paraglaidit', por nuk është e mjaftueshme apo nuk është përmbushje e plotë licencimi i personelit i vetëm një disipline aeronautike të paraglladajdzimit për arsye se nuk mund t'i mbajë gjallë aeroklubet e Kosovës apo Federatën Aeronautike të Kosovës.

Unë mendoj se është në interes të vendit që të planifikohet dhe të fillojnë të zbatohen gjatë vitit 2015 dhe viteve në vijim. Këtu mendoj në trajnimet standarde të anëtarëve të aeroklubeve të Kosovës, si dhe licencimi sipas kategorive të parashutizmit dhe të pilotëve.

Gjithashtu, është e nevojshme dhe e domosdoshme që të licencohen aeroportet sportive në vendin tonë për të zhvilluar aktivitete në lëmin e pilotëve veloristë, pilotëve motorikë dhe parashutizmit, e kjo do të ishte një mundësi e mirë për të aftësuar anë vendin tonë gjenerata të reja parashutistësh, pilotë veloristësh dhe pilotë motorikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe Blerim Grainca e ka kërkuar fjalën.

BLERIM GRAINCA: Zoti nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të mundohem të jem i shkurtër. I kam vetëm dy-tri çështje për t'i ngritur. Jam i vetëdijshtëm se jetojmë në kushte dhe rrethana kur po promovojmë një ekonomi të tregut dhe në këtë rast për mua është Autoriteti i aviacionit civil si rregullator i tregut që nuk ka arritur të përmbushë një obligim që lidhet me luftimin e monopoleve të caktuara në tregun e aviacionit e që lidhet direkt me çmimin e biletave në tregun e udhëtimeve.

Të gjithë jemi të vetëdijshtëm çka ndodh në këtë treg dhe veçanërisht me çmimet damping apo çmimet e shtrenjta të cilat u afrohen udhëtarëve në rast të festave që udhëtojnë nga Republika e Kosovës dhe po ashtu mendoj se kemi të bëjmë me një plaçkitje të hapur që agjencitë e fluturimit apo kompanitë e fluturimit u bëjnë qytetarëve tanë që jetojnë në botën e jashtme, duke u dhënë bileta me çmime të arsyeshme për ardhje në Kosovë, ndërsa në rast të kthimit për në Evropë apo destinacione tjera u trefishojnë çmimet.

Mendoj se ky asociacion, gjegjësisht Autoriteti i Aviacionit Civil do të duhej ta shikonte këtë gjë dhe këtë monopol sepse këtu kemi të bëjmë thjeshtë me një plaçkitje sikur te rasti i policave të sigurimit të cilat jepen në kufi për qytetarët tanë.

Po ashtu edhe çështja e licencimeve është interesante dhe unë edhe në Komision e kam ngritur si çështje dhe nuk kam arritur të marr përgjigje lidhur me Aeroportin e Gjakovës dhe fluturimin e kryetares së Gjakovës nga Aeroporti i Prishtinës, do të thotë, kjo çështja a e rrezikon sigurinë dhe a ka qenë konform rregullave për licencimin.

Me fjalë të tjera, do të thotë kjo se Pali sot udhëton me aeroplan për Gjakovë apo kryetarja e Gjakovës s'ka pasur licencë për fluturim. Faleminderit!

KRYESUESI: Kalojmë në pikën e fundit:

11. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014

Komisioni funksional për punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Kuvendit ka shqyrtuar Raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ta miratojë.

Tash kryetari i Komisionit Funksional është Daut Haradinaj, e merr fjalën. Atëherë, në emër të Komisionit Funksional flet Zafir Berisha. Urdhëro, Zafir!

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Siguri, Punë të Brendshme dhe FSK, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill e ka shqyrtuar Raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim të këtij raporti, edhe përkundër asaj që, edhe me një rast e thashë, Komisioni ka bërë punë të madhe përkundër mungesës financiare dhe hapësirave për veprim. Po sido që të jetë, ne si anëtarë të Komisionit para raportuesve kemi marrë obligime që në rishikim të buxhetit ta mbesim këtë komision të rëndësishëm të shtetit.

Prandaj, edhe një herë i ftoj kolegët deputetë që ta miratojnë këtë raport e po ashtu edhe në emër të Grupit Parlamentar "Nisma". Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Berisha! E ka fjalën Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

NASER OSMANI: Faleminderit!

Raporti financiar i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014 ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për raportin financiar sipas Ligjit në fuqi dhe Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit për aprovim, meqë Agjencioni në fjalë ka realizuar të shpenzojë 99.46% të buxhetit, që e ka pasur një shumë prej 371.700 euro, duke iu përmbajtur kritereve për shpenzimet sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike, prandaj ne kemi rekomanduar që të votohet. Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së rekomandojmë që raporti të votohet.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, e ka fjalën Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Po ky është një raport i hartuar kryesisht mirë, i cili e ka edhe një rekomandim brenda, që është shumë me rëndësi – aprovimi i Konventës 108 të vitit 1981 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kjo qenka edhe njëfarë parakushti që ne edhe të anëtarësohemi nëpër këto institucione të BE-së që merren ekskluzivisht me këtë punë, prandaj e shoh të rëndësishme që të votohet.

KRYESUESI: Faleminderit zotni Konjufca! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Është e vërtet se për dallim të vitit të kaluar, është njëri prej raporteve ndoshta më të mira që na ka ardhur në këtë komision dhe natyrisht, sikur e tha edhe deputeti Berisha, i rekomandojmë Parlamentit që ta miratojë. Këta kanë shprehur vërejtje dhe shqetësime sidomos në aspektin financiar, por siç e thatë edhe ju më herët, kur ishte fjala për Agjencinë Antikorrupsion, urgjentisht kërkohet që të vjen në Parlament ligji i ruajtjes së të dhënave civile, apo anglisht - ‘data protection base’. Derisa nuk e kemi një ligj të tillë, gjithmonë do të thotë manipulimi ose rrjedha e informacionit kurrkush nuk përgjigjet. Domethënë Kodi i procedurës penale nuk e njih ose nuk e penalizon atë i cili jep informata.

Po ashtu, një informacion që mendoj se edhe për deputetë të Komisionit të kaluar të sigurisë, që nga viti 1999 e deri më sot, asnjë e dhënë nuk i janë nënshtruar procedurave ligjore të cilat janë ose ekzistojnë edhe sot e kësaj dite në Vala, në Ipko, në Postën e Kosovës, por të gjitha janë në duart e qytetarëve të Kosovës dhe ata kanë të drejtë të manipulojnë qysh të kanë qejf. E kemi edhe rastin “pronto” që kurrkush nuk ka dhënë llogari se qysh ka rrjedh ai informacion në publik.

Domethënë, edhe një herë e përsëris, urgjentisht Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta sjell Ligjin për ruajtjen e të dhënave civile dhe brenda këtij ligji atëherë deputetët ta japin kontributin e vet që edhe për deputetë edhe për institucione të larta, do të thotë, të konstatojnë se cila është më e mira për t’i ruajtur të dhënat civile, që do të thotë se nëse nuk ruhen ato, në vende tjera të botës kjo temë është e mbyllur deri tash, por në Kosovë nuk ka një procedurë ligjore e cila i garanton qoftë deputetit, ministrit, zyrtarëve komunalë apo institucioneve të larta shtetërore

mbrojtjen e të dhënave civile. Do të thotë të gjitha janë në duar të qytetarëve të cilët punojnë në Posten e Kosovës, në Valë, në IPKO, Z-Mobail, e ku të di unë. Do të thotë, nëpër kafe dëgjohen bisedat e zyrtarëve të lartë shtetërorë, sepse janë të papërgjegjshme institucionet të cilat i mbikëqyrin dhe monitorojnë telefonatat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Haradinaj për diskutimin pikant, për të thënë, nëse më lejohet. Elmi Reçica, për PDK-në.

ELMI REÇICA: Faleminderit zoti nënkryetar!

Përshëndetje kolegë të nderuar,

Është e ditur se mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia nuk janë dëshirë e ndokujt, por vërtet është një e drejtë e garantuar kushtetuese, e në përputhje me këtë ne kemi krijuar autoritetin përgjegjës për mbrojtjen dhe promovimin e kësaj të drejte fundamentale të njeriut.

Sfidat dhe të arriturat e këtij autoriteti, janë të përshkruara në Raportin vjetor që gjendet para nesh. Nëse i referohemi raportit paraprak të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave, ndër sfidat kryesore ka qenë niveli jo i mjaftueshëm i informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës sa i përket të drejtave të tyre për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mund të konstatojmë se Agjencia ka adresuar dhe trajtuar me sukses këtë sfidë duke hartuar dhe realizuar me sukses fushatën ndërgjegjësuere në bashkëveprim me institucionet vendore, si Ministria e Administratës Publike, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe e atyre ndërkombëtare, siç është OSBE-ja, Zyra në Prishtinë, Projekti IPA, si dhe me botën akademike Universitetin e Prishtinës, UBT-në e tjerë.

Në kuadër të fushatës janë organizuar me dhjetëra aktivitete në tërë Republikën e Kosovës. Janë takuar me mijëra qytetarë, janë realizuar video dhe materiale tjera sensibilizuese të cilat besoj se një pjesë të tyre edhe ne i kemi parë, përcjell dhe dëgjuar.

Agjencinë duhet përgëzuar se ka arritur me sukses të jetë pjesë e mekanizmave të autoriteteve për mbrojtjen e të dhënave personale në nivel evropian e ndërkombëtar. Vetëm gjatë vitit paraprak Agjencia ka marrë konfirmimin e anëtarësimit të plotë në mekanizmin e autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave personale në Evropën Juglindore dhe përveç kësaj është anëtarësuar edhe në rrjetin ndërkombëtar të autoriteteve të 38 shteteve, pastaj është ftuar anë konferenca ndërkombëtare dhe në punëtori të ndryshme, që i ka organizuar BE-ja, siç është Sprinkferencë, dhe Agjencia është pranuar si vëzhguese e përhershme në autoritetet frankofone të mbrojtjes së të dhënave personale.

Përparimi i Agjencisë në realizimin e detyrave dhe obligimeve ligjore, si dhe obligimeve tjera, përafrimi i legjislacionit, nxjerrja e akteve nënligjore të kërkuara në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave dhe MSA, konfirmohet edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, ku pjesë aktive ka qenë edhe kjo Agjenci.

Duke hartuar strategjinë për vitin 2014-2017, agjencia ka arritur nivelin e duhur të pjekurisë institucionale duke vënë objektivat në zbatimin e drejtpërdrejt të Ligjit nëpërmjet inspektimeve dhe kontrolleve me fokus të veçantë ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë

e të dhënave, realizimin e të drejtave të subjektit të të dhënave, sensibilizmin e mëtejshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale tek organet publike dhe private, ndërgjegjësimi dhe promovimi i së drejtës themelore për mbrojtje të dhënave personale si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Në kuadër të realizimit të këtyre objektivave, respektivisht zbatimit të drejtpërdrejtë të Ligjit, gjatë vitit 2014 janë realizuar 114 inspektime, që janë mbi 40% inspektime më shumë se në vitin paraprak, derisa numri i ankesave të qytetarëve të pranuar dhe të shqyrtuara nga agjencia gjatë vitit 2014 është rritur mbi 100%. Do të thotë, më shumë se vitin paraprak, që tregon se numri i shqetësimeve të qytetarëve lidhur me mbrojtjen e të dhënave të tyre është në rritje dhe njëkohësisht mund të konstatojmë se niveli i vetëdijes së qytetarëve sa i përket mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë së tyre është në rritje të vazhdueshme.

Përkundër faktit se shohim një rritje të ndjeshme të këshillave dhe opinioneve të kërkuara e të dhëna nga agjencia, vërejmë se ne si Kuvend ende nuk e kemi kërkuar ndonjëherë mendimin e agjencisë sa i përket mbrojtjeve të dhënave dhe të privatësisë.

Agjencia tashmë ka dhënë opinione të rëndësishme dhe ka treguar pjekuri institucionale dhe ka dëshmuar kompetencë profesionale, dhe është e ditur se marrja e mendimit të agjencisë, përpos që është detyrë dhe obligim ligjor, mund të ndihmojë ndjeshëm në shqyrtimin dhe aprovimin e ligjeve dhe akteve tjera të cilat rregullojnë përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë.

Përkundër faktit se Agjencia ka një numër relativisht të vogël të punësuarve, dhe buxhet modest, të arriturat nuk kanë munguar, dhe mendoj se duhet kategorizuar në këto katër pika:

1. Me sukses ka tejkaluar barrierat duke qenë pjesë e mekanizmave evropian dhe ndërkombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale.
2. Ka realizuar me sukses fushatën për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve;
3. Ka ngritur performansën në të gjitha fushatat në mbi 50%;
4. Me sukses ka përmbushur detyrimet e saja para organeve vendore dhe ndërkombëtare, dhënia e mendimeve, komentet për ligjet, obligimet e dala nga Raporti i Progresit, liberalizimi i vizave dhe MSA.

Sigurisht se ka edhe shumë punë për të bërë, qëllimi i të cilave do të ishte njoftimi dhe garantimi i privatësisë së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo duke pasur parasysh edhe zhvillimin dhe përdorimin e teknologjisë informative dhe të cilat në vete paraqesin sfida të reja, e të cilat duhet trajtuar si nga Agjencia, ashtu edhe nga institucionet tjera, dhe atë duke përmirësuar legjislacionin dhe ngritur kapacitetet e nevojshme për t'u bërë ballë këtyre sfidave me të cilat ballafaqohemi jo vetëm ne, por edhe i tërë globi.

Agjencia ka dëshmuar tanimë përkushtimin dhe kompetencën për t'u bërë ballë sfidave, por duhet përkrahur dhe konsultuar sipas nevojës, me qëllim që t'i adresojë dhe të bëjë zgjedhjen adekuate për sfidat e reja në këtë botë të digjitalizuar. Faleminderit zoti nënkryetar!

KRYESUESI: Diskutuesi i fundit është Nuredin Ibishi.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Unë shkurtimisht desha të lidhem me çështjen e raportit, pasi që në Komisionin funksional për punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, kemi ftuar dhe dëgjuar autoritetet e Agjencisë dhe jemi bindur për gjendjen dhe duhet vetëm të rikujtoj se Kuvendi i Kosovës emëron 5 anëtarë të Këshillit, ndër ta mbikëqyrësin kryesor shtetëror dhe 4 mbikëqyrës që në vitin e ardhshëm, në muajin 6, u skadon mandati i parë.

Mendoj se për këtë kohë kanë arritur që të realizojnë objektivat që në aspektin e parë ka të bëjë me ngritjen e vetëdijes qytetare, mandej harmonizimin e legjislacionit, si të atij sekondar, sikur që janë udhëzimet administrative me rëndësi për mbrojtjen e të dhënave personale, pastaj zbatimin drejtpërdrejtë të Ligjit për inspektimet dhe kontrollet edhe në nivelin qendror edhe lokal, dhe atij publik e privat, mandej trajtimin e ankesave, ngritjen e kapaciteteve që është shumë me rëndësi për funksionimin e Agjencisë, si dhe në bazë të Raportit të Progresit, pra vërejtjet që janë dhënë kanë arritur për një kohë të shkurtër t'i tejkalojnë problemet që janë vërejtur dhe realisht mund të themi se kjo Agjenci është funksional dhe është i suksesshëm në këtë, përkundër edhe krejt sfidave të cilat u përmendën nga parafolësit e mi në trendët në rritje sidomos në aspektin e krimit kompjuterik, mandej edhe aspektet e keqpërdorimit apo përdorimit të këmbimit të dhënave personale, sidomos në aspektin edhe ndërkombëtar, dhe në veçanti të dhënave biometrike.

Pra, me një konstatim apo një përfundim, edhe si anëtar i Komisionit, po edhe si deputet i Kuvendit, mendoj se kjo agjenci me sukses ka zbatuar mandatin në kohën e paraparë. Faleminderit!

KRYESUESI: Kjo pikë u krye, por unë do t'i lexoj dhe propozimet e Listës serbe për zëvendësim të anëtarëve të komisioneve parlamentare.

12. Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Deputetja Jelena Bontiq, propozohet zëvendëskryetare e dytë të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Bojan Mitiq.

Deputetja Jasmina Zhivković, propozohet kryetare e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, në vend të Sasha Milosavljeviq, i cili prapë propozohet anëtar i këtij Komisioni;

Deputeti Sërgjan Popović, propozohet zëvendëskryetar i dytë i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, në vend të deputetes Jelena Bontiq;

Deputeti Sërgjan Popoviq, propozohet zëvendëskryetar i dytë i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis, Planifikim Hapësinor, në vend të ish deputetit Rakiq.

Të dashur dhe të nderuar deputetë e deputete,
Nuk kemi kuorum për t'i bërë votimet. Të gjitha pikat e rendit të ditës që sot i kemi shteruar në diskutime, unë shpresoj dhe duhet t'i votojmë të hënën para se të nisim seancën e re. Faleminderit për bashkëpunim! Natën e mirë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare më 18 maj 2015
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër,
Kabinet qeveritar,

Në fakt, jemi para fillimit të seancës së re plenare, por në të njëjtën kohë kemi edhe vazhdim të seancës, asnjërën nuk mund t'i procedojmë për arsye se nuk kemi kuorum.

Atëherë do ta shfrytëzojmë kohën, ndërkohë të ju krijua mundësinë, edhe pse duhet vazhduar seancën me shmangie të Rregullores, kush ka pyetje jashtë rendit të ditës le ta shfrytëzojë, ndoshta ka, ndoshta jo. Por, nuk kemi kuorum, kemi ligje, e s'kemi kuorum, për arsye se duhet me shmangie të Rregullores, i kemi këtu edhe anëtarët e Kryesisë kolegë, e të shkojmë me shmangie na duhet 61 deputetë, ose duhet të shkojmë në pauzë, ose të vazhdojmë me pyetje jashtë rendit të ditës, por pa procedura. Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Meqenëse është caktuar seancë e re, të vazhdojmë me seancë të re, i lexojmë ligjet, e pastaj kur të vijë puna për votim, shkojmë në votim.

KRYETARI: Edhe një herë, më lejoni të ritheksoj: nuk mund të vazhdojmë me leximin formal për arsye se për t'u futur në seancë duhet t'i kemi 61 vota. Duhet të bëjmë shmangie nga Rregullorja, domethënë nuk kemi të drejtë të futemi fare në seancë. Ju vendosni me 61 vota për shmangie nga Rregullorja.

Unë po e lexoj. Ani, presim në ndërkohë pesë minuta, pauzë! E donë fjalën, Glauk? Margarita, urdhëro! Ndërkohë sa jemi si pauzë, e ke kërkuar fjalën, mos ke diçka jashtë rendit të ditës? Atëherë presim të gjithë, derisa t'i kemi 61 deputetë së paku.

Kisha kërkuar nga shefat e grupeve parlamentare të verifikojnë nëse do të vijnë deputetët për arsye se nga 10 a 15, sa e di unë, janë në mungesë sot, janë në udhëtim jashtë.

(Pauzë e shkurtër)

Atëherë, të nderuar deputetë,
Tani e kemi numrin e mjaftueshëm të deputetëve në sallë, prandaj fillojmë me punimet.

I nderuar kryeministër,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Ne i vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 15 maj, me pikat e papërfunduara, si në vijim.

Kemi nga seanca e kaluar disa nga projektligjet për votim formal në leximin e parë. Do të kalojmë një nga një.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 15 maj 2015, mirëpo në mungesë të kuoromit votimi u shty për seancën e sotme.

Andaj, të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 63 deputetë, të gjithë kanë votuar për. Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent

Edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 15 maj 2015.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent.

Përgatitemi për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se në votim kanë marrë pjesë 69 deputetë, 45 kanë votuar për, 20 kundër dhe 4 abstenime.

Konstatohet se e Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor

Po ashtu, diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 15 maj, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për shëndetin mendor.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se 70 deputetë kanë votuar, 69 janë për, një ka abstenuar.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shëndetin mendor.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përherëshme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014

Edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare të datës 15 maj 2015. Ne do të vazhdojmë me votimin e raportit vjetor të punës së Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar gjithsej 68 deputetë, 50 për, 11 kundër dhe 7 kanë abstenuar.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014.

9. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014

Edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 15 maj 2015. Tani na nevojitet ta votojmë për arsye se në seancën e kaluar ka pasur mungesë të kuorumit.

Pra, përgatitemi për votim raportin vjetor të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014. Votojmë tash!

Kanë votuar 66 deputetë, nga të cilët 46 për, 16 kundër dhe 4 kanë abstenuar.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014.

10. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014

Edhe për këtë pikë diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 15 maj 2015, por nuk kemi pasur kuorum. Do ta votojmë tani raportin vjetor të punës të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 70 deputetë, 65 për, 5 kanë abstenuar.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014, bashkë me rekomandimet e Komisionit Funkcional.

11. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014

Diskutimet i kemi përfunduar në seancën e kaluar, më 15 maj 2015, por nuk kemi pasur kuorum për votim. Tani do ta votojmë raportin vjetor të Punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 73 deputetë, 70 për, 3 abstenime.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014.

12. Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Të nderuar deputetë,
Kërkoj nga ju që nëpërmjet një votimi formal me ngritje dore të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar Lista serbe. Vetëm një votim formal, ju lutem, se u bë rutinë veç duke votua. Një votim formal me dorë!

Konstatohet se Kuvendi e miratoi propozimin e lartpërmendur të Grupit Parlamentar Lista serbe për zëvendësimet e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Me këtë i mbyll punimet e seancës plenare, e filluar më 15 maj 2015.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*